

Shtator 2020
Numri: 150
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

RUAJTJA e ZEMIRËS




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Në përgjithësi, emri shejtan përdoret për njerëzit, xhinët dhe kafshët e këqija. Në Kuranin fisnik, fjalët shejtan dhe melek përdoren gjithsej 88 herë, si në shumës ashtu edhe në njëjës.

Iblisi ose shejtani, ishte pjesëtar i një grupi të xhindëve, që ndodheshin pranë melekëve. Në Kuran tregohet gjatë e gjerë se kur Iblisi u sprovua me urdhrin e sexhdes ndaj Ademit (a.s.), ai refuzoi t'i bindej urdhrin dhe e humbi sprovën për shkak të mendjemadhësisë dhe smirës.

Ajo që theksohet në këto ajete dhe mesazhi që japin ato, është ndikimi i ndjenjave djallëzore dhe prirjeve të egos në zemrën e njeriut. Urtësia e krijimit të njeriut është adhurimi i Allahut; dhe kush-ti i parë i adhurimit, është besimi. Ndërsa qendra e besimit është zemra. Për besimin, zemra e njeriut është si një kala e fortifikuar. Ndërsa shejtani është një armik i përbetuar që kërkon të hyjë në atë kala dhe të shkaktojë dëme. Ashtu siç mbrohet kalaja prej armikut, duke fortifikuar dyert dhe mbyllur të çarat e saj, në të njëjtën mënyrë edhe mbrojtja e zemrës, që është kalaja e besimit të njeriut, bëhet duke njohur rrugët e hyrjes së shejtanit në zemër dhe duke i mbyllur ato. Të çarat që hapen në zemër, janë vendet ku shejtani u ngre kurth njerëzve. Shejtani, si një gjahtar zemre, hedh karremat e tij, si zemërimin, epshin, lakminë, dashurinë për paranë, dëshirën për post etj., duke planifikuar humbjen tonë. Ashtu si zogu që nuk mashtrohet nga karremi që ka vënë gjahtari dhe shpëton prej tij, ashtu edhe robi që nuk mashtrohet nga karremat e shejtanit, ushqehet në fushat e së vërtetës dhe jeton i lirë, duke mos u lidhur pas asgjëje të kësaj bote.

Kur njeriu shpëton njëherë prej kurthit të shejtanit, mirënjohja e tij ndaj Allahut është të mos hyjë më në fushën e atyre kurtheve. Madje, të mos u afrohet fare atyre. Vesveset që nxit shejtani për të prishur zemrën e robit, nuk janë vetëm epshi dhe dashuria për këtë botë. Ai gjithmonë përdor rrugë të ndryshme, sepse është betuar se patjetër do të marrë hak prej njeriut. Siç e mësojmë edhe prej Kuranit, shejtani pretendon se Allahu i Madhëruar e devijoi atë nga rruga e drejtë me anë të Ademit dhe për këtë arsye, ai kërkoi leje prej Allahut t'i zërë pritë njeriut në rrugën e drejtë, me qëllim që ta devijojë atë duke i ardhur nga para, nga mbrapa, nga e djathta dhe e majta. Allahu i Madhëruar, kërkesës së tij i përgjigjet në këtë mënyrë:

"Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë si shpërblim Xhehenemin; (ky është) një shpërblim i plotë. Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata! Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde! Bëhu pjesë në pasurinë e në fëmijët e tyre dhe jepu premtime! -Premtimet e shejtanit janë vetëm mashtrime. Por në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi!.."

Shtator 2020

VITI: XIV

NUMRI: 150

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



12

Virusi i egoizmit dhe shërimi i tij
Rabia Christine Brodbeck



Besimi ndaj Allahut
dhe pranimi i caktimit të Tij
Doç. dr. Harun Emysh

16



20



34

Lumturia Familjare - Të bëhesh nënë e krejt Umetit
Osman Nuri Topbash

- 5 Ruajtja e Zembrës
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 8 Rendi ynë i edukimit të njeriut
Prof. dr. Mehmet Gërmez
- 10 Ai që nuk interesohet
për të tjerët është i pafat
M. Lutfi Arslan
- 18 Portreti social i myslimanit
Xhafer Durmush
- 20 Bujaria në pasuri në jetë
dhe në çdo gjë tjetër
Sami Gëksyn
- 22 Metodologjia e arsyetimit të Kuranit
Ibrahim Arpaxhë
- 25 Fitimi hallall dhe haram
Irfan Ozturk




40

Jo vetëm një aspekt, 28
por të gjitha aspektet
Mustafa Kçyqkashçë
Një Ajet - Një Hadith 32

Të besosh 40
Ahmet Zijlan
Drejt asaj që duhet të realizohet 44
Idris Arpat
Tevekuli i Ibrahimit (a.s.) 46
Sezai Engin
Me zemër të pastër dhe faqe të bardhë 54
Selma Çevikollu
Vlera e leximit të Kuranit 56
Naim Drijaj

48



Flladi hyjnor, mëshira
Dr. Mustafa Xhanllë

Të mëshirshëm kundrejt myslimanëve
dhe të ashpër kundër armiqve të fesë
Prof. dr. Sulejman Derm

52





Ruajtja e Zemrës

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Në përgjithësi, emri shejtan përdoret për njerëzit, xhinët dhe kafshët e këqija.¹ Në Kuranin fisnik, fjalët shejtan dhe melek përdoren gjithsej 88 herë, si në shumës ashtu edhe në njëjës.²

Iblisi ose shejtani, ishte pjesëtar i një grupi të xhindëve, që ndodheshin pranë melekëve. Në Kuran tregohet gjatë e gjerë se kur Iblisi u sprovua me urdhrin e sexhdes ndaj Ademit (a.s.), ai refuzoi t'i bindej urdhrin dhe e humbi sprovën për shkak të mendjemadhësisë dhe smirës.³

Ajo që theksohet në këto ajete dhe mesazhi që japin ato, është ndikimi i ndjenjave djallëzore dhe prirjeve të egos në zemrën e njeriut. Urtësia e krijimit të njeriut është adhurimi i Allahut; dhe kushti

i parë i adhurimit, është besimi. Ndërsa qendra e besimit është zemra. Për besimin, zemra e njeriut është si një kala e fortifikuar. Ndërsa shejtani është një armik i përbetuar që kërkon të hyjë në atë kala dhe të shkaktojë dëme. Ashtu siç mbrohet kalaja prej armikut, duke fortifikuar dyert dhe mbyllur të çarat e saj, në të njëjtën mënyrë edhe mbrojtja e zemrës, që është kalaja e besimit të njeriut, bëhet duke njohur rrugët e hyrjes së shejtanit në zemër dhe duke i mbyllur ato. Sipas Gazzaliut, dyert dhe të çarat që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut mund të radhiten në këtë mënyrë:

1- Dera e parë dhe më e madhe nga ku hyn shejtani, është zemërimi dhe epshi. Zemërimi, pra nxehja apo nervozizmi, e nxjerrin mendjen jashtë loje. Dhe, kur mendja dobësohet, shejtani kalon në sulm. Ndërsa epshi dobëson forcën e vullnetit, duke i hapur rrugën shejtanit. Për këtë arsye, shejtani e mashtron më lehtë birin e njeriut kur zemërimi, urrejtja dhe epshi janë më të forta. Nëse e mbush barkun plot, qoftë edhe me ushqim hallall, kjo e shton epshin dhe e forcon pozitën e

1. shih. Isfahani, Mufreddat, fq. 383.

2. Iblis dhe shejtan, janë dy terma kuranorë që përdoren me kuptim të njëjtë. Iblis, do të thotë “i pashpresë” dhe vjen nga rrënja e fjalës “be-le-se”. Iblis nënkupton atë që i ka këputur shpresat nga Allahu. Kjo fjalë kalon 11 herë në Kuran. Kërkimi i mbrojtjes nga Iblisi, që e ka humbur shpresën tek Allahu, është një urdhër kuranor dhe po ashtu, nuk është rastësi që edhe ky urdhër kalon 11 herë.

3. shih. Bekare, 34-37; Araf, 11-22; Hixhr, 32-42; Isra, 61-66; Kehf, 50-51; Ta-Ha, 116-123; Sad, 74-83.

shejtanit, sepse ngrënia e tepërt e bën njeriun përtac, të rëndë dhe neglizhent ndaj namazit dhe përmendjes së Allahut. Zemërimi dhe epshi e shpjen njeriun në sjellje të urryera dhe përcmuese ndaj kundërshtarëve të tij. Dhe kjo e bën shejtanin ortak në punët e robit.

2- Dy dyer të tjera ku shejtani e hedh në kurth njeriun, janë smira dhe lakmia. Në fund të fundit, ajo që e çoi shejtanin në humbje, ishte smira. Ndërsa ajo që e nxori Ademin (a.s.), nga xheneti, ishte lakmia. Nëse njeriu e dëshiron shumë diçka, syri i tij nuk e sheh të drejtën dhe veshi i tij nuk e dëgjon të vërtetën. Ajo që e lajmëron njeriun për hyrjen e shejtanit në zemër, është drita e urtësisë. Mirëpo, lakmia dhe smira e verbojnë urtësinë. Kur njeriu verbohët, shejtani ndikon tek njeriu dhe ia zbukuron arritjen e dëshirës që ka.

3- Një prej dyerve që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut, është edhe pasioni i zbukurimit me mirësitë e kësaj bote. Kur shejtani e sheh tek dikush këtë sëmundje, kllon në zemrën e tij dhe fillon të thurë kurthe duke përdorur bukuritë tërheqëse të kësaj bote.

4- Një nga dyert më të mëdha nga ku shejtani hyn në zemër, është edhe ndjenja e pangopësisë. Nëse kjo ndjenjë mbizotëron në zemër, njeriu bëhet dyfytirësh dhe hileqar vetëm e vetëm për të arritur atë që dëshiron. Mirëpo, dyfytirësia dhe hilja, e shkatërrojnë edhe zemrën edhe punën e tij.

5- Një tjetër prej dyerve nga ku futet shejtani në zemër, është nxitimi. Maturia, marrja e vendimeve duke u menduar mirë dhe llogaritja e përfundimit, i zvogëlon mundësitë e gabimeve të njeriut. Në zemrën e njeriut, tek i cili ekziston vetëdija se ndjenja e nxitimit është prej shejtanit, ndërsa ndjenja e maturisë është prej Rrahmanit⁴, zgjerohet horizonti i meditimit e i përkujtimit dhe drita e urtësisë së tij i pakëson vendimet e gabuara.

6- Një prej dyerve që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut, është edhe koprracia dhe frika

nga varfëria. Këto ndjenja e pengojnë njeriun nga bamirësia dhe e nxisin atë të mbledhë sa më shumë pasuri. Ai orientohet drejt gjërave të kësaj bote, si mbledhja e floririt dhe argjendit. Mirëpo, mirësitë e kësaj bote që janë më tepër se nevojat, bëhen edhe qendra e veprimit të shejtanit.⁵

Allahu i Madhëruar i nxit robërit e Tij që në vend që të shpenzojnë pasurinë e tyre për t'u dukur, pa besuar në botën tjetër, ta shpenzojnë atë vetëm për hir të Allahut, duke e cilësuar shoqërinë me shejtanin një shoqëri shumë të keqe.⁶

Të çarat që hapen në zemër, janë vendet ku shejtani u ngre kurth njerëzve. Shejtani, si një gjahtar zemre, hedh karremat e tij, si zemërimin, epshin, lakminë, dashurinë për paranë, dëshirën për post etj., duke planifikuar humbjen tonë.

Ashtu si zogu që nuk mashtrohet nga karremi që ka vënë gjahtari dhe shpëton prej tij, ashtu edhe robi që nuk mashtrohet nga karremat e shejtanit, ushqehet në fushat e së vërtetës dhe jeton i lirë, duke mos u lidhur pas asgjëje të kësaj bote.

Kur njeriu shpëton njëherë prej kurthit të shejtanit, mirënjohja e tij ndaj Allahut është të mos hyjë më në fushën e atyre kurtheve. Madje, të mos u afrohet fare atyre. Vesveset që nxit shejtani për të prishur zemrën e robit, nuk janë vetëm epshi dhe dashuria për këtë botë. Ai gjithmonë përdor

rugë të ndryshme, sepse është betuar se patjetër do të marrë hak prej njeriut. Siç e mësojmë edhe prej Kuranit, shejtani pretendon se Allahu i Madhëruar e devijoi atë nga rruga e drejtë me anë të Ademit dhe për këtë arsye, ai kërkoi leje prej Allahut t'i zërë pritë njeriut në rrugën e drejtë, me qëllim që ta devijojë atë duke i ardhur nga para, nga mbrapa, nga e djathta dhe e majta.⁷ Allahu i Madhëruar, kërkesës së tij i përgjigjet në këtë mënyrë:

“Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë si shpërblim Xhehenemin; (ky është) një shpër-

Nëse njeriu e dëshiron shumë diçka, syri i tij nuk e sheh të drejtën dhe veshi i tij nuk e dëgjon të vërtetën. Ajo që e lajmëron njeriun për hyrjen e shejtanit në zemër, është drita e urtësisë.

4. shih. Tirmidhi, *Sunen*, Bejrut; Birr ve's- sila 65; Bejhaki, *Shuabu'l- iman*, Bejrut 1410, fq. 89.

5. shih. *Ihja ulumi'd-din*, Kairo, fq. 30-39.

6. shih. Nisa, 4/38-39.

7. shih. Araf, 7/16-17.

blim i plotë. Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata! Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde! Bëhu pjesë në pasurinë e në fëmijët e tyre dhe jepu premtimet e shejtanit janë vetëm mashtrime. Por në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi!..”⁸

Ajo që e hedh njeriun në kurthin e shejtanit, është mospërmendja e Allahut. Kush qëndron larg përmendjes së Allahut, sulmohet më lehtë nga shejtani. Edhe pse shejtani e devijon nga rruga e drejtë, ai pandeh se gjithçka është në rregull. Njeriu që është bërë shok me shejtanin, do ta kuptojë se sa shok i keq është ai, ditën kur të dalë përpara Allahut. Atë ditë ai do të thotë: **“Ah, sikur largësia midis meje dhe teje të kishte qenë sa ajo mes lindjes e perëndimit!”**. Por më kot, sepse në atë moment do të jetë shumë vonë.⁹

Shejtani vazhdimisht e sulmon njeriun dhe në një mënyrë apo në një tjetër, merret me të gjithë. Madje edhe Ademi (a.s.), me Havanë, për shkak të kurthit të tij u dëbuan prej xhenetit. Prandaj, të krekosesh duke thënë se “shejtani nuk më bën dot gjë”, është diçka pabazë dhe e pakuptimtë. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar shprehet se shejtani është munduar të ndërhyjë në çdo fjalë apo shpallje që u vinte pejgamberëve të tjerë para Pejgamberit tonë (a.s.).¹⁰ Në të njëjtin kuptim me këtë, edhe Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: **“Ndonjëherë më vijnë në zemër gjëra të tilla, sa që bëj istigfar (kërkoj falje) njëqind herë në ditë”**.¹¹

Egoja dhe shejtani e nxisin njeriun që edhe veptrat t’i bëjë për hir të dikujt tjetër e jo për hir të Allahut. Në këtë mënyrë, ato synojnë të dëmtojnë besimin e vërtetë në zemrën e njeriut. Besimi i dobët dhe miqësia me shejtanin, e fusin njeriun në vështirësi të mëdha. Në lidhje me këtë, Melvana i nderuar ka thënë:

8. Isra, 17/63-65.

9. shih. Zuhruf, 43/36-38.

10. shih. Haxhxxh, 52.

11. Ahmed b. Hanbel, *Musned*, Kairo IV, fq. 211.

“Shejtani është qen. Ai hyn brenda mijëra personave. Tek cilido që hyn dhe zë vend, ai person bëhet shejtan. Ajo që të ftoh prej Allahut e të vërtetës dhe të pengon nga adhurimi, është shejtani brenda teje. Ai është fshehur brenda në lëkurë. Nëse shejtani nuk e gjen njeriun shejtan që do ta ndihmojë, hyn në imagjinatën tënde dhe të shtyn në gjynahe. Ai të sjell vërdallë në botën e imagjinatës dhe të bën t’i ndjekësh ato. Pastaj, shejtani vjen dhe të merr çdo mirësi shpirtërore që ke arritur të mbledhësh prej namazit, agjërimit dhe çdo mirësie apo adhurimi që ke bërë.”¹²

Gjithmonë është diskutuar se; a janë egoja me shejtanin e njëjta gjë apo dy gjëra të ndryshme? Por me sa kuptohet, ato janë dy gjëra të ndryshme dhe që të dyja e ftojnë njeriun në vepra të këqija.


Mirëpo, shejtani është një ftues i jashtëm, që mundohet ta orientojë njeriun në punë të këqija i kamufluar në një personalitet të ndryshëm. Ndërsa egoja, është ndjenja djallëzore që e mbështet nga brenda këtë thirrje të jashtëme dhe shkon pas saj. Pra, ajo që e devijon njeriun nga brenda, është egoja. Kur egoja që mbizotëron robin devijon edhe të tjerët, atëherë ai bëhet shejtan. Shejtani është i përgjithshëm, kurse egoja është e veçantë për çdo person. Çdo ego ka një anë djallëzore, por është e pamundur ta cilësosh çdo shejtan si ego.

Zëri i brendshëm i çdokujt që thërret në të keqe, për vetë personin është ego, ndërsa për të tjerët është shejtan. Ky është kuptimi që nxirret edhe prej ajeteve dhe haditheve.

Njeriu punon dhe përpiqet në këtë botë. Prandaj, ai i ngjan prodhuesit që e mbush hambarin e tij me grurë. Mirëpo, prodhuesi që nuk e vë re miun që hyn në hambarin e tij, në fund ngelet duarbosh. Në të njëjtën mënyrë, nëse njeriu e lë shejtanin dhe egon t’i marrin zemrën, çdo punë e tij do të humbasë dhe do të ngelet duarbosh. Kështu që edhe kjo botë edhe bota tjetër kthehet në një humbje të hidhur. Allahu na ruajtë të gjithëve nga ky lloj përfundimi!

12. Mesnevi, III, b. 4326-4335.

Njeriu punon dhe përpiqet në këtë botë. Prandaj, ai i ngjan prodhuesit që e mbush hambarin e tij me grurë. Mirëpo, prodhuesi që nuk e vë re miun që hyn në hambarin e tij, në fund ngelet duarbosh.



Rendi ynë i edukimit të njeriut

— Prof. dr. Mehmet Gërmez —

Muhamedi (a.s.) është padyshim shembulli unik për të gjithë myslimanët në çdo kohë dhe në çdo shekull. E rëndësishme është të kuptojmë sa janë orientuar myslimanët drejt dritës së udhëheqjes së tij përgjatë historisë. Sa janë në gjendje ata t'i zbatojnë vlerat, parimet universale që Ai (a.s.) i solli njerëzimit.

Profeti i Islamit (a.s.), brenda një kohe të shkurtër, arriti të vendosë bazat e qytetërimit islam nga një shoqëri e njerëzve endacakë të shkretëtirës dhe të hidhte dritë në rrugën e shpëtimit të njerëzimit nga rrokullisja në humnerat pafund. Me pak fjalë, profeti Muhamed (a.s.) e ktheu shoqërinë e mohimit, idhujtarisë, urrejtjes dhe hakmarrjes në një shoqëri besimi, islami, dashurie, dashamirësie dhe mëshire.

Jetojmë në një kohë ku i gjithë njerëzimi po kalon sprova të vështira. Zhvillimet lokale rajonale dhe globale kanë shkaktuar shqetësime serioze si rrjedhojë e përbaljes në mënyrë të vazhdueshme të njerëzimit me vdekjen. Në mënyrë të veçantë, pakujdesia, mungesa e vëmendjes dhe ekuilibrit në marrëdhëniet midis myslimanëve është kthyer tashmë në një barrë të dhimbshme. Si pasues të rrugës profetike, jemi ngarkuar me përgjegjësinë e të qenit një ummet (bashkësi) i dobishëm për gjithë njerëzimin dhe busull orientuese drejt të vërtetës së pastër, drejtësisë dhe moralit të bukur, megjithatë, fatkeqësisht marrëdhëniet tona me njëri-tjetrin, me të tjerët, me gjënë e gjallë e jo të gjallë, madje me vetë jetën, lënë shumë për të dëshiruar.

Teksa përballë nesh qëndrojnë mesazhet universale, parimet unike të Kuranit Famëlartë dhe shembulli i pashoq i Profetit të mëshirës; në një kohë që Zoti ynë na ka urdhëruar t'i shërbejmë të vërtetës, drejtësisë, moralit dhe virtytit, ndërsa i Dërguari i Tij përmes traditës profetike na ka mësuar rrugën e duhur për të qenë njeri i mirë dhe i dobishëm, për

fat të keq sot bota islame është shumë larg “botës së Islamit”. Me keqardhje themi se gjeografia islame nga një hapësirë diturie dhe qytetërimi është shndërruar në një hapësirë zullumi dhe shtypjeje. Vendet islame nga vende të paqes, qetësisë dhe sigurisë janë shndërruar në vende të fitnes armiqësisë, dhunës dhe luftës. Ummeti islam është shumë larg vetëdijes së tevhidit, unitetit, bashkimit dhe vëllazërimit duke rënë në vorbullën e përçarjes, ndarjes dhe diskriminimit. Myslimanët janë larguar nga përbushja e detyrimeve të vëllazërimit mes njërit-tjetrit dhe kanë humbur vetëdijen dhe ndjeshmërinë e të qenit ummet i Muhamedit (a.s.). Medh’hebet, të cilat janë shkolla të civilizimit islam, kanë filluar të shihen si burim tensioni dhe konflikti. Myslimanët, të rënë pre e sëmundjes së racizmit, sektarizmit, grupimeve dhe xhemateve, i kanë kthyer këto përkatësi sipërfaqësore në identitet duke u përpjekur t'i rendisin këto të fundit para përkatësisë thelbësore që është vetë Islami. Sot, përfaqësimi i Islamit në botë synon të realizohet jo përmes rrugës së duhur, të bazuar në diturinë e saktë dhe në qytetërimin historik, por përmes lëvizjeve ekstreme të shfaqura në kohët moderne. Kjo gjendje dhe prirje që ka nisur të shkatërrojë një nga një tiparet bazike të qytetërimit islam është e papranueshme. Pa humbur kohë jemi të detyruar të përballemi me vetveten, të kompensojmë humbjet dhe neglizhencën tonë; të japim llogari në mënyrë serioze për këtë gjendje “të dhimbshme” që na bën të pyesim e të mendojmë të gjithëve: “Ku po shkojmë?” Sepse tërësia e njohurive të mbledhura në botën Islame në lidhje me marrëdhëniet fe-jetë, fe-politikë, fe-shtet, fe-njeri, nuk janë të mjaftueshme për t'i vendosur aty ku duhet këto marrëdhënie.

Parë nën këndvështrimin e të vërtetës hyjnore, njeriu lind (vjen) në këtë botë me një natyrë të pastër. Çdo individ në hapësirat e jetës ndërton identitetin dhe karakterin e tij duke qenë i hapur

për ndërveprime të ndryshme dhe duke lundruar midis burimeve të besimit, dijes dhe vlerave. Si rezultat, kur njeriu formon karakterin e tij, kur ai fillon të mbrojë zgjedhjet dhe prirjet e tij, kur arrin të jetë i qëndrueshëm në synimet dhe orientimet e tij, e gjen veten në botën vetjake të mentalitetit (koncepteve). Të gjitha këto zhvillime, procese, vijimësi ndryshimesh mund të përmbliken me fjalët: “rendi i edukimit njerëzor”.

Në fakt, “rendi i edukimit të njeriut” është qëllimi unik i çdo strukture që dëshiron të strukturojë, formojë dhe ndërtojë çdo person brenda sistematikës së vet, me pak fjalë, që pretendon të jetë e organizuar. Nisur nga kjo, është thelbësore të vlerësohen mekanizmat e edukimit njerëzor të botës në të cilën jetojmë dhe mentalitet që na rrethojnë të gjithëve. Institucionet formale dhe joformale, strukturat private dhe publike, manifestimet formale të sferës fetare, traditat, besimet, ideologjitë, synimet politike, formacione fetare dhe kulturore që ushqejnë strukturat e mentalitetit (mendësitë), tarikatet, xhematet, sistematika moderne e informacionit, dobësitë e interpretimit në orientimet kombëtare dhe fetare ndaj ndikimeve globale... Me pak fjalë është jashtëzakonisht e rëndësishme të rivlerësohen të gjithë këto elemente. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se dimensionet e civilizimit klasik islam të mbartura në këtë shekull janë dobësuar ndjeshëm; se është qëndruar larg institucioneve që ushqejnë tiparet themelore të qytetërimit tonë dhe se feja është kufizuar vetëm brenda për brenda xhamisë. Po kështu, që nga fillimi i shekullit që lamë pas, përhapja anë e kënd botës e sekularizmit, modernizmit, pozitivizmit, materializmit dhe individualizimit krijoi një situatë kaotike në lidhje me pozicionin që duhet të ketë feja, jo vetëm në gjeografinë islame, por në mbarë sipërfaqen e botës njerëzore. Nga ana tjetër specifikat e jetës në qytet dhe fshat sjellin me vete një lloj paqartësie në raportet që krijohen me fenë, lidhjen, marrëdhënien, afërsinë me të dhe pritshmëritë ndaj saj.

Sot duhet të ngremë pyetjet: Si po i edukojmë brezat tanë? Çfarë pritshmërie kemi ndaj tyre? Çfarë të ardhme na premton brezi që po edukojmë? Sa është i gatshëm brezi i ri të ndërtojë personalitetin me tipare të besnikërisë dhe idealit. A jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë tona në këtë drejtim? Për t’iu përgjigjur të gjitha këtyre pyetjeve në mënyrë të duhur, të drejtë dhe insistuese, së pari duhet të marrim parasysh kushtet që na rrethojnë, botën nga vijmë, gjuhën dhe ligjërimet që na ushqejnë, strukturat e mentalitetit në të cilat gjendemi vlerat dhe ligjërimet të cilat i japin peshë personalitetit dhe identitetit tonë. Ne jemi të detyruar të rishqyrtojmë mendësinë, rendin dhe të gjitha mekanizmat tona që prodhojnë dituri dhe vetëdije në lidhje me edukimin

e njeriut. Në këtë kontekst, duhet të rivlerësojmë të gjitha institucionet që ofrojnë arsim fetar, medresetë, universitetet islame, fakultetet teologjike, shkollat fetare, kurrikulat dhe programet e tyre, konceptin si duhet edukuar një studiues. Me pak fjalë, është e nevojshme të rishqyrtohet ç’formë e islamit u mësohet njerëzve dhe mënyra si u mësohet atyre kjo fe në shkolla, fakultete, institucione arsimore formale dhe joformale, xhami, kurse, organizata vullnetare dhe joqeveritare, fondacione dhe shoqata, shtëpi studentore, konvikte, shtëpi, lagje, në masmedia, në shtypin e shkruar, atë vizual, apo në mediat sociale. Kjo është një çështje që duhet trajtuar me shumë rigorozitet, në mënyrë që gjeneratat tona të ardhshme të mos formohen me një koncept të gabuar në lidhje me fenë së drejtës, Islamin. Sepse, si myslimanë, me të drejtë do të dëshironim të ishim të zotët e fjalës në lidhje me rrjedhën e ngjarjeve në botë. Ne nuk jemi thjesht kureshtarë të dimë ç’botë i pret fëmijët tanë, rininë dhe brezin e ardhshëm, por kërkojmë të gjurmojmë dhe të gjejmë gjithçka në lidhje me të. Duam ta mposhtim presionin shtytës së një bote të shpejtë dhe brutale. Po ashtu duam që marrëdhëniet midis trinomit njeri, univers, Krijues të jenë aty ku duhet. Duam që mësimi i tevhidit (njësisë), profetësisë, konceptimi i kësaj bote dhe asaj të përtejme të jenë në mënyrën e duhur. Përpiqemi t’ua mësojmë njerëzve të drejtën si të drejtë, dhe të shtrembrën si të shtrembër. Ne përpiqemi gjithmonë që parimi i drejtësisë të mbizotërojë dhe bëjmë çmos të eliminojmë të gjitha llojet e mizorive dhe padrejtësive. Brenda kornizës së përgjegjësive që Kurani Famëlartë i ngarkon secilit prej nesh, përpiqemi të kundërshtojmë të keqen dhe të mbështesim të mirën dhe të vërtetën në përputhje urdhrin kuranor “*emri bil maruf nehji anil munker*” (Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.) Të gjithë duam të jetojmë në një shoqëri ku mbizotëron paqja dhe mirëqenia në përputhje me besimin dhe rrugën e duhur ndaj së cilës është i kënaqur Krijuesi i Gjithësisë.

Sot, për të përmbushur këto qëllime dhe detyrime, kemi nevojë të rishikojmë dhe rishqyrtojmë në mënyrë rigorozë çdo fazë të “rendit të edukimit njerëzor”. Evidentimi i gabimeve në këtë rrugëtim, vlerësimi i natyrës dhe kostos së tyre do të shërbejë për të na hapur horizonte të reja.

Si përfundim, jemi të detyruar të pyesim me zë të lartë përse fetarizmi ynë në vend që të jetë burim morali dhe drejtësie, prodhon përçarje dhe tension; përse dashuria për Profetin në zemrat tona është e pamjaftueshme t’i japë fund urrejtjes dhe zemërimit midis nesh; përse besimi ynë është aq i mangët sa nuk mjafton të përmbushë detyrimet ndaj vëllazërimit, moralit dhe drejtësisë; me pak fjalë kemi nevojë t’i qasemi ndryshe “rendit të edukimit njerëzor.”

Përktheu nga turqishtja: msc. Elona SYTARI



Ai që nuk interesohet për të tjerët është i pafat

— M. Lutfi Arslan —

Ai që u shërben të tjerëve dhe e konsideron këtë si një mundësi për ta falënderuar Zotin (xh.sh.), do të thotë se e ka gjetur rrugën e duhur drejt pafundësisë. Kurdo që i japim përparësi vetes sonë, atëherë fillon edhe ngushtimi në zemër. Kur zemra fillon të ngushtohet, lihemi në dorë të nefsit tonë. A ka më keq se ai që lihet në dorën e nefsit të tij? Sa fatkeq është ai që nuk interesohet përveçse për veten e tij!

Kur i riu u ngrit atë ditë i shqetësuar, mendoi se brenda kishte një ngushtim prej një kohe të gjatë.

“U bënë shumë kohë që nuk shkoj te i urti. Mos vallë po më ndodh nga kjo?”

Ai nuk kishte asnjë mendim se përse nuk kishte shkuar, por nga brenda nuk i vinte për të shkuar. Këtë nuk mund ta shpjegonte në asnjë mënyrë. Në të vërtetë, shumë herë pati bërë plane për të shkuar, por asnjëherë nuk arriti t'i realizonte.

Befasisht ndodhi diçka. Menjëherë u ngrit nga vendi dhe u përgatit shpejt. Ndërkohë nuk arrinte ta shpjegonte se çfarë po bënte dhe përse po e bënte. Në fakt, këtë nuk e kishte aspak si qëllim.

Pas pak gjendej pranë të urtit. Kur i urti e pa, vetëm buzëqeshi. I tregoi vendin për t'u ulur dhe përsëri u kthye te libri në të cilin zhytej plotësisht.

Ndërkohë që i riu po e shikonte atë, filloi të kontrollonte pak veten e tij. Tashmë nuk kishte ngelur ndonjë gjurmë nga ajo gjë që ia gërvishte zemrën, që ia dridhte atë si bishti i nepërkës dhe që ia bënte të dyshonte. Ndoshta një çast u mahnit, deshi të kërkonte ndonjë shpjegim, madje deshi ta kapte dhe ta pyeste. Por pastaj hoqi dorë fare dhe nuk e bëri diçka të tillë. “Kjo është tërheqja e gjakut.” – tha dhe ia la veten rrymës së ujëvarës që filloi të rridhte në brendësinë e tij.

Më vonë, pas asaj ndarjeje të gjatë, befasisht do t'i thoshte se nuk mund t'i shpjegonte aspak ato

që gjeti pranë të urtit. Sa shumë luftëra ndodhnin brenda tij kur ishte larg të urtit! Sa shumë beteja pati bërë mendja me zemrën e tij! Këtë e dinte vetëm ai. Kur qëndronte vetëm, mendonte se mendja e tij fitonte në të gjitha këto luftëra.

“Ja, për këtë arsye nuk mund të shkoj...”

Por kur befas u ngrit e iku dhe kur mendja e çdo gjë që më parë pati fantazuar nuk e ndaluan dot, çdo gjë u kthye ndryshe. Në të vërtetë, kush ishte ai që kishte fituar këtu? Lëreni fare se kush kishte fituar, në të vërtetë, ishte mendja e tij ajo që kishte humbur. Si mund ta shpjegonte në një mënyrë tjetër këtë ardhje që ia shkatërronte të gjitha ato mendime e fantazi që pati bërë më parë? Aty kishte diçka që e kalonte atë. Diçka tjetër përtej thirrjes... Diçka që nuk e njihite aspak vullnetin dhe që vinte duke gufuar nga zemra...

Një herë deshi t'i thoshte vetes: “Mos vallë duhet të më shpien dhe të më vendosin në vendin që duhet të gjendem? Nuk jam i sigurt...” Me të vërtetë nuk ishte i sigurt, sepse nuk arrinte dot t'ia dilte mbanë sado që përpiquej ta shpjegonte. Nuk arrinte t'ia dilte mbanë, sepse nuk mund të bënte dot përkufizimin e duhur. Kërkimi i fjalëve për ato që kishte përjetuar dhe për ato gjëra që kishte arritur me eksperiencë, ishte sikur të ecte lakuriq ndërmjet njerëzve për të kërkuar rroba. Ndër të tjera, ajo që kishte gjetur nuk i tregonte gjë dhe e mashtronte. Në ato momente iu kujtua përsëri diçka që kishte dëgjuar nga i urti:

“Kur bëhet fjalë për të vërtetën, fjalët nuk mund ta shpjegojnë, por vetëm mund ta shikojnë...”

Pasi i riu kishte në sytë dhe në zemrën e tij të urtin, i urti e filloi fjalën sikur e dinte sa çfarë po mendonte i riu. I ngriti vetullat, kokën e uli pak dhe po e shikonte përmbi syzet e tij:

-Ku ke humbur?

I riu e uli kokën, ngaqë u turpërua dhe i tha:

-Nuk arrita të vija në asnjë mënyrë.

-Mos vallë nuk deshe të vije?

-Në të vërtetë desha, por...

-Domethënë, nuk deshe që të donte Ai...

I riu e ngriti kokën i mahnitur. I urti buzëqeshi nga kënaqësia që i dha reagimi që priste nga i riu dhe i tha:

-Ne nuk mund të duam pa dashur Ai. Për këtë arsye, nëse duam të bëjmë diçka, duhet të duam që të dojë Ai. Ne kësaj i themi qoftë e hajrit. Gjëja më e hajrit është ajo që do Ai.

Heshti, sepse nuk donte të fliste më shumë në lidhje me këtë çështje. Andaj mendonte se ky nuk ishte fati i asaj dite. Të gjithë kanë mundësi për të folur sipas kohës, kapacitetit dhe fatit të tyre. Siç përgatitet kështu dhe na vendoset përpara me anë të dikujt, edhe mundësitë për të folur na vijnë me mënyra të caktuara. Edhe fjala do përpikëri dhe mjeshtëri si një gjellë e gatuar mirë. Ushqimet duhet të zgjidhen mirë, duhet të përgatiten mirë, duhet të gatohen mirë dhe duhen servitur me rregull. Njerëzit që gatuajnë fjalët duhet të jenë njerëz specialistë në lidhje me përdorimin e fjalëve. I riu gjithmonë pati dashur ta kishte një aftësi të tillë. Në të vërtetë, a nuk është sugjerim i të Dërguarit të Allahut (a.s.), që t'u flasim njerëzve aq sa mund të perceptojnë?

I urti më shumë ishte i shqetësuar për qëndrimin e gjatë larg tij që i riu kishte bërë:

-Nuk munde të vije, sepse gjithmonë nuk kemi mundësi të vijnë e të shkojmë. Nganjëherë zemra na zgjerohet aq shumë, saqë mund ta nxërë të gjithë botën brenda. Ndërsa nganjëherë ngushtohemi aq shumë, saqë nuk mund të nxëmë brenda as veten tonë.

I urti e pa të riun sikur po maste masën e ndikimit të fjalëve të tij te ai. Kureshtja që e kishte kapluar të riun, dukej qartë në fytyrën e tij.

-Ti nuk mund t'ia caktosh erës drejtimin në të cilin duhet të fryjë, por mund të caktosh ndikimin që ajo mund të të lerë.

I riu nuk ishte shumë i sigurt për këtë. Kur dëgjon-te diçka që mendja nuk ia pranonte, nuk mund ta ndalonte vrenjten e fytyrës. Përsëri kështu ndodhi. Kjo nuk i iku as të urtit pa e parë:

-E rëndësishme nuk është se kush do të vijë, por si do të na gjejë ai që do të vijë. Vullneti ynë nuk mund ta caktojë atë që do të vijë, por mund të caktojë se si do të sillemi ndaj atij që do të vijë. Nëse i kemi në dorë frenat e vullnetit tonë, mysafiri, qoftë i mirë apo i keq, vjen me të mirë, ndjehet mirë përgjatë qëndrimit dhe largohet i lumtur. Nëse i mbajmë në dorë frenat e vullnetit, vjen një ditë dhe na jepet

mundësia për të zgjedhur ngushtimin apo zgjerimin e zemrës sonë.

I riu e ktheu kokën lehtë nga ana e djathtë. I urti i buzëqeshi kësaj lëvizjeje që do të thoshte “nuk e kuptova” dhe tha:

-Sigurisht që është ashtu. Ti mund ta zgjedhësh edhe ngushtimin, edhe zgjerimin e zemrës. Mjafton që ta sundosh vullnetin tënd. Çdokush që të vjen, konsideroje sikur të vjen nga Ai. Andaj, atë që të vjen nga Ai, respektoje siç duhet respektuar. Mos e prish ekuilibrin ndaj asnjë mysafiri, sepse ne nuk mund ta dimë se te cili është mirësia.

Ai e ngriti dorën dhe ia vendosi te kraharori:

-A do më pyesësh se çfarë preferoj unë?

I riu u bë kureshtar. Ndërkohë që po thoshte “po” me lëvizjen e kokës, edhe po buzëqeshte. I urti vazhdoi:

-Unë e përdor ngushtimin ndaj vetes sime, ndërsa zgjerimin e përdor për të tjerët. Prandaj preferoj të jem i ngushtuar kundrejt vetes sime dhe i hapur kundrejt të tjerëve.

Kur i riu habitej, gjithmonë belbëzonte pak. Përsëri kështu ndodhi:

-Si, si arrini ta bëni këtë?

-Kur fryn era e ngushtimit të zemrës, e di se ka ardhur koha e marrjes së vetes në llogari. Andaj, menjëherë kthehem dhe e marr veten në llogari. Nëse zemrën e kam të ngushtë, patjetër që kam gabuar ndaj dikujt ose kam bërë ndonjë gjë gabim. Kështu që kërkoj falje, sepse kjo është koha kur duhet të qëndroj me veten dhe kur duhet t'i përgjërohëm Allahut të Lartësuar.

-Po kur e ndjeni zemrën të zgjeruar?

-Atëherë është koha e falënderimit dhe shërbimit. Kështu që i gëzoj të tjerët, u jap dhe i ndihmoj. Kjo është koha kur duhet t'i ndihmoj të tjerët dhe të falënderoj Allahun e Madhëruar.

Kur i riu po largohej nga i urti, po mendonte se përse nuk mund ta dimë kur dhe si mund të fryjë era. Papritur ndjeu një lëvizje nga brenda, mendja iu ndriçua dhe hapat filloi t'i hidhte më shpejt prej emocionit që i jepte arritja e perceptimit të një gjëje të re. Atë ditë shkroi këto rreshta në ditarin e tij:

“Nëse shërbimi ndaj njerëzve dhe falënderimi ndaj Allahut Teala bëhet vazhdimisht, edhe zemra vazhdimisht do të jetë e zgjeruar dhe e lumtur. Si rezultat, gjithmonë vazhdon të hapet. Ai që u shërben të tjerëve dhe e konsideron këtë si mundësi falënderimi ndaj Allahut të Madhëruar, do të thotë se e ka gjetur rrugën e hapjes drejt pafundësisë. Kurdo që i japim përparësi vetes sonë, atëherë fillon edhe ngushtimi i zemrës. Kur zemra fillon të ngushtohet, lihemi në dorë të nefsit tonë. A ka më keq se ai që lihet në dorë të nefsit të tij? Sa fatkeq është ai që nuk interesohet përveçse për veten e tij!”



Virusi i egoizmit dhe shërimi i tij

— Rabia Christine Brodbeck —

AI NJERI QË NUK KA MORAL, ËSHTË I PRIVUAR NGA MIRËSIA E ZOTIT.

Mevlana ka një këshillë madhështore kundrejt skenarëve që po përjetojmë sot: “Le t’i lutemi Zotit që të na japë moral. Ai njeri që nuk ka moral, është i privuar nga mirësia e Zotit. Ai që nuk ka moral, nuk i bën keq vetëm vetes së tij. Ndosh-ta mund të djegë të gjithë botën. Çdo vështirësi apo fatkeqësi që i ndodh, i vjen nga paturpësia dhe arroganca. Ky qiell është ndriçuar në sajë të moralit. Edhe engjëjt janë të pafajshëm dhe të dëlirë për shkak të moralit.”

Sot po dëshmojmë një mbrapshti të madhe. Shekulli ynë është shekulli i komunikimit, por komunikimi ndërmjet njerëzve është prishur dhe është shkëputur. Në këtë mënyrë, jemi bërë të huaj për njëri-tjetrin, e keqkuptojmë njëri-tjetrin, flasim gjuhë të ndryshme, debatojmë me njëri-tjetrin, kërcënojmë dhe sulmojmë. Ndërmjet nesh ka përplasje, luftë, kontradikta dhe divergjencja. Jemi bërë armiq me njëri-tjetrin. Nuk e përshëndesim njëri-tjetrin. Nuk dëshirojmë ta duam njëri-tjetrin. Nuk duam ta ndihmojmë, t’i shërbejmë dhe ta frymëzojmë njëri-tjetrin. I kemi humbur cilësitë njerëzore dhe i kemi shkullur nga zemra tona ndjenjat humane. Ndjenja e miqësisë dhe shoqërisë është prishur. Shkurtimisht, kemi humbur njerëzillëkun tonë. Siç thotë edhe Mev-

lana, kemi humbur “moralin”, i cili është veçoria njerëzore më e vlefshme. Dhe si rezultat, po e djegim të gjithë botën.

Sot anëtarët e xhematëve thonë: “Hoxha im, xhemati im, revista që nxjerr unë, vakëfi im, shtëpia e fëmijës apo azili që kam bërë unë...”, domethënë, kur thuhet “unë apo ne”, hyn ndjenja e egoizmit. Feja islame është feja e bashkimit. Arti ynë më i madh është të duam për hir të Allahut dhe të jetojmë për hir të Allahut. Përderisa të mos e mësojmë këtë, nuk do të fitojmë asnjë gjë.

Punët shkojmë mbrapsht, sepse çdo gjë e bëjmë për interes. Çfarë mund të kuptojmë nga dashuria që Aliu, Ebu Bekri, Hatixhja, Nesibja, Hamzai, Bilali dhe Shemsi ndjenin për Pejgamberin tonë të nderuar, Muhamed Mustafanë (a.s.), pasi të mbytemi në marrëdhëniet e interesit? Miqësi nuk mund të ketë pa e dashur, pa i shërbyer, pa u bërë shembull dhe pa i dhënë përparësi njëri-tjetrit më shumë se vetes sonë. Sot bëhen shumë seminare, simpoziume dhe programe televizive rreth miqësisë. Ne nuk mund ta kuptojmë njëri-tjetrin ndërkohë që jemi shumë larg. Si mund të bashkohemi me rrymën e dashurisë së evlijave nëse nuk duam, nëse nuk i ndajmë mirësitë hyjnore të Krijuesit tonë të Lartësuar dhe, nëse nuk i ndajmë me të tjerët frytet e perceptimit nëpër kuvendet fetare të cilat i frekuentojmë?

Neve na ka hyrë një virus. Virusi i egoizmit. Si mundet? Bota na ka vënë në gjumë me narkozë. Por feja islame ka një moral të mrekullueshëm kundër virusit të egoizmit. Për shembull, myslimanët u japin përparësi nevojave të vëllezërve të tyre edhe nëse vetë kanë shumë nevojë. Ata e shikojnë më të rëndësishme dhimbjen e vëllezërve të tyre se sa dhimbjen e vet. Ebu Bekri (r.a.), i cili gjendej në kulmin e sakrificës dhe flijimit, thotë: “Bujaria e vërtetë është të vuajturit për të shuar vuajtjet e të tjerëve.” Ehli Bejti dhe sahabët e nderuar ishin në kulmin e sakrificës së vetes. Ata të gjithë patën thënë me një zë dhe më gjithë shpirt: “Nëna, babai, fëmija, pasuria, pozita dhe jeta ime të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut!” Allahu Teala thotë në Kuranin Famëlartë: “Pejgamberi është më i afërt për besimtarët se sa ata për vetë njëri-tjetrin...” (Ahzab,

6) Përderisa të mos e duam të Dërguarin e Allahut

(a.s.), më shumë se veten tonë, besimi ynë nuk do ta arrijë pjekurinë. Ne jemi bërë robër të kësaj bote. Pse? Sepse nuk përpiqemi ta edukojmë veten tonë.

Allahu (xh.sh.), nuk e lëshon mëshirën pa pasur përpyetje në pah. Ne mendojmë se çdo gjë është falas.

Për këtë arsye, nuk agjërojmë kur agjërojmë. Nuk japim zekat kur japim zekat. Nuk shkojmë në haxh kur shkojmë në haxh. Nuk falim namaz kur falim namaz. Për fat të keq, nuk jemi bërë njerëz dhe nuk kemi lënë paqe në këtë botë. Ndërkohë feja islame u mëson njerëzve mirësinë, universalitetin dhe dashurinë e pakufishme që i përfshin të gjithë. Feja islame është feja e dashurisë. Ajo nuk bën ndarje kombi, race, shoqërie, pozite apo vendi ndërmjet njerëzve. Por për fat të keq, ne nuk kemi luftuar dot. Ndërkohë, lufta në rrugë të Allahut është borxh për ne, sepse ne jemi mëkëmbësit e Rahmetun li'l-aleminit. Ne e kemi detyrë të përpiqemi dhe të luftojmë në rrugë të tij. Por për fat të keq, nuk jemi bërë dot umet i tij. Ndërkohë, ata që i besojnë fesë së tevhidit

janë si një familje e vetme, një shoqëri e vetme dhe një trup i vetëm. Të gjithë ne jemi nipat e Ademit dhe fëmijët e Habil, të cilët ishin përfaqësues të tevhidit. Ne mbartim përgjegjësinë e të qenit robër ndaj Allahut dhe jemi krijesa që engjëjt na kanë bërë sexhde. Jemi nipërit e Ibrahimit (a.s.), i cili hodhi themelet e shtëpisë së besimit. Por për fat të keq, nuk kemi arritur dot ta kuptojmë martirizimin e Hysejnit dhe Hamzait. Nuk kemi arritur dot ta kuptojmë vullnetin sublim që shfaqën trimërisht në flijimin e jetëve të tyre. Në vend të këtyre, po besojmë se do të hyjmë në xhenet pa u marrë në llogari, duke u bërë një bombë e gjallë për të vrarë popullin civil e të pafajshëm në vendet plot njerëz si tregjet. Cilin obligim s'po e kryejmë dot që këto bomba bien në botën islame?


Bota islame është në pikë të hallit. Ne nuk po e marrim për shembull Pejgamberin

(a.s.), i cili kërkonte nga Zoti udhëzim, mëshirë, falje dhe mirësi për umetin e tij dhe i cili ishte dërguar mëshirë për botët. Ndërkohë, jemi pasues të fesë së Rahmetun li'l-aleminit. Allahu i Lartësuar e ka dërguar të Dashurin e Tij, Muhamedin (a.s.), me një

qëllim të vetëm: Që të jetë mëshirë për botët! Tashmë myslimanët nuk e shohin si udhëzues të tyre moralin e Pejgamberit, Muhamed Mustafasë (a.s.) dhe nuk përpiqen për të ecur në gjurmët e tij. Për shkak të kësaj, po dëshmojmë një kohë në të cilën ka degjenerim, keqpërdorim, mashtrim, padrejtësi, kolonizim, agresion, militantizëm, dhunë, terror dhe shkatërrim. Në këtë mënyrë, humbet thesari i të qenit afër me Zotin e botëve dhe me Pejgamberin e Tij, që e pati dërguar si mëshirë për botët. Kjo humbje do të thotë që mineralet e dashurisë, të cilat janë brenda jetës sonë, të ngelin të mbuluara përgjithmonë dhe të mos e arrijmë gradën e njeriut.

Nëse i krahasojmë njerëzit e shoqërive moderne me brezat e tyre paraardhës, do të shohim se janë





Njëra prej mangësive me të mëdha që ka sot bota islame, është se myslimanët nuk e përjetojnë të vërtetën që thuhet në hadithin fisnik: “Besimtari është pasqyra e besimtarit.” Vetëm pasi të bëhemi pasqyrë për njëri-tjetrin mund të realizohet kalimi i dritës hyjnore nga zemra në zemër. Feja islame përfaqëson dashurinë pa interes që arrin pikën më të lartë ndërmjet dy zemrave.

të zhytur në batakun e një injorance shumë më të madhe, janë shumë të shkapitur, të privuar nga frymëzimi shpirtëror dhe begatia e Allahut dhe e të Dashurit të tij. I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka njoftuar që shumë kohë më parë për këtë gjendje: “Ju do të shkoni pëllëmbë për pëllëmbë dhe centimetër për centimetër në rrugën e atyre para jush, saqë nëse ata hyjnë në vrimën e një zvarraniku helmues, edhe ju do të hyni pas tyre.” Në ditët e sotme kemi një largësi dhe shkapitje të tmerrshme me njëri-tjetrin. Pothuajse po jetojmë siç thuhet në ajetin e Kuranit Fisnik:

“...Njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.” (Abese, 34-36) Vetën duhet ta pyesim: A nuk po e përjetojmë Ditën e Kiametit tani? Njerëzia vazhdimisht përballet me një kalbje, shkatërrim dhe vdekje më të madhe. Sot po përhapen fatkeqësitë më të mëdha njerëzore. Po përjetohe falimentime në dimensionet morale, politike dhe ekonomike.

Në çdo dimension po shikojmë se vlerat janë kthyer përmbys. Përplasjet ndërmjet medh’hebeve po i copëtojnë lidhjet vëllazërore dhe shpirtërore. Në botën islame ka hyrë një virus. Ka hyrë virusi i ndarjes dhe copëtimit. Njerëzit po e shkatërrojnë njëri-tjetrin.

Njëra prej mangësive me të mëdha që ka sot bota islame, është se myslimanët nuk e përjetojnë të vërtetën që thuhet në hadithin fisnik: “Besimtari është pasqyra e besimtarit.” Vetëm pasi të bëhemi pasqyrë për njëri-tjetrin mund të realizohet kalimi i dritës hyjnore nga zemra në

zemër. Feja islame përfaqëson dashurinë pa interes që arrin pikën më të lartë ndërmjet dy zemrave. Umetit të Muhamedit i është dhënë mirësia për ta përjetuar në formën më të lartë hadithin profetik: “Besimtari është pasqyra e besimtarit”.

Drita hyjnore e Allahut bashkohet me dritën e nefsit të dëlirë. Ja, bashkimi i dy dritave do të thotë dritë mbi dritë. Njeriu arrin ta njohë veten e tij nga pasqyra hyjnore që ka në zemër. Në pasqyrën e ekzistencës së tij, njeriu njeh Zotin, veten e vet dhe krijesat e tjera. Vetëm se kjo ka një kusht: Pasqyra e zemrës duhet të jetë e pastër. Ndriçimi i pasqyrës së sinqeritetit fillon të reflektojë pafundësinë e të fshehtave hyjnore. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Zemra (e Muhamedit) nuk gënjen për atë që ka parë.” (Nexhm, 11) Nga vjen frymëzimi hyjnor? Vjen nga bashkimi dhe dashuria. Nga mund ta marrim kënaqësinë dhe lumturinë më të madhe? Nga Bejtullah, sepse ajo është shtëpia e Allahut. Atje përjetojmë të vërtetën: “Besimtari është pasqyrë e besimtarit.” Ndriçimi i pasqyrës së sinqeritetit na e reflekton pafundësinë e të fshehtave hyjnore.

Si një person që kam studiuar gjendjen aktuale të shoqërive moderne, besoj se njerëzit, me të gjitha tezat e tyre logjike, mendimet dhe këndvështrimet racionaliste, duhet t’i lënë mënjanë problemet politike, sociale e juridike dhe qasjet e tyre të kufizuara me logjikë dhe t’i drejtohen udhërrëfyesit tonë sublim, Muhamedit (a.s.). Tashmë është koha për t’i lënë mënjanë debatet që s’kanë fund.

Bindja ndaj Profetit (a.s.), NËN DRITËN E AJETEVE TË KURANIT

— Dr. Kerim Bulladë —

Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është farz për të gjithë besimtarët. Në Kuranin Fisnik theksohet qartazi se bindja ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është e domosdoshme. Në shumë ajete, pasi Allahu Teala urdhëron bindjen ndaj Tij, kërkon që besimtarët t'i binden edhe të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kurani nuk e ka ndarë bindjen ndaj Allahut me bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai e ka pranuar bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), si bindje ndaj Allahut të Lartësuar. Përveç të tjerash, kundërshtimin që mund të bëhet ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), e ka pranuar si kundërshtim ndaj Tij. Në lidhje me këtë çështje, në Kuranin Fisnik thuhet: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.”** (Nisa, 80)

Allahu Teala ka urdhëruar bindjen ndaj të Dërguarit të Tij (a.s.). Nëse dikush i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.), i është bindur Allahut Teala, sepse ai që i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.), ka zbatuar urdhrin e Allahut të Madhëruar. Në një ajet thuhet: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.”** (Nisa, 59) Siç shikohet, Allahu Teala e ka bërë prej kushteve të besimit bindjen ndaj Pejgamberit (a.s.). I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëron bindje vetëm ndaj Allahut Teala. Për këtë arsye, nëse dikush i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe e zbaton urdhrin e tij, i është bindur Allahut, azze ve xhelle. Sipas disa transmetimeve, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë kur ka qenë në Medine: **“Kush me do mua, do Allahun. Kush më bindet mua, i bindet Allahut.”** (Buhari, Ahkam, 1; Muslim Imaret, 32-33) Kur politeistët e akuzuan të Dërguarin e Allahut (a.s.), në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala zbriti këtë ajet me synimin për ta vërtetuar fjalën e Pejgamberit: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.”** (Nisa, 80)

Në lidhje me çështjen e bindjes për të cilën bëhet fjalë në ajet me shprehjen: “Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij!..”, është bërë një shpjegim i tillë: “Bindjuni Allahut në gjërat që janë farz dhe bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që janë sunet.” Ndërsa edhe një shpjegim tjetër është kështu: “Bindjuni Allahut për gjërat që ka urdhëruar dhe ndaluar në Librin e Tij. Bindjuni të

Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka urdhëruar dhe ndaluar në Sunetin e tij. Bindjuni Allahut në çështjet që ka urdhëruar dhe bindjuni të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka predikuar.”

Besimtarët e kanë obligim t'i binden të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çështjet që ka shpjeguar, predikuar, urdhëruar, zbatuar dhe aprovuar, sepse çdo gjë që ai ka thënë apo çdo gjë që ka bërë në lidhje me fenë, është thënë dhe është bërë nën mbikëqyrjen e revelatës hyjnore. Specifika më e rëndësishme që Kurani e kërkon nga ata që i besojnë Allahut dhe ahiretit është që ta marrin për shembull Pejgamberin. **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21) Nëse besimtarët nuk i binden të Dërguarit të Allahut (a.s.), e kanë të pamundur ta marrin për shembull dhe ta pranojnë si të tillë atë. Ai që e do atë, i bindet, i jep besën dhe ecën në rrugën e tij. Pa iu bindur atij dhe pa e zbatuar sunetin e tij, nuk mund të arrihet dashuria ndaj tij.

Në ajete të ndryshme Allahu i Lartësuar shprehet se ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij do të korrin një sukses të madh, do të shpëtojnë dhe do të fitojnë xhenetin:

“Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë.” (Nur, 52) **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t'ju bekojë veprat tuaja dhe do t'ju falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”** (Ahzab, 70-71) **“Nuk është gjynah për të verbrin, as për të çalin, as të sëmurin (që të mos marrin pjesë në luftë). Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm.”** (Fet'h, 17)

Siç kuptohet plotësisht qartë nga ajetet e mësipërme, besimtari mund të korë sukses në këtë botë provizore dhe mund të fitojë lumturinë e përhershme në ahiret vetëm duke iu bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Jeta islame nuk mund të imagjinohet pa bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), domethënë, duke e përjashtuar Sunetin e Pejgamberit. Kurani Fisnik kuptohet dhe shndërrohet në një libër jetësor në sajë të Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).



BESIMI NDAJ ALLAHUT DHE PRANIMI I CAKTIMIT TË TIJ

— Doç. dr. Harun Ĕmysh —

besimtarët nga vija e Kuranit dhe Sunetit. Nuk ka asnjë besimtar që nuk e brenkos kjo plagë dhe kjo fatkeqësi që është përhapur ndërmjet myslimanëve dhe që vazhdon të thellohet pa reshtur. Shpëtimi i myslimanëve nga kjo traumë e rëndë do të arrihet vetëm nëse ata do t'i kthejnë përsëri në jetë rregullat që ka vendosur Kurani dhe Suneti.

Përgjatë gjithë historisë ka pasur prej atyre që e kanë xhelozuar jetën e lirë, të qetë dhe të sigurt të besimtarëve të Kuranit nga aspekti ekonomik, financiar, social dhe kulturor. Ata që kanë shpirt kolonizues dhe që u kanë ngulur sytë pasurive të nëndheshme e të mbidheshme të tjerëve duke i shtypur, në mënyrë që popujt e tyre të jenë sa më rahat, gjithmonë kanë ekzistuar. Këtë të vërtetë Kurani e ka theksuar që para pesëmbëdhjetë shekujsh dhe i ka paralajmëruar besimtarët në lidhje me këtë çështje e i ka udhëzuar:

“Nëse ty të vjen ndonjë e mirë, ata hidhërohen; nëse të godet ndonjë e keqe, ata thonë: “Sa mirë që i morëm masat që më parë” dhe largohen të gëzuar.” (Teube, 50)

Kur fjala “hasene”, e cila përmendet në ajet, të vlerësohet duke e shtjelluar ajetin para dhe pas saj, do të thotë pasuri dhe fitore. Ndërsa fjala “sejje” do të thotë mposhtje dhe humbje.² Por në kuptimin e përgjithshëm, fjala “hasene” shpreh çdo mirësi, çdo nimet dhe çdo punë të mirë që njeriu e arrin në veten, trupin, gjendjen e sjelljet e tij dhe që i jep lumturi atij. Përveç të tjerash, përfshin edhe

Ngjarjet që po përjetohen në gjeografinë islame dhe në Turqi, vazhdojnë të na e copëtojnë zemrën dhe të formojnë një ndikim të thellë te myslimanët. E vërteta e hidhur që umeti Islam po e dëmton shpirtin dhe të drejtën e vëllazërisë që Kurani dhe Suneti e kanë nxjerrë në pah, e ka çuar atë deri në shkatërrimin e fuqisë materiale dhe shpirtërore të tij. Myslmanët i kanë humbur aftësitë për ta kuptuar paralajmërimin e mëposhtëm të Kuranit Fisnik:

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (Enfal, 46) Pasojnë e dhimbshme të kësaj, myslimanët janë të detyruar ta paguajnë me krime që shkatërrojnë dinjitetin njerëzor, si poshtërimi, vrasjet në masë dhe pushtimi.

Në vend që ithtarët e Kuranit të shfaqin një qëndrim dinjitoz, guximtar, të zgjuar, serioz dhe të fortë kundrejt femohuesve dhe tiranëve,¹ po sillen të pashpirt dhe të pamëshirshën ndaj njëri-tjetrit. Kjo që po bëjnë ata, është plotësisht në kundërshtim me sistemin e besimit që ka vendosur Kurani dhe Suneti. Kjo situatë tregon se sa shumë janë larguar

1. Shik. Fet’h, 29.

2. Kurtubi, Ebu Abdillahi Muhammed b. Ahmed, el-Xhamiu li Ahkami’l-Kur’an, Daru’l-Fikr, Bejrut, 1995, vëll. IV, K. VIII, 88; Shejkana, Muhammed b. Ali Muhammed esh-Shejkani, Fet’hu’l-kadir el-Xhamiu bejne Fenneji’r-Rivajeti min Ilmi’t-Tefsir, Daru’l-Kitabi’l-Arabijji, Bejrut, 1994, II, 481-482.

kuptimet si mirëqenie, begati, mbarëvajtje dhe pasuri. Ndërsa fjala “sejje” është e kundërta e saj. Ajo përfshin kuptimet si thatësi, mungesë të ushqimit, varfëri dhe humbje.³

Kur të mendohet kuptimi i ajetit nga të gjithë këto, kuptohet qartë se femohuesit nuk duan që myslimanët të jetojnë të qetë, në paqe, në liri e në siguri dhe të kenë një jetë të zhvilluar ekonomike, teknologjike, sociale e politike. Ngjarjet që po përjetojnë sot në të gjithë botën, e vërtetojnë kontekstin e ajetit të mësipërm. Gjithashtu, e nxjerrin qartazi në pah se Kurani është një libër mrekulli.

Ngjarjet që sot po ndodhin në botë dhe në vendin tonë, ndikojnë te ne në një masë të papërkufizueshme dhe na brengosin. Veçanërisht flakët e zjarrit të fitnes që duan t'i ndezin dhe avujt përvëlues të shkatërrimit që duan të bëjnë të mbijnë ndërmjet myslimanëve, siç na i djegin fytyrat, na i copëtojnë edhe zemrat tona. Por krahas të gjithave, ne nuk duhet të biem në pesimizëm. Një njeri që është mposhtur mendërisht, do të thotë se e ka pranuar mposhtjen që i vjen menjëherë. Neve nuk na ndodh asgjë përveç asaj që ka caktuar Allahu Teala. Ajeti i mëposhtëm e qetëson ndërgjegjen e të gjithë myslimanëve dhe ua forcon atyre besimin:

“Thuaj: “Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu. Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!” (Teube, 51)

Mbështetja te Allahu, besimi ndaj Tij dhe strehimi te mbrojtja e Tij është detyra jonë themelore si myslimanë. Por kjo mbështetje për të cilën po flasim, duhet të bëhet pasi t'i kemi kryer detyrat tona si njerëz dhe pasi të kemi shfaqur përpjekjen e vendosmërinë e duhur. T'i mbështetesh Zotit pa u përpjekur dhe pa dhënë mundin e duhur, nuk është gjë tjetër përveçse një mashtrim bosh që Kurani nuk e pranon. Një besimtar i vetëdijshëm dhe i sinqertë duhet ta hetojë veten për të parë se sa preokupohet për zhvillimin e shoqërisë në aspektin e besimit dhe moralit, se sa përpjekje bën për bashkimin dhe unitetin e myslimanëve, se çfarë bën për ta shuar zjarrin e fitnes dhe se sa e prish rehatinë e tij për t'i ndaluar vrasjet makabre që po bëhen në vendet islame, qoftë edhe duke u lutur. Nëse duhet ta përmbledhim, themi: Myslimani duhet të mendojë se sa përpiqet në raport me mundësitë shpirtërore dhe materiale që posedon. Pasi t'i kryejë të gjitha këto, duhet ta dijë se ka edhe të drejtën për t'u mbështetur te Zoti. Paralajmërimi i poetit me origjinë shqiptare, Mehmet Akif Ersojit në lidhje me këtë çështje, është shumë kuptimplotë:

3. Isfehani, Mufredatu Elfadhi'l-Kur'an, Verefikoi, Safvan Adnan Davdi, Daru'l-Kalem, Bejrut, 2011, fq. 235. (Si shembull shik. Nisa, 78).

*Sheriati të tha “përpiqu, kurse ti nderje,
Në emër të shariatit sajove sa e sa besëtytni!
Më në fund, duke e futur me zor në mes “nën-
shtrimin ndaj Zotit”,*

*Fenë e mjerë e ktheve me të në maskaradë!
Lëre ti punën dhe urdhëro prej ku je ulur,
E mos u lodh se ja, ke Zotin shërbëtor personal!
Në mëngjes, para se të dalësh, i shkruan punët
Një nga një në një listë se i kryen Zoti: është de-
tyrë e Tij!*

*Ngarkesa t'u lehtësua... Pra ti shko tani drejt në
kafene!*

*Fëmijët mund të hiqen zvarrë e të mbeten të uri-
tur...*

Po a s'i ushqen Zoti ata? Ti shih qejfin tënd!

Thesari i të mirave të Tij është dhe i yti,

Ngarkoja të gjitha shpenzimet... T'i jep!

Zoti përdor armën, Ai ruan në kufi;

*Qenkan mbaruar ushqimet dhe municioni? Fur-
nizon Ai!*

Dërgon nën komandën e vet engjëj si ushtri

Që i shtrojnë për tokë armiqtë për hesapin tënd!

Po mbete ngushtë, mjafton ai zëri yt nazemadh;

*“Na ndihmo!” dhe Ai vjen vetë ose dërgon Hëz-
rin!*

*Po të kesh të sëmurë në shtëpi, e ka për borxh t'i
shikojë,*

Thesari i shërimit do të derdhet e do të kullojë.⁴

Çdo besimtar duhet të përpiqet për ta kryer detyrën që i takon. Në lidhje me këtë çështje, nuk duhet të hezitohet për të sakrifikuar materialisht e shpirtërisht. Pasi t'i kryejë të gjitha këto, duhet t'ia lërë Allahut rezultatin dhe duhet t'ia lutet Atij për sukses. Besimtari duhet të veprojë sipas parimeve të shpjeguara në ajetin e mëposhtëm, duhet të përkushtohet për të fituar miqësinë e Allahut Teala dhe asnjëherë nuk duhet të bjerë në pesimizëm: “Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë. Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia lehtësojë çështjen.” (Talak, 2-4) Për këtë arsye, besimtari duhet të besojë me bindje të plotë se nuk do t'i ndodhë asgjë përveç asaj që i ka caktuar Allahu i Lartësuar.

4. Mehmet Akif Ersoji, Fletët, Në Katedrën e Fatihut, Shtëpia Botuese Logos-a, 2006, fq. 327.



PORTRETI SOCIAL I MYSLIMANIT

— Xhafer Durmush —

Allahu i Lartësuar thotë në suren Ali Imran: “Nxi-toni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë, pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!” (133-136)

Kur të ulemi për ta lexuar Kuranin Fisnik, mund të ndjejmë një ngrohje nga brenda, nëse në leximin tonë gjenden edhe këto ajete fisnike, sepse ato na ndriçojnë rrugën. Zoti i Gjithëmëshirshëm na mëson se si duhet të shkojmë drejt faljes së Tij të pafundme dhe xhenetit, i cili është i gjerë sa qiejt dhe toka. Na përshkruan edhe pamjen e jashtme të personalitetit të myslimanit. Na jep mundësinë për t'i risistemuar marrëdhëniet njerëzore duke i kontrolluar ato. Ndër të tjera, na tregon se duhet t'u drejtohem virtyteve të cilat u përmenden më lart, në mënyrë që ta vlerësojmë si duhet kohën e jetës.

Besimtari jeton në çdo çast të jetës me vetëdijen e dhënies së llogarisë. Ai dëshiron të futet në xhenet, i cili është përgatitur për të devotshmit. Për këtë

arsye, përpiqet të bëjë sa më shumë punë, të cilat do të bëhen shkak për arritjen e faljes hyjnore. Nisur nga ky aspekt, mundohet të jetë i devotshëm në çdo punë dhe vend të hapur apo të fshehtë. Në sajë të respektit dhe dashurisë së thellë që ka ndaj Allahut të Madhëruar, nuk u afrohet veprave që tërheqin zemërimin hyjnor. Në çdo moment përpiqet të bëjë vepra të cilat Allahu Teala i do dhe i pëlqen.

Besimtari jep edhe në mirëqenie, edhe në vështirësi. Ai përpiqet të jetë gjithmonë dora që jep sipas mundësisë që ka dhe asnjëherë nuk e harron se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka qenë bujar si ujërat që rrjedhin. Gjithashtu nuk harron se buzëqeshja ndaj vëllait mysliman dhe dy fjalë të ëmbla që mund t'i a thotë, janë lëmoshë për të.

Besimtari gjithmonë e mposht zemërimin. Zemërimin që i buron nga nefsi, përsëri e drejton nga vetja. Në vend që t'u nxeht të tjerëve për shkaqe personale, mundohet të shikojë mangësitë e tij dhe thotë: “Së pari rregulloji këto!” Për këtë arsye, nuk i urren të tjerët dhe nuk rend pas marrjes së hakut prej atyre. Ai përpiqet ta mposhtë zemërimin, mad-je, ta kthejë në dashuri. Andaj shfaq përpjekje serioze për t'u bërë një besimtar i përsosur që i mirëkupton të gjithë dhe që mirëkuptohet nga të tjerët.

Besimtari i fal njerëzit. Ai përpiqet t'i harrojë gabimet, i fal lehtësisht ato dhe bashkëbiseduesit i thotë: “Haku im të qoftë hallall.” Butësinë që i vjen nga moszemërimi dhe mosurrejtja, e kurorëzon me falje. Ai i mbulon gabimet e të tjerëve dhe është i

vetëdijshëm se si duhet të nxjerrë mësim nga ga bimet. Ai i beson kësaj të vërtete me të gjithë qenien e tij: Ditën e gjykimit, një thirrës do të thërrasë: “Ku janë ata që vetë Allahu do t’ua japë shpërblimet?” Ata që do të ngrihen në këmbë, do të jenë vetëm njerëzit që falin.

Pastaj përpiqet për t’u bërë prej muhsinëve. Ai e di se muhsin do të thotë bamirës, njeri që jep pa pri-tur shpërblim dhe ai që fal. Andaj, asnjëherë nuk e nxjerr nga mendja se të dhënët pa interes është prej moralit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Nëse bën ndonjë të keqe apo i bën ndonjë padrej-tësi vetes, menjëherë e kujton Allahun Teala. Në këtë mënyrë, pendohet dhe i kërkon falje Atij. Në momentin kur e kupton gabimin e tij, menjëherë kthehet, e rregullon nëse ka prishur ndonjë gjë, i pranon kundërshtimet dhe nuk insiston në ga-bimin e tij. Ai i kërkon falje Allahut duke qenë i vetëdijshëm se askush nuk mund t’i falë mëkatet përveç Atij.

Ajetet fisnike të mësipërme na japin këtë sihariq: Shpërblimi i atyre që veprojnë sipas virtyteve që u përmenden më sipër, është falje nga ana e Zotit dhe xhenete nën të cilat rrjedhin lumenj...

Për shkak të rëndësisë që mbart, këtu duam të transmetojmë fjalën e Thabit el-Benanit, i cili ka thënë: “Sipas dijes që kam unë, shejtani, alejhi’l-laneh, ka qarë kur ka zbritur këto ajete.”

Atëherë, të mençurve u takon të veprojnë sipas këtyre ajeteve, që e bëjnë për të qarë djallin e mallkuar. Ata duhet të nxitonjë për të bërë sa më shumë mirësi dhe të garojnë në këtë çështje pa humbur as-pak kohë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojnë se në lënien për më vonë të punëve të mira ka fatkeqësi të ndryshme.

Allahu Teala e ka krijuar njeriun të aftë për të hyrë në xhenet e për t’u lartësuar në gradat e tij, por edhe për të hyrë në xhehenem e për t’u rrokullisur në shkallët e tij. Pastaj e ka përgëzuar me xhenet dhe e ka paralajmëruar me anë të pejgamberëve në lidhje me xhehenemin.

Siç shprehet edhe në Ruhu’l-Bejan, arritja e xhe-netit është e mundur pasi të hiqet dorë prej gjërave që gjenden në qiell dhe në tokë. Ndërsa heqja dorë nga gjërat që i konceptojnë organet e pesë shqisave, arrihet me devotshmëri, e cila përbëhet nga pastri-mi i vetes prej cilësive të këqija. Argumenti i kësaj është ajeti në të cilin thuhet për xhenetin: “Ai është përgatitur për të devotshmit.”

Si thoni? A jemi gati t’i përvetësojmë virtytet që përmenden në ajetet fisnike, në mënyrë që ta bëjmë jetën tonë “një garë për në xhenet”? A jemi gati ta kurorëzojmë faljen me durim dhe dhënien me mo-desti? A jemi gati ta mbartim në jetë personalitetin e myslimanit me petkun e devotshmërisë?


Lexo-Mendo

TË THUASH: “KËTË E DIJA”

Në ajetin e tetëmbëdhjetë të sures Hakka flitet për ditën në të cilën njerëzit do të dalin në audiencën hyjnore që të japin llogari dhe thuhet: “...Asnjë fsheh-tësi e juaja nuk do të ngelë pa u shfaqur.” Në vazhdim flitet për gjendjen e mirë të atyre që libri do t’u jepet nga e djathta dhe nga përpara: “Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t’u thotë (njerëzve të tij): “Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.” Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur në një kopsht të lartë, frutat e të cilit do t’i kapë lehtë. (Njerëzve të tillë u thuhet:) “Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!” (Hakka, 19-24)

Fjalja më tërheqëse në këtë ajet është se ata të cilët do t’u jepet libri i veprave të tyre nga ana e djathtë dhe nga përpara, do arrijnë të thonë: “Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.” Sepse ata patën besuar plotësisht se një ditë do të jetë e vërtetë ajo skenë. Si rezultat, bënë vepra që do t’i mbartnin te ajo skenë dhe u larguan nga ato vepra që i bënë të meritonin të kundërtën.

Nëse jeta është një maratonë të cilën nuk e dimë se ku dhe si do të përfundojë, atëherë, synimi ynë duhet të jetë që t’i japim fund asaj me sukses, të shpërngulemi me besim nga kjo botë në momentin e frymës së fundit dhe të futemi në grupin e të përgëzuarve nga ajeti fisnik. Nëse do veprojmë në këtë mënyrë, do arrijmë të themi: ““Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.” – kur ta marrim nga e djathta librin e veprave tona, në të cilin asgjë e madhe apo e vogël nuk lihet pa u shkruar.





Bujaria në pasuri, në jetë dhe në çdo gjë tjetër

— Sami Gëksyn —

Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), u kthye nga Mali Uhud në Medinetu'l-Munevvere dhe tha:

“Po të kisha florinj aq sa është Mali i Uhudit, kjo nuk do të më gëzonte. Përveç atyre që kam ndarë për të paguar një borxh, nuk dua që ndonjë dinar të jetë nën pronësinë time më shumë se tri ditë.” I Dërguari i Allahut (a.s.), duke bërë shenjën e dhënies me duart e tij përpara, djathtas dhe majtas, tha: “Atë që e kam dua t’ua shpërndaj kështu e ashtu robërve të Allahut.” (Buhari, Rikak, 14.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), siç ishte në të gjitha virtytet e tjera, edhe në bujari ishte më para të gjithëve. Kur Aliu, (r.a.), po fliste rreth Hz. Pejgamberit, tha:

“Ai ishte njeriu më bujar prej të gjithëve.”

Allahu i Lartësuar është fisnik dhe e do fisnikërinë. Është bujar dhe e do bujarinë.

Në hadithin kudsî thuhet:

“Kjo fe (domethënë Islami), është një fe që e kam zgjedhur për vete dhe prej së cilës jam i kënaqur. Asaj i ka hije vetëm bujaria dhe morali i lartë. Përderisa të jetoni si myslimanë, lartësojeni

atë me këto dy cilësi!” (Hejthemi, VIII, 20)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh këtë të vërtetë me të kundërtën e saj:

“Këto dy cilësi nuk gjenden kurrë bashkë te një besimtar i vërtetë:

Koprracia dhe morali i ulët!..” (Tirmidhi, Birr, 41/1962.)

Për këtë arsye, Aliu, (r.a.), thotë kështu në فرمانin që ia shkroi valiut të Egjiptit, Malikut:

“Mos e fut në kuvendin e konsultimit koprracin që mund të të bëjë të heqësh dorë nga fisnikëria dhe bujaria jote duke të trembur me varfëri!”

Çdo gjendje e bujarisë është e nderuar. Njerëzit pandehin se bujaria shfaqet vetëm në aspektin material dhe me pasuri, por ja që bujaria mund të shfaqet me pasuri, me qëllim të mirë, me dije dhe me jetë.

Atëherë, si mund të shfaqet bujaria me nijet të mirë?

Fillimi i kësaj është që të duam edhe për të tjerët atë që duam për veten tonë. Pastaj vazhdon deri sa interesat e besimtareve të jenë më primare për ne se sa interesat tona.

Njeriu mund ta arrijë shpërblimin edhe duke dëshiruar me qëllim të mirë për të bërë një punë. Për shembull:

Dikush që thotë: “Sikur të kisha edhe unë pasuri dhe të bëja mirësi si filan person.” – dhe që e mbart këtë nijet, fiton sevape aq sa njeriu të cilin deshi ta merrte si shembull.

BUJARIA NË PASURI

Bujaria në pasuri fillon që nga dhënia borxh njerëzve e arrin deri te lëmoshat nafile, ndihmat, lëmoshat e obliguara dhe zekati, te vakëfet etj.

Veprat e panumërta dhe madhështore të vakëfeve që edhe sot qëndrojnë në këmbë, si çezmat, urat, rrugët, hanet, hamamet, medresetë, xhamitë dhe spitalet janë vepra që burojnë nga bujaria e kësaj feje.

Falënderimet qofshin për Allahun Teala që kjo ndjeshmëri vazhdon edhe sot.

BUJARIA NË DIJE

Bujaria në dije fillon duke mos i fshehur dijet e dobishme e të nevojshme për njerëzit, duke ua mësuar edhe të tjerëve atë që di vetë, duke ua urdhëruar njerëzve të mirën e duke i ndaluar ata nga e keqja dhe arrin deri te edukimi i shkencëtarëve në dobi të njerëzve e realizimi i veprave të dobishme.

BUJARIA NË LIDHJE ME JETËN

Kjo do të thotë që të marrim parasysht flijimin e jetës dhe rënien dëshmor për atdheun, popullin, shtetin, nderin, fenë e pastër islame dhe për çdo gjë tjetër që e konsiderojmë të shenjtë.

Myslimanët nuk presin ndonjë shpërblim, madje, as edhe ndonjë falënderim në këtë botë për çfarëdo lloj mirësie që mund të bëjnë. Me këto bujari që shfaqin, përjetojnë mirësi shpirtërore, duke e ditur se çdo gjë e kanë bërë për hir të Allahut Teala, se shpërblimin e tyre do ta marrin shumëfish në ahiret, se do t’i arrijnë ato që shpresojnë dhe se edhe në këtë botë do të shpërblehen shumëfish me të mirat e Zotit.

Tani dua të transmetoj dy histori në lidhje me këtë çështje nga jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ishte njeriu dhe peygamberi më bujar dhe nga jeta e sahabëve që i pati edukuar ai:

Një ditë, njëra prej zonjave sahabe, ia dha dhu-

ratë të Dërguarit të Allahut (a.s.), mantelin që kishte thurur për të. Ngaqë i Dërguari i Allahut, (a.s.), atë kohë kishte nevojë për një mantel të tillë, e veshi atë.

Njëri prej sahabëve që gjendej aty, e preku mantelin dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut! Sa i bukur qenka ky mantel. A mund të ma japësh mua?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Në rregull.” Pasi Resulullahu (a.s.), qëndroi pak me shokët e tij, shkoi në shtëpi. E palosi mantelin dhe ia dërgoi sahabit që e deshi. Sahabët e tjerë që gjendeshin aty e qortuan shokun e tyre duke i thënë:

“Nuk veprime aspak mirë. Ti i kërkove të Dërguarit të Allahut mantelin që pati veshur dhe që pati nevojë për të. Ne të gjithë e dimë se i Dërguari i Allahut nuk e refuzon asnjë kërkesë.”

Ai u tha:

“Për Zotin, nuk ia kërkova atë për ta veshur, por ia kërkova që ta kem për qefin kur të vdes.”

Me të vërtetë, ai mantel u bë qefini i atij sahabi kur ndërroi jetë. (Buhari, Edeb, 39.)

Sahabët, të cilët i pati edukuar i Dërguari i Allahut (a.s.), garonin me njëritjetrin në ndihmën ndaj të varfërve dhe në bujari. Umeri, (r.a.), thotë:

“Diku afër Medines banonte një grua e varfër, e moshuar dhe e verbër. Unë dëshiroja që të shkoja çdo ditë te ajo dhe t’ia plotësoja nevojat, por kurdo që shkoja, vija re se dikush kishte shkuar para meje dhe ia kishte kryer punët.

Një ditë u bëra kureshtar dhe mendova: “Vallë, kush është ai që e bën këtë sevap çdo ditë?” Për këtë arsye, një ditë shkova shumë herët te ajo grua. Por çfarë të shikoja? A nuk kishte qenë Ebu Bekri (r.a.), ai që e bënte këtë sevap?”

Siç ndodhte gjithmonë, Ebu Bekri (r.a.) edhe këtë radhë ia kaloi Umerit (r.a.), në bujari...

Në këto kohë të vështira, lus Allahun Teala që të na i zhvillojë ndjenjat e bujarisë dhe të na i shtojë përpjekjet në sakrificë! Zoti e bëftë bujarinë tonë shkak për hapjen e të gjitha mirësive dhe largimin e të gjitha ligësive! Amin!...





Metodologjia e arsytimit të Kuranit

— Ibrahim Arpaxhë —

Shprehja “në mënyrë që të mendoni”, e cila përmendet shpeshherë në Kuran, është një tërheqje vërejtjeje dhe një paralajmërim në lidhje me çështjen se si duhet të pozicionohet njeriu ndaj Allahut dhe krijesave të Tij në ngjarjet me të cilat përballet. Kur Allahu i Lartësuar e bën këtë paralajmërim, sugjeron një meditim të thellë mbi krijesat e Tij. Ky meditim i thellë realizohet duke menduar dhe duke marrë parasysh zemrën.

Ndërkohë që Kurani Fisnik e sugjeron njeriun që të mendojë, nuk e këshillon që të mendojë në mënyrë të zakonshme, por në mënyrë induksioniste. Kjo fillon nga grimca më e vogël në gjithësi dhe vazhdon deri te sistemi më i madh i dritës në univers. Për këtë arsye, Kurani thekson se mund të meditohet mbi çdo krijesë, duke filluar nga fara në tokë e deri te embrioni i njeriut. (Bakara, 26)

Gjithashtu, duke folur rreth bukurisë së krijimit të njeriut: “Kështu e kemi rregulluar; sa Rregullues të shkëlqyer jemi Ne!” (Murselat, 23), e fton njeriun të meditojë edhe mbi veten e tij. Përveç të tjerash, Allahu i Lartësuar ka nxjerrë në pah një terminologji të drejtë mendimi për ne, duke u shprehur: “Në tokë ka vende që kufizohen njëri me tjetrin dhe ka kopshte me hardhi, edhe ara, pemë me shumë filiza, ujiten nga i njëjti ujë, por frutin e disave e pëlqejmë më shumë për të ngrënë se të disa tjerave. Në këtë ka, me të vërtetë, argumente për njerëzit që kanë mend.” (Rrad, 4)

Kjo terminologji është arritje te e vërteta duke menduar mbi krijesat.

Domethënë, ndërkohë që Kurani i fton njerëzit të meditojnë, dëshiron që ata të meditojnë edhe mbi terminologjinë e tij. Në këtë mënyrë, e shpëton

njeriun nga konceptet e gabuara të shekullit në të cilin gjendemi sot. Ndërkohë që e bën këtë, komunikon me botën e perceptimit të njerëzve duke u dhënë shembuj nga ngjarjet e qarta dhe që mund të vërtetohen. Për shembull, Kurani influencon te njerëzit me shembuj që nuk janë larg jetës së përditshme duke thënë: “Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqs fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, në mënyrë që t’ua vënë veshin.” (Ibrahim, 24-25)

Të gjithë duhet ta dimë se njohja e së vërtetës arrihet duke parë nga këndvështrimi që na sugjeron Krijuesi i të vërtetës. Ndërkohë që Kurani shpjegon përmbajtjen e tij, thekson se rruga më e drejtë prej të gjithave është rruga që tregon ai vetë: “Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.” (Nahl, 89)

Përveç të tjerash, nuk duhet ta harrojmë edhe këtë të vërtetë: Filozofia mund t’i përgënjeshtrojë zbulimet e djeshme me të vërtetat e sotme. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkencën. Ajo mund t’i refuzojë zbulimet e djeshme me të dhënat që ka arritur sot. Pra, kjo është e mundur, por të njëjtën gjë nuk mund ta themi për fetë në përgjithësi dhe për Islamin në veçanti. Feja është e pandryshueshme. Ithtari i një feje e ripërtërin besimin e tij me shprehjet e asaj feje që vazhdimisht rrinë të freskëta. Kjo arrihet duke iu afruar mendimeve dhe ideve të kundërta të kohës me një epistemologji fetare.

Kurani Fisnik e ka lidhur fuqinë e besimit me nënshkrimin e zemrës. Për këtë arsye, në shumë vende flet për shikimin dhe mendimin me zemër. Ai e ka lidhur meditimin, të folurën dhe urtësinë me mendimin e zemrës duke thënë: “Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (Haxh, 46)

Kjo ka dalë aq shumë në pah, sa që në historinë islame ka pasur prej atyre që perëndimin e kanë quajtur racional dhe lindjen shpirtërore. Nisur nga kjo, kanë dalë në përfundimin se për shkak të kësaj, pejgamberët kanë dalë nga lindja ndërsa filozofët kanë dalë nga perëndimi.

Në ditët e sotme, për fat të keq, ka shumë mendime iluzionare kryesisht në lidhje me problemet e njerëzve. Kurani qëndron larg të gjitha këtyre mendimeve dhe jep shembuj më të përshtatshëm për botën e perceptimit të njeriut. Kur i jep këta shembuj, thotë: “Allahu nuk ngurron të japë shembull mushkonjën ose diçka më të madhe se ajo. Ata që besojnë, e dinë se kjo është e vërteta nga Zoti i tyre, kurse ata që nuk besojnë, thonë: “Çfarë kërkon të tregojë Allahu me këtë shembull?”

Nëpërmjet tij, Ai shumëkënd e lë në humbje e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë.

Ai i lë në humbje vetëm gjynahqarët e mëdhenj.” (Bakara, 26)

Në këtë mënyrë, Kurani na tregon se e vërteta nuk është më e madhe se përgjegjësitë që na ka vënë në këtë botë që jetojmë dhe na sugjeron t’i shikojmë me syrin e urtësisë gjërat që nuk i koncepton mendja jonë.

Ndërkohë na njofton se njeriu nuk ka nevojë të shkojë shumë larg për çfarëdo lloj çështjeje qoftë dhe se, edhe një deve me veçoritë e saj ontologjike mund ta shpjerë njeriun te krijuesi i tij: “Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?!

Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po tokën, se si është shtrirë?!” (Gashije, 17-20)

Domethënë, Kurani na njofton se gjëja që kërkon njeriu nuk gjendet në jetesën laike të mendimit të sotëm kapitalist, por në ndriçimin e vetë Kuranit. Si mesazh të parë, njofton se të pranueshme nuk janë interesat njerëzore, por mendimet e Kuranit.

Njeriu i sotëm punon pa reshtur natë e ditë për gjërat që koha, të cilën përpiqet ta arrijë, ia shfaq si të nevojshme. Më në fund, dëshpërohet edhe më shumë ngaqë nuk i arrin ato, sepse kultura jonë e prodhimit dhe konsumimit nuk është në perspektivën që i jep përparësi Kurani. Në këtë mënyrë, e fusim veten në sprovat e panevojshme





të skenës së kësaj bote. Për fat të keq, kemi arritur në një gjendje që nuk e llogarisim dot se çfarë është mirësia e vërtetë dhe cilat janë gjërat më të vlefshme.

Ndërkohë, Kurani thotë se planifikimi i kësaj jete dhe i jetës së botës tjetër arrihet duke menduar drejt. Për këtë arsye, jep shembuj nga natyra e deri te dheu, nga njerëzit e deri te kafshët në lidhje me fushën e jetës që e bëjnë sipas rregullave të tyre. Kur e bën këtë, nuk e sheh të përshtatshme ndërhyrjen në ligjin e zhvillimit natyral të individit (Rahman, 8) dhe nuk e lejon dhunimin e fushës së jetesës së kafshëve: “Ai e ka bërë tokën për krijesat.” (Rahman, 10) “Të gjitha kafshët në tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju...” (En’an, 38) Nëse e shohim nga një këndvështrim tjetër, Kurani Fisnik ia kujton njeriut se kjo botë nuk i përket vetëm atij. Pastaj, duke dhënë shembuj nga natyra, qielli dhe toka, urdhëron që t’u dihet vlera mirësive të dhuruara nga Zoti dhe të konsumohen me vetëdije të plotë.

Përsëri në të njëjtën mënyrë, e këshillon njeriun, i cili ka një trup që do kalbet dhe një jetë që do mbarojë, t’i konsumojë trupin, mendjen dhe jetën për ahiretin, i cili është i përhershëm dhe i premtuar. Për këtë arsye, i sugjeron njeriut vazhdimisht që të mendojë dhe meditojë.

Le ta lidhim temën tonë me një hadith fisnik të të Dërguarit të Allahut (a.s.): “Dy vetë shkojnë dhe e vizitojnë Aishen (r.a.). Njëri prej tyre i tha: “A mund të na tregosh diçka ndikuese që keni parë te Muhamedi (a.s.)?” Aishja (r.a.), iu përgjigj:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), një natë u ngrit, mori abdest dhe fali namaz. Ai qau shumë në namaz. Lotët që i rridhnin nga sytë, ia lagën mjekrën dhe

vendin përgjatë sexhdes. Bilali (r.a.), erdhi për namazin e mëngjesit dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut!

Çfarë ju ka bërë të qani, ndërkohë që ju janë falur të gjitha mëkatet e kaluara dhe të ardhshme?” I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: “Allahu i Lartësuar më ka zbritur një ajet mbrëmë. Ai ajet më ka bërë të qaj.” Pastaj këndoi ajetin: “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.” (Ali Imran, 190) Pasi e këndoi ajetin, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “Mjerë për ata njerëz që e lexojnë këtë ajet dhe nuk meditojnë rreth tij.”

Siç shprehet edhe në hadithin fisnik, pasi robi të meditojë rreth gjithësisë së pafundme, arrin ta kuptojë se është i vogël sa një grimcë. Në këtë mënyrë, e percepton dobësinë dhe varfërinë e tij. Pastaj i thyen muret e mendjemadhësisë dhe shtron fletët e modestisë. Ai e zbut zemrën dhe e përgatit atë për zbritjen e mëshirës së Allahut Teala.

Siç mblidhet uji i shiut në gropë, ashtu mblidhet edhe mëshira e Allahut të Madhëruar në zemrën e robit që mendon, që e bën atë që mendon, që e di vendin e tij në univers dhe pozicionohet sipas këtyre që mendon e kupton.

Nëse bëjmë një sintezë ndërmjet Islamit dhe feve të tjera dhe e nisim rrugën nga gazmorja e Nastradinit i cili i tha: “Shko e kërkoje gjilpërën në dritë!”, dikujt që i kishte humbur ajo, mund të themi: “Mësimet e manipuluar të feve të tjera në këtë botë janë një errësirë. Ekzistenca e re nuk gjendet në atë errësirë, por ajo duhet të kërkohet në dritën e Kuranit. Edhe Kurani ua ka shfaqur, ua shfaq dhe do t’ua shfaqë këtë dritë atyre që i besojnë dhe meditojnë rreth tij.



FITIMI HALLALL DHE HARAM

“O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju!” (Mu’minun, 51)

— Irfan Ozturk —

CILAT GJËRA JANË FITIM HALLALL DHE I PASTËR?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili është i obliguar për të shpjeguar shpalljen hyjnore, na e jep përgjigjen e kësaj pyetjeje duke u shprehur:

“Ushqimi më i pastër që ha njeriu është ai (ushqim) që e fiton vetë.” Enciklopedia e Hadithit, Kutubu’s-Sitte, 14-312.)

“Njeriu nuk ka ngrënë gjë më hallall se një ushqim që e fiton me mundin e tij.” (Buhari, Buju’, 15.)

Nisur nga kjo, risku i pastër për të cilin bëhet fjalë në ajet, është fitimi që besimtari e arrin duke punuar në përputhje me dispozitat që ka vendosur Allahu Teala. Sigurimi i riskut me anë të kësaj rruge është një obligim për çdo besimtar.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh kështu këtë dispozitë në një hadith fisnik: “Sigurimi i jetesës në hallall është farz për çdo mysliman.” (Taberani)

ÇFARË I JEP BESIMTARIT KRYERJA E KËTIJ OBLIGIMI?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh kështu këtë dispozitë në një hadith fisnik: “Sigurimi i jetesës në hallall është farz për çdo mysliman.” (Taberani)

Të punosh për ta fituar riskun në hallall është ibadet.

Feja islame e konsideron ibadet të punuarit për ta fituar riskun në hallall. Të parët tanë kanë thënë:

“Adhurimi është dhjetë pjesë. Nëntë prej këtyre pjesëve përbëjnë kërkimin e riskut në hallall.” (Ihja, 2/236.)

Një njeri që i beson Allahut të Madhëruar, e kryen me ibadet detyrën e nënshtrimit që ka ndaj Tij, sepse ibadeti është borxh për çdo rob kundrejt Zotit (xh.xh.).

Përveç të tjerash, ka edhe një të vërtetë që duhet ta dimë. Ajo është: borxhi që duhet të paguhet në mënyrën më urgjente është borxhi kundrejt Allahut Teala.

Përderisa njeriu merr frymë, është borxhli ndaj Zotit (xh.sh.)... Gjithashtu, ne nuk e dimë se kur do të marrë fund ajo frymë.

Besimtarët duhet ta bëjnë mirë llogarinë e çdo fryme që marrin e japin dhe absolutisht duhet ta harxhojnë në një formë që të shndërrohet në sevap ky kapital i vlefshëm, në mënyrë që të mos shkojnë me borxhe në botën tjetër.

Përgatitja për fundin absolut, domethënë, vdekjen, e cila është caktuar në pafillimësi dhe e cila dihet në mënyrë absolute nga Zoti (xh.xh.), por që ne nuk mund ta dimë, apo me një shprehje tjetër, për të mos u kapur nga vdekja pa qenë të përgatitur, myslimani duhet ta përdorë çdo çast për të kryer detyrat që ka ndaj Allahut Teala.

Ja pra, fitimi hallall është një mundësi e përkryer për ta adhuruar Zotin dhe për të kryer detyrën që kemi kundrejt Tij...

Madje, puna është një adhurim më i virtytshëm se disa ibadete nafile / vullnetare.

Isai, (a.s.), pa një burrë dhe e pyeti:

“Si je? Çfarë bën?” Burri iu përgjigj:

“Preokupohem me ibadet. Vazhdimisht i bëj ibadet Zotit. Hazreti Isai e pyeti përsëri:

“Kush ta siguron jetesën?” Burri i tha:

“Ma siguron vëllai.” Hazreti Isai ia ktheu:

“Në fakt, vëllai yt qenka ai që bëka ibadet.” (Ihja, 2/164.)

Por ka edhe një pikë tjetër që duhet të shpjegohet. Në ditët e sotme kanë dalë disa njerëz dhe japin fetva të gabuara duke u shprehur:

“Ai që punon me qëllim për të siguruar jetesën e familjes, është në adhurim. Për këtë arsye, nuk ka rëndësi nëse nuk i kryen ibadetet e tjera.” Kjo fetva shihet qartë se po ua ngatërron mendimet myslimanëve.

Njeriu nuk mund të rrijë gjithmonë larg mëkateve. Fakti që ai bën gabim ndonjëherë është rezultati normal i të qenit njeri... Veçanërisht në ditët e sotme, nuk është e lehtë të rrihet larg mëkateve... Andaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Jeni përpëlitur prej mëkateve. Prandaj mund të pastroheni me pendim.” Domethënë, ne, si njerëz dhe si robër mëkatarë, kemi nevojë për falje, në mënyrë që të hyjmë në xhenet dhe të shohim Zotin (xh.xh.)...

Ja pra, përpjekja për të fituar në hallall ia mundëson robit këtë falje. Profeti (a.s.), thotë:

“Kushdo që e kalon natën i lodhur prej punës së tij, do të thotë se e ka kaluar duke arritur faljen e Allahut.” (Enciklopedia e Hadithit, Kutubu’s-Sitte, 14/312.)

Qoftë babai, i cili lodhet ditën për ta fituar në

rrugë të lejuara riskun e familjes së tij apo qoftë nëna, e cila punon pa reshtur në shtëpi dhe kuzhinë për rehatinë e familjes së saj dhe të veten, përfshihet nga e njëjta falje hyjnore. Allahu i Lartësuar i shpërblen ata përgjatë gjithë natës duke ua falur mëkatet...

Sa mirësi e madhe! Edhe fitojmë para, edhe bëjmë ibadet në të njëjtën kohë...

Ata që zgjedhin rrugën e fitimit të lejuar janë ndërmjet banorëve të xhenetit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Banorët e xhenetit ndahen në tri grupe. Ato janë:

- Kryetari i shtetit që është i drejtë dhe i suksesshëm,

- Njeriu zemërbutë kundrejt të afërmve dhe myslimanëve dhe;

- Njeriu që largohet nga fitimi haram dhe që nuk kërkon asgjë prej askujt, edhe pse familja e tij është kallaballëk.” (Muslim, Xhenet, 63.)

Të punojmë për ta fituar riskun në përputhje me pëlqimin e Allahut Teala... Të fitojmë me djersën e ballit në vend që t’ua zgjasim dorën të tjerëve... Në këtë mënyrë, do ta mbrojmë personalitetin tonë dhe do të hyjmë në xhenet...

Fitimi në hallall ia ngre pozitën njeriut te Allahu i Madhëruar.

Fitimi në hallall ia ngre pozitën njeriut edhe në ahiret, siç i jep atij edhe nder në këtë botë. Besimtarit, i cili do të arrijë shpërblime të ndryshme me çdo lloj vepre që bën në këtë botë, në botën tjetër i jep një jetë të lumtur dhe të përhershme në vendin ku gjenden të sinqertët...

Ja, a nuk është ky shpërblimi më i madh?

Sehli, (r.a.), i cili ishte prej sahabëve më të mëdhenj, thotë:

“Ai që dëshiron të lartësohet në shkallën e të sinqertëve, le të fitojë nga hallalli dhe të veprojë sipas Sunetit.”

Në lidhje me këtë çështje, besimtari duhet të marrë shembull nga kjo këshillë që Lukmani i Urtë i dha birit të tij:

“Biri im! Mbrohu nga varfëria me fitim hallall! Atë që bie në varfëri e presin tri lloj fatkeqësish:

1. Dobësia në fe, sepse varfëria e zvarrit njeriun drejt së keqes.

2. Dobësia në mendje, sepse të menduarit e vazhdueshëm rreth nevojës e çorodit njeriun.

3. Humbja e burrërisë dhe e njerëzillëkut. Ndërsa fatkeqësia më e madhe edhe se këto, e cila e pret njeriun, është se ai bie në një pozitë në të cilën tallet nga të gjithë njerëzit.

PO FITIMI NË HARAM !

Përsëri i Dërguari i Allahut (a.s.), na njofton se ka rreziqe të mëdha për ata që zgjedhin rrugën e haramit në fitimin e tyre.

Ja rreziqet e të ushqyerit me ushqim të fituar në haram:

Namazi është një ibadet të cilin besimtari nuk mund ta neglizhojë në jetën e tij. Ata që e nënvlerësojnë atë i pret një dëm i madh në këtë botë dhe në botën tjetër. Namazi është një ibadet i tillë që edhe në udhëtim, edhe në luftë me armikun nuk është e lejuar që të lihet.

- Namazi nuk mund të lihet për shkak të preokupimeve në këtë botë, domethënë, për shkak të tregtisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “O ju që keni besuar! Kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!” (Xhumua, 9)

- Namazi nuk mund të lihet për shkak të ndonjë frike.

- Namazi nuk mund të lihet, edhe pse mund të ketë rrezik nga armiku përgjatë udhëtimit. “Kur të udhëtoni, nuk është gjynah që ta shkurtoni namazin, nëse druheni që jobesimtarët do t’ju bëjnë ndonjë dëm. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiq të tuaj të hapur.” (Nisa, 101)

- Madje, edhe në luftë me armikun nuk është lejuar që të lihet namazi. “Kur të jesh ti (o Muha-

med) në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e namazit (në luftë), atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t’i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe, le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t’i mbajnë armët e veta! Jobesimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tuaja, që t’ju sulmojnë me tërë fuqinë. Nuk ka gjynah për ju nëse hasni në ndonjë shqetësim prej shiut ose sëmundjes e i lini armët, por edhe atëherë, bëhuni syçelë. Allahu, me të vërtetë, ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët.” (Nisa, 102)

Në këto ajete fisnike është njoftuar qartë se si mund të falet namazi në këto lloj gjendjesh.

Pranimi i namazit, i cili është një obligim i tillë në jetën e myslimanit, hyn në rrezik me fitimin në haram. I Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet:

“Namazi nuk pranohet përderisa të gjendet një copë prej një robe mbi njeriun që e ka marrë atë me dhjetë grosh, ndërkohë që në paratë e tij një grosh është haram.” (Ihja, 2/236.)

Andaj, nuk mund të mendohet ndonjë dëm më i madh dhe një humbje më e madhe se kjo për një besimtar që i beson Allahut dhe ahiretit, sepse, siç na ka njoftuar edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), pyetja e parë që do të bëhet Ditën e Gjykimit do të jetë për namazin. Nëse llogaria e namazit është në rregull, do të kalohet te veprat e tjera. Nëse nuk është në rregull, veprat e tjera as që do të shikohen...

Allahu i Lartësuar na bëftë të gjithëve prej robërve të Tij që fitojnë në rrugë të lejuara dhe që bëjnë vepra të mira!

Amin!



JO VETËM NJË ASPEKT, POR TË GJITHA ASPEKTET

— Mustafa Kyçkashçë —

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: “Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.” (Haxh, 11)

“Por ata (popuj ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.” (Mu’minun, 53)

Në ajetin paraardhës të ajetit të mësipërm theksohet bashkimi para përçarjes: “Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje!” (Mu’minun, 52) Ndërsa në ajetin pas përçarjes bëhet e qartë se përçarja është një dallgë shkujdesjeje që të shpie në shkatërrim: “(O i Dashuri im!) Andaj, lëri ata në padijen (shkujdesjen e hutimin) e tyre për një

farë kohe!” (Mu’minun, 54) Ky ajet është edhe një shpjegim i qartë që sqaron se si janë prishur fetë në të kaluarën...

Mesazhi është i qartë: Njerëzit duhet t’i besojnë Allahut nga të gjitha aspektet... Ata duhet ta ndjekin sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga çdo aspekt dhe nuk duhet të tentojnë të zgjedhin disa pjesë të caktuara prej tij. Kjo është tejet e rëndësishme.

Ndërmjet kushteve të leximit të Kuranit në namaz na del përpara një detaj: Nëse në rekatin e dytë nuk lexohet surja që pason suren që kemi lexuar në rekatin e parë, por e kalojmë atë dhe lexojmë një tjetër, është mekruh. Të shfaqurit e një tabloje sikur e kalon qëllimisht atë sure, nuk është konsideruar si diçka e pëlqyeshme. Andaj, njerëzit duhet të hyjnë brenda kornizës së Islamit duke i pranuar të gjitha dispozitat e tij siç thuhet edhe në ajetin fisnik: “O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar.” (Bakara, 208) Në të kundërt, veprat që bëhen edhe pse mund të kenë referencë nga një aspekt prej Kuranit dhe sunetit, gjithashtu kanë edhe aspekte të tjera që bien në kundërshtim dhe që përplasen me dispozitat e



fesë islame. Kjo dobësi del më shumë në pah veçanërisht nëse bëhet fjalë për një medheheb apo profesion, sepse një shoqëri e tregon veten me gjërat e ndryshme të saj. Për shembull, në jurisprudencën islame shkolla e Kufës dhe ajo e Medines sigurisht se ndahen nga njëra-tjetra me aspektet që u japin më shumë rëndësi. Njëra i jep më shumë rëndësi mendjes (akl), ndërsa tjetra i jep transmetimit (nakl)... Por ja që as Kufa nuk e la naklin dhe as Medina nuk e la aklin... Ndryshimi që kanë ndërmjet tyre më shumë ka lidhje me logjikën dhe parimet e sistemit. Domethënë, atë që njëra e ka vendosur në radhë të parë, tjetra e ka vendosur në radhë të dytë. Për këtë arsye, që të dyja kanë një kible dhe një drejtim: Islamit e vërtetë...

Por ja që kur fraksioni Mutezile mohoi kaderin dhe fraksioni Xhebrije mohoi vullnetin, i morën vetëm disa prej ajeteve dhe haditheve. Në këtë mënyrë, bënë përzgjedhje të njëanshme të tyre. Si rezultat, e humbën tërësinë, unitetin dhe bindjen ndaj fesë nga çdo aspekt. Prandaj, një ndryshim milimetrik i istikametit në fillim është e qartë se çfarë devijimesh shkakton në synim. Për këtë arsye, qasjet e njëanshme dhe që janë mjaftuar me atë që kanë zgjedhur, kanë rezultuar me devijim. Le të japim disa shembuj konkretë:

Dikush i jep më shumë rëndësi çështjes së urdhrit të fesë për xhihad. Nisur nga kjo, feja për atë është xhihad. Madje edhe xhihad është vetëm xhihadi konveksional (nëse mund të shprehemi kështu). Si rezultat lind një lëvizje rinore që hedh slogane dhe që bën aksione. Vetëm vetëdijesim, reagim, rezistim... Në këtë mënyrë, e mbushin tepër cilësinë “të ashpër kundrejt qafirave” dhe e shndërrojnë këtë në gjendjen e një sjelleje që pothuajse reflekton ndaj të gjithë besimtarëve

dhe qafirave... Pra, e çojnë deri aty sa bëhen të ashpër edhe kundrejt besimtarëve që nuk bëjnë xhihad si ata!

Dikush tjetër kapet pas mesazheve të rezistimit pasiv të fesë. Durim, vonim, tolerim, dialog, falje... Sipas këtij këndvështrimi xhihadi është vetëm “përpjekje”. Te këta sundon mendimi i të jetuarit bashkë dhe ai i shumicës. Ata kanë një tolerancë aq të madhe saqë pothuajse mund të kërkojnë ndjesë për shkak të besimit të tyre. Ata duan ta shndërrojnë njeriun në zog para se t’i predikojnë fenë.

Që të dyja këto lloj lëvizjesh sigurisht kanë pika që i kanë marrë si referencë, por ja që këto janë pika të përzgjedhura e të njëanshme siç parajmëron edhe ajeti fisnik...

Në Kuran, sunet dhe në sijeru'n-Nebi që mund ta quajmë përvojë e epokës së lumturisë është përjetuar një periudhë në të cilën aspak nuk është lejuar lufta, por gjithashtu janë përjetuar edhe periudha në të cilat të gjithë kanë shkuar në xhihad... Andaj, nëse çështjet i analizojmë duke i marrë parasysh të gjitha, do të arrijmë në rezultate të duhura. Sigurisht se në shembullin që ka lidhje me epokën e lumturisë nuk gjenden problemet që po i shohim sot, sepse, ndërkohë që ata i përkisnin periudhave të përkohshme të një procesi, sot po flasim për praktikën e gabuar të atyre që marrin si model vetëm një prej praktikave të asaj kohe dhe ndërtojnë një sistem mbi të. Për shembull, edhe parimi i “Tedrixhit” mund të keqpërdoret. Tedrixh nuk do të thotë të fshehësh esencën e mesazhit dhe ta mashtrosh bashkëbiseduesin e tij (njeriun) në çështjen e asaj që e fton ai mesazh. Kur te flasim për Tedrixhin, në mendje duhet të na vijë ndalesa e alkoolit. Po,



kjo ndalesë është plotësuar në katër shkallë dhe katër vite pas hixhretit. Por i Dërguari i Allahut (a.s.), e vinte në pah qëndrimin e tij duke mos pirë aspak alkool. Edhe Ebu Bekri (r.a.), i cili ishte prej shokëve të tij më të afërt, nuk ka pirë fare alkool. Këshu, alkooli ishte hequr de facto. Edhe mbulesa është bërë farz (obligim) në vitin e pestë të hixhretit, por le të shohim edhe këtë shembull që është përjetuar para hixhretit dhe që tregon edhe vuajtjet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), që i ka hequr për të predikuar Islamin. Mudrik el-Ezdi tregon:

“Bashkë me babain tim po bëja haxhin (e xahilijetit). Pasi shkova në Mina dhe u vendosa aty, u takova me një grup njerëzish. Babain e pyeta: “Përse është mbledhur ky grup?” Ai më tha: “Janë mbledhur për atë njeri që e ka lënë fenë e popullit të tij.” Kur i hodha sytë nga ana që ma bëri me shenjë, pashë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ai po thoshte: “O njerëz! Thoni la ilahe il-la’ll-llah, në mënyrë që të shpëtoni!” Dikush prej njerëzve e pështynte në fytyrë, dikush i hidhte dhe në kokë dhe dikush tjetër e ofendonte. Kjo situatë vazhdoi deri në drekë. Në ato momente erdhi një vajzë, të cilës i ishte hapur jaka, me një enë uji dhe një shami në dorë. Ajo po qante. I Dërguari i Allahut (a.s.), piu ujë nga ena dhe i lau duart e fytyrën. E ngriti kokën dhe i tha:

“Bija ime! Mbuloje jakën me mbulesën tënde! Mos u frikëso për babain tënd me mendimin se do të bjerë në kurth, do të vritet apo do të poshtërohet!” Ne pyetëm se kush ishte ajo vajzë. Na thënë: “Ajo është vajza e tij, Zejnebja.” (Hejsemi, VI, 21.) Ja mbulesa... Akoma nuk kishte një shoqëri besimtare apo një shtet që të udhëhiqej nga jurisprudenca islame, por mbulesa ishte. Për këtë arsye, tedrixhin duhet ta kuptojmë drejt.

Çfarë ndodh nëse nuk e kuptojmë saktë tedrixhin? Në pah del një fe e cunguar me mesazhe të përzgjedhura. Apo siç shprehet edhe Kurani Fisnik, në pah del një fe që është humbje si në këtë botë, si në botën tjetër për njerëzit. Nëse një praktikë që i përket një procesi përgjithësohet, gjërat që kanë zënë vend në kohën e epokës së lumturisë nuk mund të zënë vend dot në këtë strukturë të njëanshme. Dje janë dhënë fetva për të shpëtuar nga ndalesa e shamisë së kokës nëpër universitete. Tani nuk është më një ndalesë e tillë, por përsëri ka prej atyre që nuk e mbulojnë kokën edhe pse janë besimtare. Atyre u thuhet: “Dje keni përdorur këtë leje (në fjalë) për të hyrë si studente nëpër universitete, ndërsa tani do ta

përdornin për të hyrë si pedagogë!.. Sidoqoftë, kjo nuk është një çështje besimi!.. Mos vallë të ngelin bosh ato vende? Pastaj urdhri i mbulesës ka zbritur shumë vonë...” Ja pra, kjo nuk është feja që ka predikuar Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Tani le ta shtjellojmë çështjen nga një këndvështrim i ndryshëm:

Me të vërtetë, a nuk është vepra një çështje besimi?

Me të vërtetë, lidhja besim-vepër është një fushë që ka rënë viktimë nga shtrëngimet e njëanshme. Nëse e merrni për bazë njëren prej këtyre shtrëngimeve (metodave) të njëanshme, përsëri e ngushtoni fenë apo e nxirrni nga rrjedha e saj. Cilat janë këto metoda të ndryshme:

1. Metoda frikësuese / thirrje për te istikameti: Në këtë metodë vepra dhe besimi shfaqen si një tërësi. Për shembull:

“Ai që bën zina (imoralitet), e nxjerr këmishën e besimit kur e bën këtë mëkat të madh. Mëkatet e mëdha janë vepra të qafirave. Ai që ka mendjemadhësi në zemër qoftë edhe sa një grimcë, ai që i përgojon të tjerët, etj. nuk mund të hyjë në xhenet.” Kur në këtë metodë frikësuese bëhet fjalë për besimtarin, flitet për një besimtar të përsosur. “Nëse njeriu nuk do për vëllain e tij atë që do për vete, ai nuk është besimtar.” Këto mendime i paralajmërojnë besimtarët nga një këndvështrim në të cilin përparësi ka aspekti i idealizmit. Gjithashtu ky këndvështrim nuk i lë fushëveprimi plogështisë dhe gjithmonë synon përsosmërinë. Nëse nxirret ndonjë dispozitë prej këtyre ajeteve dhe haditheve duke mos marrë parasysh se ato klasifikohen në metodën e të frikësuarit, patjetër duhet që vepra të konsiderohet si një pjesë e besimit, pra, besimtarin që bën mëkate të mëdha për ta nxjerrë nga besimi ose, nëse nuk nxirret dot nga besimi, për ta vendosur në një pozitë ndërmjet qafirit dhe besimtarit. Edhe fraksioni Mutezile këtë pati bërë. Pasi kësaj punë iu përzi edhe politika, në pah dolën Havarixhët dhe Vahabistët (të cilët janë radikalët e kohës sonë të apasionur pas terrorit) që thonë: “Meqë është qafir, atëherë është e lejuar vrasja e tij!”

2. Metoda tërheqëse / Thirrje për në besim: Në këtë metodë theksohet besimi dhe veprat shpirtërore:

“Ai që ka besim qoftë edhe sa një grimcë në zemrën e tij, do të hyjë në xhenet. Ai që thotë si fjalë të fundit la ilahe il-lall-llah, do të hyjë në xhenet. Allahu i fal mëkatet. Ai ka falur edhe

vrasësin e njëqind vetave. Shpresa nuk pritet nga mëshira e Allahut Teala. Gruaja që i bindet bashkëshortit të saj do të hyjë në xhenet. Hafizët dhe dëshmorët do të ndërmjetësojnë, ndërsa në krye vjen ndërmjetësimi i madh i të Dërguarit të Allahut (a.s.). E rëndësishme është që të jemi me besim në frymën e fundit.”

Në të njëjtën kohë, kjo metodë sjellë edhe të vërtetën në përputhje me Librin rreth çështjes së besimit. “Baza është aprovimi i zemrës. Besimi ekziston në zemër. Ajo që pritet prej një besimi të përsosur është reflektimi i tij edhe në sjellje. Por ja që njerëzit bien në gabime për shkak të nefsit, shejtanit dhe pengesave të tjera të ngjashme me këto. Madje, e vërtetë është se nuk ka asnjë rob të pagabueshëm. Atëherë zemra duhet të ketë shumë kujdes ndaj dashurisë dhe besimit të saj. Ata që nuk e frenojnë dot veten nga mëkatet dhe që nuk i kryejnë dot detyrat e tyre ashtu siç duhet, të paktën të mos e çojnë gjendjen e tyre deri në mohim. Por krahas faljes së Allahut, nuk duhet të harrojnë edhe zemërimin dhe ndëshkimin e tij.”

Nëse joshja e kësaj metode nuk bashkohet me frikësimin e metodës tjetër, do të përballemi me portretin e myslimanëve që nuk falen e që nuk luten siç po e shohim edhe në ditët e sotme. Pra, do të kemi myslimanë që shkojnë vetëm në namazin e xhumasë apo atë të bajramit. Ndërkohë, edhe vepra është për ta mbrojtur dhe vërtetuar besimin.

Nxjerrja e besimit në plan të parë dhe hedhja e veprës në plan sekondar është e papranueshme. Vepra menjëherë duhet të vendoset në pozitën e dytë që ka, por pa ia humbur rëndësinë që mbart. Edhe tarikatet tepër tolerante dhe që e kanë humbur istikametin në dimensionin e veprës në ditët e sotme, në të kaluarën e tyre kanë pasur prej atyre që patën qenë kapur shumë pas kësaj pikës së dytë. Kjo domethënë se ata që thonë: “Sidoqoftë nuk është çështje besimi!” – nesër i pret i njëjti rrezik. Sidomos kur bëhet fjalë për influencën përsheptuese të ndryshimeve shekullore të ahirzamanit / kohës së fundit.

Nisur nga ato që thamë më lart, çdo besimtar duhet të përdorë kundrejt nefsit të tij metodën frikësuese dhe kundrejt të tjerëve metodën tërheqëse apo joshëse. Ndërkohë nuk duhet të harrojë se feja nuk përbëhet nga njëra prej këtyre, por nga të gjitha. Feja jonë islame ka si parim mesataren dhe peshoren e ndjeshme e të përpiktë. Shembujt

janë të shumtë:

Nëse do t’ju flisja për “mbrojtjen e shfaqjeve të kulturës dhe civilizimit të Islamit dhe për mbylljen e veshëve ndaj mesazheve juridike dhe politike të tij...” – patjetër se në mendjen tuaj do t’ju vinin disa organizata.

Po nëse ju flas për ata që e shohin pothuajse si kusht shkatërrimin e civilizimit dhe kulturës dhe që e shohin Islamit vetëm nga këndvështrimi i hadithit: “Çdo bidat është humbje!” Një dijetar i edukuar në shkollat e njëanshme të këtij mendimit të fundit, pohoi se Java e Kremtimit të Ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilën e përjetuam në ditët që kaluam, është shkaktarja e të gjitha problemeve të botës islame. Në këtë mënyrë, nxori në pah një qasje që nuk i pranon as aktivitetet si leximin e poezive dhe shpërndarjen e llokumeve.

Nga ana tjetër, edhe qasja e atyre që thonë vetëm kulturë dhe asgjë tjetër, kanë nxjerrë në pah vepra të papranueshme për ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke e përkujtuar Hz. Pejgamberin me tablo xhahilijeti, të cilën ai është munduar ta zhdukë, si recitimi i poezive nga vajzat e reja përpara djemve të rinj. Ndërkohë ajo që duhet të bëjnë besimtarët është përkujtimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), në ditë apo javë të caktuara me aktivitete të përshtatshme ndaj emrit të tij dhe në përputhje me sheriatin. Gjithashtu, nëse ju flas për ata që e ndërtojnë Islamit vetëm mbi dashurinë ndaj ehli bejtit dhe njerëzve, në mendje do t’ju vijë këndvështrimi fetar i shtrënguar dhe që e ka humbur vërtetësinë e tij. Nga ana tjetër, çfarë do të mendonit nëse do t’ju thosha se ka edhe prej atyre që përpiqen ta vendosin në pozitë të zakonshme, lërinin sahabët apo ehli bejtin, por vetë të Dërguarin e Allahut (a.s.)? Po nëse ju them se ka prej atyre që e shohin Islamit vetëm si një iluminizëm racional?

Problemi është ngushtimi vetëm në një aspekt, jo nxjerrja e dispozitës së duhur duke i përfshirë të gjitha aspektet dhe duke gjykuar sipas metodës e argumentit... Jo vetëm dashuri, por jo edhe vetëm frikësim... Jo vetëm shpresë, por jo edhe vetëm shqetësim... Jo vetëm esencë, por jo edhe vetëm formalitet... Jo vetëm vetmi, por jo edhe vetëm shërbim... Jo vetëm ndërgjegje, por jo edhe vetëm ligji... Jo vetëm përgëzim me xhenet, por jo edhe vetëm qortim e frikësim me xhehenem... Andaj duhet të merren të gjitha dhe nga çdo aspekt...

"Thuaju (o Muhamed):

*Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua,
që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!"*

(Al'Imran, 31)

Ky ajet zbriti atëherë kur jahudijtë u shprehën "Ne jemi djemtë dhe të dashurit e Allahut", kur të krishterët thanë "Ne e adhurojmë Isain nga dashuria që kemi për Allahun" dhe kur mushrikët thanë "Ne adhurojmë idhujt për hatër të dashurisë që kemi për Zotin si dhe për hatër të besimit që kemi se ato do të na afrojnë kah Ai". Allahu i Lartmadhëruar i urdhëroi që t'u bindeshin Resulullahut, nëse janë të sinqertë në fjalët e tyre. T'i bindesh Resulullahut do të thotë të zbatosh ato që ai urdhëron, të largohesh nga ato gjëra që ai t'i ndalon dhe ta marrësh atë si shembull në çdo çështje. E kundërta e kësaj, që unë e dua Allahun, por nuk ia vë veshin urdhëresave të Tij, që nuk i dua ata që Ai do dhe ata që e duan, pra të dërguarit e Tij, kjo do të thotë se nuk dëshiron t'i përngjasosh atyre dhe se nuk do askënd tjetër përveç vetes, e si përfundim do të thotë se nuk dëshiron të ecësh në rrugën e tevhidit.

Kur u shpall ky ajet, hipokriti Abdullah ibni Ubej tha:

"Muhamedi po pretendon se bindja dhe adhurimi ndaj tij është bindje dhe adhurim ndaj Zotit. Ai po kërkon që ta duam atë si ashtu si të krishterët Isain."

Më pas, në lidhje me këtë u shpall ky ajet:

"Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!" (Al-i Imran, 31)

Me këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar na informoi neve se masa më e saktë e adhurimit dhe e bindjes ndaj Tij është i Dërguari i Tij. Sepse ata që njohin më së miri urdhëresat dhe ndalesat e Tij dhe që i zbatojnë ato më mirë, janë Pejgamberët. Ata e praktikuan pa asnjë mangësi rrugën e drejtë. Ata na e treguan në mënyrë të shkëlqyer se feja është rruga e të mesmes dhe e veprimit të matur. Pejgamberi i fundit e vizatoi rrugën e ndritur të Islamit, vlefshmëria e të cilit do të zgjasë deri në kijamet, duke e zbatuar atë në çdo sferë të jetës së tij. Ky stil jetese i përvijuar nga Resuli (a.s) në planin individual dhe në atë shoqëror, fjalët, veprimet e tij, miratimet apo kundërshtimet që ai ka shprehur ndaj veprimeve të të tjerëve, janë emërtuar me termin sunnet. Prandaj, të ruash sunetin dhe çdo gjë që ka ardhur me të, do të thotë të ruash islamini.

Pejgamberi -salallahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"Mirësia është morali i pastër (i bukur). Kurse gjynahu është ajo gjë që njerëzit nuk duan ta dijnë (mësojnë) edhe pse ajo ia shqetëson zemrën."

(Muslim, Birr 14, 15. Gjithashtu shih Tirmizi, Zuhd 52)

DY FJALË KOMENTI:

Njëra nga veçoritë e Hazreti Pejgamberit është aftësia për të shpjeguar gjëra shumë të vështira në mënyrë konçize dhe me shprehje të thjeshta e të qarta. Këtë cilësi ai e ka quajtur "xhevamiul-kelim".

Konceptet e së mirës dhe të së keqes nuk janë të thjeshta për t'u sqaruar me fjalë. Hazreti Pejgamberi shprehet se mirësia është morali i bukur, ndërsa në hadithe të tjera shpjegon se të kesh moral të bukur do të thotë të përballosh me durim çdo vështirësi, të mos mërzhitesh me tepri, si dhe të jesh i buzëqeshur e fjalëmbël.

Pejgamberi vendosi një masë për të kuptuar lehtësisht gjynahun dhe të keqen, duke thënë:

Në qoftë se kryerja e një vepre ta trazon shpirtin dhe ti nuk dëshiron ta marrin vesh të tjerët, atëherë ajo është e shëmtuar, është gjynah dhe e padëshiruar nga Allahu i Lartmadhëruar. Kjo, sepse pjesa më e madhe e njerëzve dëshirojnë që t'u dihet, t'u përmendet vepra e tyre e mirë, si dhe të shikohen me mahnitje dhe zili nga të tjerët. Kjo masë, e cila nuk gabon,

mund të përdoret krejt thjeshtë nga gjithsecili. Mjafton të dyshosh në lidhje me një vepër, dhe kjo përbën një argument të mjaftueshëm për braktisjen e saj.

Zemrat të cilat nuk janë nxirë krejtësisht nga papëstërtitë e gjynahut janë si pasqyra, të afta ta tregojnë të mirën dhe të keqen. Për këtë arsye, kur njeriu dëshiron të bëjë diçka duhet të shikojë fillimisht nga zemra. Në qoftë se njeriu ndjen një shqetësim të brendshëm nga kryerja e një vepre, nëse fillon ta brejë dyshimi dhe shqetësimi, atëherë ai duhet të heqë dorë urgjentisht nga ajo vepër. Sepse një ndërgjegje e pastër i tregon njeriut rrugën e vërtetë.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI

1- Destinacioni për ku duhet të drejtohet njeriu, është morali i bukur.

2- Njeriu mund të bëjë dallimin ndërmjet të mirës dhe të keqës nëpërmjet një zemre të pastër.

3- Në qoftë se kryerja e një vepre i jep shqetësime zemrës dhe ti nuk dëshiron ta marrë vesh kush, atëherë ajo vepër është me siguri gjynah.

Një Hadith



LUMTURIA FAMILJARE TË BËHESH NËNË E KREJT UMETIT

Bashkëshortet e Pejgamberit a.s. fituan emrin nënat e besimtarëve edhe pse ato nuk sollën në jetë fëmijë. Siç dihet vetëm Hz. Hatixhja dhe Hz. Marija lindën fëmijë. E megjithatë të gjitha u regjistruan në librin hyjnor si ummehat/ nënat e besimtarëve.

Le të sjellim një shembull:

Beshir bin Akrabe el-Xhuheni ﷺ tregon:

“U takova me të Dërguarin e Allahut në ditën e luftës së Uhudit dhe e pyeta:

- Në ç'gjendje është babai im?

- *Babai yt ra dëshmor, Allahu e mëshiroftë!* - u përgjigj ai.

Fillova të qaja. I Dërguari i Allahut më mori pranë vetes, më përkëdheli kokën dhe më tha:

- *A je i kënaqur nëse unë bëhem babai yt, ndërsa Aishja nëna jote?*” (Hejthemî, VIII, 161)

Ndërsa unë u përgjigja:

“Të qofshin falë nëna dhe babai o i Dërguar i Allahut, patjetër që jam i kënaqur!”

Edhe pse tashmë jam thinjur, aty ku preku dora e bekuar e Resulullahut, flokët janë ende të zeza.” (Buhârî, et-Târihu'l-Kebîr, II, 78; Ali el-Muttakî, XIII, 298/36862)

Bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut u bënë shembulli i mëshirës dhe dhembshurisë që buronte nga mëmësia. Ato u bënë edukatore të grave të umetit, harxhuan pasurinë e tyre për të blerë ro-

bëresha me qëllim që t'u dhuronin lirinë, i rritën dhe i martuan jetimet në përputhje me ajetin e mëposhtëm:

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju...” (Nur, 32)

Nisur nga kjo, të gjitha gratë e tjera të këtij umeti duhet të marrin shembull nga Nënata e Besimtarëve.

Kështu që;

Çdo besimtare duhet t'i dhurojë umetit mëshirën dhe dhembshurinë e një nëne, pavarësisht nëse Zoti

i ka dhuruar apo jo fëmijë. Kjo qasje duhet t'i përfshijë të gjithë dhe në mënyrë të veçantë fëmijët jetimë e të vetmuar duke u përpjekur që të jetë burim udhëzimi për secilin nga këto filiza që presin të formësohen.

Gjatë historisë shumë gra bamirëse kanë ngritur vakufe dhe

kanë përmbushur më së miri detyrën e mëmësisë.

Transmetohet se Sulltan Abdu'l-Hamidi nga 150 robëresha (shërbëtore) të sarajit ka ndihmuar në martesën e 149 prej tyre përveç njëres që ishte me aftësi të kufizuara.

Orientimi drejt shembullit plot mirësi që ofron i Dërguari i Allahut në ndërtimin e jetës familjare dhe mbrojtjen e saj, është një domosdoshmëri.

Dashuria dhe respekti që shohim tek bashkëshortet e Pejgamberit është e paarritshme.





Po ashtu edhe dashuria dhe mirësjellja e të Dërguarit të Allahut ndaj bashkëshorteve të tij është e pashembullt.

Asnjë vajzë nuk mund ta dojë babain e saj siç e deshi Hz. Fatimja Resulullahun.

Asnjë baba nuk mund ta dojë vajzën e tij siç e deshi Resulullahu Hz. Fatimen.

NËNA E EHLE BEJTIT

Një tjetër shembull i shquar nga nënat fisnike të këtij umeti është edhe Hz. Fatimja.

Ajo është fëmija i vetëm i të Dërguarit të Allahut që ka jetuar gjatë gjithë jetës së tij, është nëna e Hz. Hasanit dhe Hz. Husejnit, është bashkëshortja e Hz. Aliut dhe padyshim burimi i mirësive të pafundme.

Kur femohuesit e Mekës ofenduan dhe sulmuan të Dërguarin e Allahut, ajo vrapoi drejt tij për ta ndihmuar dhe mbështetur pa u frikësuar aspak nga keqberësit (nga mizora e tyre.). Nisur nga kjo dhembshuri që tregoi ndaj babait të saj u quajt “nëna e babait të saj” (ummu ebi).

Hz. Fatimja fizikisht ishte e dobët dhe e pafuqishme. Ndërsa punët e shtëpisë ishin shumë të lodhshme. Kur ndizte zjarrin për të gatuar ndodhte që shkëndijat e flakës t’i digjinin vende-vende fustanin. Mbulohej e tëra nga pluhuri sa herë pastronte shtëpinë me fshesë. Shpesh duart i gjakoseshin kur bluante miellin në mulli e shpina i zinte plagë nga bartja e ujit. Por pavarësisht vështirësive ajo nuk ka patur kurrë shërbyese. Bereqeti i familjes së tyre ishte devotshmëria, mbështetja dhe kënaqësia ndaj Allahut.

Në jetën e tyre modeste ka shembuj kuptimplotë

të dhurimit në kushte të vështira.

Transmetohet se;

Hz. Fatimja bashkë me bashkëshortin e saj Hz. Aliun për tri ditë rresht i dhuruan ushqimin e tyre të vetëm, një të varfri, jetimi dhe një robi të cilët trokitën derën e tyre pikërisht në kohë yftari. Për rrjedhojë Allahu i Lartësuar zbriti këto ajete:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë:

Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!

Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.

Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.” (Insan, 8-11)

Le të sjellim shembullin e një tjetër zonje fisnike që ka lënë gjurmë në historinë islame:

Siç vepronte shpesh, një natë Hz. Omeri kishte dalë rrugëve të Medines. Kur po kalonte pranë një shtëpie dëgjoji dy persona duke biseduar me zë të lartë. Nëna po i thoshte vajzës:

“Bija ime, shto pak ujë në qumështin që do shesim nesër.”

Vajza u përgjigj:

“Nënë e dashur, halifja na e ka ndaluar ta përziejmë ujin me qumësht.”

Këtë herë nëna i foli me ton qortues:

“E si do ta marrë vesh halifja që kemi shtuar ujë në qumësht në këtë kohë të natës?”

Përsëri vajza, zemra e së cilës ishte ndriçuar me devotshmëri, nuk pranoi urdhrin e gabuar të nënës së saj dhe tha:

*“Nënë e dashur,
edhe sikur të mos shohë
halifja, sheh Allahu.
Është e lehtë ta fshehim
këtë hile nga njerëzit,
por është e pamundur ta
fshehim atë nga Krjuesi
i Gjithësisë që sheh dhe
di gjithçka...”*

“Nënë e dashur, edhe sikur të mos shohë halifja, sheh Allahu. Është e lehtë ta fshehim këtë hile nga njerëzit, por është e pamundur ta fshehim atë nga Krjuesi i Gjithësisë që sheh dhe di gjithçka...”

Hz. Omeri pasi e gjeti këtë vajzë, e martoi me të birin e tij, Asimin. Nipi i kësaj familjeje të begatë, Omer bin Abdulazizi, u bë halifja i pestë i myslimanëve.

Siç e shohim edhe në këtë shembull, nëna të tilla fisnike kanë qenë mbështetja më e madhe e personaliteteve të shquar të historisë. Edhe nëna e Abdulkadir Gejlanit ka qenë një prej tyre.

Tregohet se Abdulkadir Gejlani udhëtoi në kërkim të dijes që në moshë shumë të vogël. Karvani ku ai udhëtonte një ditë u ndal nga plaçkitësit të cilët e pyetën:

“A mban ar me vete?”

Ai me shumë naivitet u përgjigj:

“Në këmishën e brendshme nëna më ka qepur një kuletë ku mbaj 40 monedha ari.”

I pari i plaçkitësve u befusua nga kjo përgjigje dhe e pyeti:

“Djalë, përse tregove që mban ar me vete? Sikur të mos flisje askush nuk do të të kontrollonte.”

Djaloshi tha:

“Kur u largova nga shtëpia i premtova nënës sime që nuk do të gënjej kurrë. E si mund ta prish premtimin tim për 40 monedha ar?”

Të mahnitur nga kjo fisnikëri dhe dinjitet që buronte nga zemra e djaloshit të vogël, plaçkitësit u penduan dhe hoqën dorë nga ai akt i shëmtuar duke u bërë njerëz të mirë.

Ja pra, këto nëna u bënë shembujt më të bukur të umetit islam. Përgjatë gjithë historisë ata u bënë edukatore të nënave të reja si simbol i ndershmërisë, dëlirësisë, dhembshurisë, shërbimit, mëshirës dhe bujarisë.

Ka shumë prej tyre që sot nuk ua dimë as emrin. Kjo sepse ata e ruajtën të fshehur mirësinë e tyre larg syfaqësisë dhe e kushtëzuan vetëm në diturinë e Allahut të Lartësuar. Kjo gjendje nuk kishte të bënte me atë që shumë njerëz të paditur dhe të cektë e quajnë sot, si: “qëndrim në plan të dytë”. Por ishte një zgjedhje e vetëdijshme në përputhje me natyrën e pastër islame. Përndryshe, në ditët tona shohim se sa më shumë të vendosen në të ashtuquajturën “plan të parë”, gratë detyrohen të marrin përsipër edhe përgjegjësitë e burrave. Si rezultat, ato përballen

me çrregullime të rënda psikologjike.

Sidoqoftë, këto zonja fisnike kanë lënë gjurmë në histori përmes bamirësive të tyre:

Bashkëshortja e Harun Reshidit, zonja Zubejde ka harxhuar një pjesë të madhe të pasurisë për t’u siguruar haxhilerëve ujë të freskët. Akoma sot përmendet me emrin e saj kanali i ujit që ka çelur. Gjatë historisë i njëjti kanal është mirëmbajtur nga bashkëshortja e Kanuni Sulltan Sulejmanit, Sulltanësja Mihrimah dhe më pas nga halla e Sulltan Abdulhamitit, Sulltanësja Adile dhe të afërmit e saj.

Në historinë Osmane janë regjistruar 1400 vepra bamirësie. Ky numër tregon vetëm ato që kanë kaluar në regjistra. Por në mënyrë të veçantë vakufet e oborrarëve të sarajit ishin shumë të mëdhenj dhe të jashtëzakonshëm.

ATO NËNA...

Sulltanësja Nur Banu Valide ka ndërtuar shumë vepra bamirësie si në pjesën aziatike ashtu edhe në pjesën evropiane të Stambollit. Pjesë e këtyre veprave janë edhe xhamia Atik Valide në Yskydar, mensa për të varfërit (imaret’hane), medreseja, qendra shëndetësore (darush-shifa, ose spitale), hamame për meshkuj dhe për femra.

Sulltanësja Mahpejker Kosem Valide ka hedhur themelet e Xhamisë së Re, ka ndërtuar Xhaminë Xhinili në Yskydar dhe pranë saj edhe një mekteb, çezme, daru’l-hadith (shkollë për mësimin e haditheve) dhe një sebil (struktura prej guri, e bërë posaçërisht ngjitur me xhamitë, ku shpërndahej uji i pijshëm për bamirësi) si dhe një xhami tjetër në Anadolu Kavagi.

Vakufi që ajo ngriti enkas për t’i mbrojtur dhe martuar vajzat jetime është një simbol i vyer i mëshirës. Tërheq vëmendjen fakti që edhe Sulltanësja Kosem e njohur në histori për madhësitinë dhe autoritetin e saj tregonte mëshirë dhe dhembshuri në mënyrë të natyrshme.

Sulltanësja Hatixhe Turhan përfundoi ndërtimin e Xhamisë së Re, themelet e së cilës ishin hedhur më parë. Po ashtu, pranë saj ndërtoi vepra të tjera bamirësie, si: mejtep, medrese, mensë, bibliotekë dhe çezme.

Tërheq vëmendjen po ashtu edhe mbishkrimi në vakfijen e Xhamisë së Re ku thuhet:

“Gjatë netëve të Ramazanit dhe Netëve të Mëdha në disa çezme do të rrjedhë sherbet i përgatitur nga mjalti më cilësor i kohës me të cilën do të gostitet

xhemati i xhamive.”

Sulltaneshja Pertevnijal Valide ka ndërtuar në Aksaraj të Stambollit Xhaminë Valide dhe Mexhidin Ja Vedud dhe më pas një bibliotekë, çezme dhe mejtep.

Sulltaneshja Mihrimah ka ndërtuar po ashtu nga një xhami të llojit “selatin”¹ në Edirnekapi dhe në Yskydar.

Sipas traditës Osmane ndërtimi i xhamive me dy minare ishte karakteristikë e sulltanëve. Sot komplekset historike të xhamive me dy minare mbeten një kujtim prej tyre.

Një ndër sulltaneshat më bujare dhe bamirëse është **Sulltaneshja Bezmialem Valide** e cila ka ndërtuar plot vepra bamirëse që kanë shërbyer për shekuj me radhë dhe janë bërë pjesë tashmë e historisë. Xhamia më e madhe që ka ndërtuar është Xhamia Valide përballë Sarajeve të Dollmabahçes. Edhe Ura e famshme e Gallatës është vakuf i saj (vepër bamirësie).

Është domethënëse vakfija e një prej vakfeve që ajo ngriti në Sham. Aty thuhet:

“Të ardhurat e këtij vakufi do vihen në shërbim të dëshmërbimit të sendeve të thyera apo të dëmtuara nga shërbëtorët me qëllim që të mos nëpërkëmbet dinjiteti dhe personaliteti i tyre.”

Një nga veprat më madhështore bamirëse të Sulltaneshës Valide është Spitali “Gurabâ-i Muslimîn” të cilin e ndërtoi duke dhuruar të gjithë pasurinë e saj. Kjo vepër e mrekullueshme që nga viti 1843 i ka shërbyer sidomos shtresës së varfër të shoqërisë. Edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë nën shërbimin e komunitetit nën emrin Spitali Bezmialem Valide Sulltan.

Të njohur për bamirësinë e tyre, **Kamil Pasha** dhe bashkëshortja e tij **Zonja Zejnep** ndërtuan spitalin “Zejnep Kamil” i cili sot është ende në shërbim të shoqërisë duke u bërë kështu për vite me radhë një

sadaka rrjedhëse për to.

Mbaj mend të kem dëgjuar një histori nga babai im i ndjerë (rahmet pastë) Musa Efendiu në lidhje me këtë familje të njohur me bujarinë e tyre të madhe:

Dera e shtëpisë së kësaj familjeje qëndronte e hapur gjatë gjithë Ramazanit. Një ditë Sulltan Abdula-zizi erdhi për yftar në konakun e Kamil Pashës dhe zonjës së tij Zejnep. Pas gostitjes i erdhi rradha e “diş kirasi”. “Dis kirasi” ishte emri elegant i dhuratës që i jepej mysafirëve pas gostitjes në sofër.

Kryeveziri Jusuf Kamil Pasha vendosi tapinë e atij konaku madhështor si dhe disa dokumente të tjera në një tabaka argjendi dhe ia shtroi Sulltan Abdulazizit në shenjë dhurate si “diş kirasi”.

Sulltani e mori:

“U ndjeva i gëzuar dhe i vlerësuar! Tani edhe unë po jua dhuroj ju.” - tha dhe ua ktheu dhuratën.

Ndërsa Zonja Zejnep në shenjë dhurate vendosi në tabakanë e argjendë një Mushaf me kaligrafi të Shejh Hamdullah të shkruar dhe të zbukuruar me bojë ari, të cilën padishahu e pranoi pasi e puthi tri herë dhe e vendosi në ballë në shenjë respekti.

Me pak fjalë, ato nëna fisnike zotëruan pasuri përrallore, thesare dhe xhevahire të mahnitshme. Por ata nuk ranë pre e egos së tyre, përkundrazi dhuruan gjithçka për umetin.

Sot nuk i shohim pasuritë e tyre të ekspozuara nëpër muze. Por e ndjejmë shkëlqimin e kupolave të Stambollit dhe qyteteve të tjera. Shpërblimi i bamirësisë së tyre do vazhdojë të ruhet në fletoren e veprave të mira deri në Ditën e Kijametit. Kjo është pasuria e vërtetë, ky është thesari më i çmuar...

SEKRETI I FITOREVE

Nënat fisnike ishin fuqia e padukshme që fshihej pas fitoreve dhe sukseseve. Ato janë heroinat e padukshme të fitoreve të të parëve tanë, që rritën dhe

*“O ju njerëz!
Respektoni të drejtat e
grave! Silluni me mirësi
dhe dashuri ndaj tyre! Ju
këshilloj t’i frikësoheni
Allahut për hakun e tyre.
Ju i keni marrë gratë tuaja
si amanet nga Allahu dhe i
keni bërë të lejuara nderin
dhe dëlirësinë e tyre në
emër të Allahut!”*

(Muslim, Haxh, 147)

1. Xhamitë Selatin, janë xhami të ndërtuara nga sulltanët dhe sulltaneshat. (shën. i përkthyesit.)

edukuan trima të vërtetë, i mëkuan ata me qumështin më të dëlirë, dhe i rritën me ninullat e lutjet për fitore të mëdha.

Kur në betejën e Uhudit Hz. Sumejra mori lajmin e martirizimit të dy djemve, babait, bashkëshortit dhe vëllait e saj, fillimisht ajo pyeti me një shqetësim të madh:

“A i ndodhi gjë të Dërguarit të Allahut?”, por pasi pa që Ai ﷺ ishte gjallë tha:

“Të qofshin falë nëna dhe babai o i Dërguar i Allahut! Nuk më shqetëson asgjë tani që të pashë (shëndosh e mirë)!”

Po ashtu në luftën e Kadisijes, Hz. Hansa humbi katër djemtë e saj dhe kur e mori vesh lajmin e hidhur e falënderoi Allahun me një ndjenjë të lartë besimi duke thënë:

“Qofshin falë katër djemtë e mi për një fitore të Islamit. Falënderimet i qofshin Allahut që në Ditën e Gjykimit do më ringjallë si nënë e katër dëshmorëve.”

Ishin ato nëna që i dërgonin bijtë e tyre në luftë sikur t'i dërgonin në dasmë. Ishin po ato nëna që i dërgonin bijtë e tyre kundër armikut pasi bashkëshortët nuk ktheheshin më.

Ato nëna u bënë heroinat e suksesit të Çanakalasë. Ardhmëria e një kombi arrihet vetëm përmes edukimit të një brezi me zemër të ndjeshme të mbushur me ndjenjën e lartë të sakrificës. Një brez që hodhi në vargjet e ninullave epopenë e Çanakalasë do dijë të mbrojë natyrshëm fenë, gjuhën, historinë, flamurin, atdheun e kombin, me pak fjalë të gjitha vlerat materiale dhe shpirtërore.

Kjo është vlera dhe dinjiteti që i është dhënë një nëne fisnike në fenë tonë dhe në historinë tonë të lavdishme.

PLASARITJE XHAMI

Fatkeqësisht në ditët tona mëmësia dhe detyrat e gruas në familje nuk vlerësohen sa duhet. Në kundërshtim dhe ndryshe nga natyra e tyre e krijimit, femrat po kthehen në objekte komerciale dhe

po përfshihen në çdo fushë njësoj me burrat. Këto thirrje egoiste, për fat të keq kanë gjetur përgjigje në shumë njerëz që lëngojnë nga dëshira për t'u dukur.

Në të kaluarën vajzat edukoheshin që herët për të genë të afta të kryejnë detyrën si nënë dhe si amvisë dhe përgatisnin pajën e tyre duke mos e hequr dore kanavacën dhe dantellën. Fëmijët edukoheshin t'u shërbenin në mënyrë të veçantë të moshuarve dhe mysafirëve.

Ndërsa tani me keqardhje shohim që edhe vajzat e mbuluara shpenzojnë kohën duke qëndruar nëpër kafene.

Në ditët tona, dërgimi i fëmijëve në kopshte, i prindërve në azile, endja deri në hutim pas një edukimi dhe karriere në ambiente të çoroditura, darkimi në ambiente të jashtme, apo porositja e ushqimit nga jashtë është kthyer në një stil jete në përmasa epidemike që po minon gjithnjë e më shumë familjen,

bereqetin dhe dashurinë. Jemi përballë një brezi që nuk di as të gatujë.

Fatkeqësisht, rrymat feministe dhe të barazisë gjinore kanë depërtuar tashmë edhe në shoqërinë tonë. Që nga koha e Tanzimatit, relativisht ishim të mbrojtur materialisht dhe shpirtërisht në saje

të strukturës së fortë familjare që zotëronim. Por tashmë këto rryma kanë depërtuar thellë në familjet tona. Numri i divorceve është shtuar. Dhuna në familje dhe në mënyrë të veçantë ndaj gruas është shtuar.

E vërteta është që këto nuk janë dëgjuar në historinë e të parëve tanë. Ishte e famshme shprehja “Nuk ngrihet dorë ndaj femrës - Femra është e paprekshme”, ajo mbahej me respekt dhe vlerësohej.

Shkaku më i madh i dhunës në familje është nënvlerësimi dhe dobësimi i edukimit shpirtëror.

Feja jonë përmes normave dhe moralit të bukur e ka garantuar paqen dhe qetësinë shpirtërore në familje.

Në Kuranin fisnik thuhet:

“Jetoni e silluni mirë me to (gratë)!” (Nisa, 19)



I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Më i miri nga ju është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij...” (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 50; Dârimî, Nikâh, 55)

“Mos i rrihni gratë tuaja! Ata që i rrahin gratë e tyre nuk janë prej të mirëve.” (Ebû Dâvûd, Nikâh, 42; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 51)

“O ju njerëz! Respektoni të drejtat e grave! Silluni me mirësi dhe dashuri ndaj tyre! Ju këshilloj t’i frikësoheni Allahut për hakun e tyre. Ju i keni marrë gratë tuaja si amanet nga Allahu dhe i keni bërë të lejuara nderin dhe dëlirësinë e tyre në emër të Allahut!” (Muslim, Haxh, 147)

Për sa kohë gratë të garojnë me burrat në emër të feminizmit dhe barazisë gjinore, ato do të mbesin pre e sjelljeve të ashpra të shoqërisë.

Vlerësimi i çështjeve familjare në mënyrë të njëanshme është e gabuar. Në ditët e sotme dhuna në familje e burrave ndaj grave po merr përgjigje me të njëjtën monedhë nga ana e grave. Kjo është njësoj si të mundohesh të fikësh zjarrin me flakë. Një plan i fshehtë dhe djallëzor po mundohet të shkatërrojë familjen.

Qasjet e sotme ndaj gruas nuk mund të quhen aspak përpjekje për ta vlerësuar atë. Personalitete të shumta të grave fisnike që i kemi përmendur në temat e mëparshme kanë lënë gjurmë në histori përmes vlerave të tyre shembullore.

Por përpjekjet e sotme për ta njësuar gruan me burrin në kundërshtim me natyrën e saj të krijimit, nxitja e tyre për të vrapuar në të njëjtin drejtim me ta, s’është gjë tjetër vetëm se zhvlerësim i figurës së gruas, përpjekje për ta shkatërruar familjen dhe për t’i lënë fëmijët pa përkujdesje.

Vlera e gruas nuk shfaqet duke u ekspozuar por duke u mbuluar. Gruaja fisnike është e çmuar brenda intimitetit të familjes. Mbulesa është nderi dhe dinjiteti i femrës myslimane. Qëndrimi i saj larg të huajve është mbrojtje për të.

ISLAMI DHE NATYRA E PASTËR E KRIJIMIT

I Dërguari i Allahut thotë:

“Gratë janë gjysma plotësuese e burrave.” (Ebû Dâvûd, Tahâret, 94; Tirmidhî, Tahâret, 82)

Tek Krijuesi Fuqiplotë burrat dhe gratë nuk zotërojnë asnjë epërsi ndaj njëri-tjetrit përveç se në shkallën e besimit, adhurimit, apo në çështjen e

llogaridhënies. Epërsia qëndron vetëm në nivelin e devotshmërisë.

Mes burrave dhe grave ekzistojnë dallime të natyrshme, por që në të njëjtën kohë plotësojnë njëri-tjetrin. Në këtë pikë Islami bën një ndarje të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve në përshtatshmëri me këto dallime.

Islami kundërshton me forcë çdo tendencë krahasimi dhe barazimi mes burrit dhe gruas. Sepse kjo fe është kundër tjetërsimit të natyrës së pastër të krijimit.

Madje në Epokën e Lumturisë me shfaqjen e disave që dukej sikur po lakmonin njëri-tjetrin për karakteristikat e ndryshme që mbartnin, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin kuranor:

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët:

- meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar

- e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar.

Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Nisa, 32)

Sipas transmetimit të Muxhahidit ky ajet u zbriti pasi Ummu Seleme tha:

“O i Dërguar i Allahut! Burrat dalin në frontin e luftës, ndërsa ne jo, ne na jepet vetëm gjysma e trashëgimisë së burrave. Ah sikur të ishim edhe ne si ata. (Vâhidî, *Esbâbu’n Nuzûl*, Bejrut 1985, s. 104; Ibnu’l-Xhevzî, *Zâdu’l-Mesîr fi Ilmi’t-Tefsîr*, Bejrut 1384/1964, II, 69)

Sipas një transmetimi të Ikrimesë, gratë kërkuan të marrin pjesë në luftë duke thënë:

“Dëshirojmë që Allahu ta bëjë edhe për ne farz (detyrim) luftën në mënyrë që edhe ne të fitojmë shpërblimin e burrave.” Për rrjedhojë Allahu i Lartësuar zbriti ajetin kuranor:

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët.” (Vâhidî, *Esbâbu’n Nuzûl*, Bejrut 1985, s. 105)

Me pak fjalë mund të themi që:

Allahu i Lartësuar kërkoi prej nesh që burri dhe gruaja të ruajnë tiparet e natyrshmërisë së krijimit dhe të shërbejnë secili në fushën e vet në përputhje me këtë natyrshmëri.

Te besosh

— Ahmet Zijlan —

Besimi është koka e çdo gjëje. Kështu është edhe në adhurim, edhe në biznes, edhe në arsim, edhe në gjërat e tjera të ngjashme me këto. Nëse njeriu ka ndonjë problem në besim, veprat që bën as që shikohen... Sepse ato nuk shprehin ndonjë kuptim dhe nuk kanë ndonjë dobi. Ai që nuk beson, në fakt edhe nuk mund të veprojë. Edhe nëse vepron, vepron duke hezituuar dhe shkatërrohet që në problemin më të vogël me të cilin përballet. Prandaj, njeriu në fillim duhet të besojë vetë. Në fillim duhet të besojë vetë se do t'ia dalë mbanë, se do ta bëjë dhe se do ta arrijë qëllimin.

Në Kuranin Fisnik ka dy ajete që i lexojmë çdo ditë pas namazit të jacisë. Ato janë dhurata e Miraxhit... Pra, janë dy ajetet e fundit të sures Bekare. Si fillojnë ato: "Amene'rr-Rrasulu... Pejgamberi besoi." Në fillim beson i Dërguari i Allahut (a.s.). Pra, i beson mesazhit të tij, detyrës së tij dhe se do t'u sjellë njerëzve e shoqërive lumturinë... Beson se do t'i japë fund xhahiljetit, do t'i shkatërrojë idhujt dhe se do të ndërtojë civilizimin e virtyteve...

Këtu ka një mësim të mirë për të gjithë ata që fillojnë ndonjë punë të dobishme në këtë botë. Askush nuk duhet të thotë: "Të më besojë dikush dhe të më mbështesë, në mënyrë që edhe unë t'ia dal mbanë." Jo, jo, së pari duhet të besosh ti.

I Dërguari i Allahut (a.s.), nga njëra anë ishte një sipërmarrës. Ai hodhi hapin për ta ndërruar gjendjen e një shoqërie e cila kishte vite që jetonte në xhahiljet/injorancë. Ai e kishte të plotë edhe mbështetjen te Allahu, edhe besimin ndaj vetes. Me lejen e Allahut Teala e arriti suksesin për 23 vjet. Siç e pranoi thirrjen e tij i gjithë gadishulli arabik, edhe krahinat e gjera u njoftuan për mesazhin e Islamit. Prandaj është shumë e rëndësishme që njeriu t'i besojë pikërisht vetes së tij, por edhe liderët e kauzave të mëdha dhe sipërmarrësve të mëdhenj kanë nevojë për një kuadër që i mbështetin dhe u besojnë. Ata janë ndihmësit më të mëdhenj dhe burimet e moralit.

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, mori shpalljen e parë, shkoi në shtëpinë e tij duke u dridhur nga madhështia e asaj që kishte përjetuar. Ai një herë digjej nga temperatura dhe një herë kishte të ftohtë sikur ta kishte kapur sëmundja e malaries. Kur Hazreti Hatixhja e pyeti: “Çfarë të ka ndodhur?” – i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha ato që kishte përjetuar. Pastaj i tregoi rreth madhështisë dhe vështirësisë së detyrës për të cilën ishte zgjedhur. Ajo, nëna jonë e madhe, i tha: “Përse shqetësohesh?” Ai ia ktheu: “Kush do të më besojë mua?” Hazreti Hatixhja i tha: “Të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Ja, mbështetja më e madhe është mbështetja që të vjen nga shtëpia. Mbështetja që të vjen nga bashkëshortja. Mbështetja që të vjen nga njeriu më i afërt. Pa mendoni një herë për një bashkëshorte që i thotë burrit të saj: “Mos vallë je i çmendur? Përse merresh ti me këto gjëra? Mos do të na hapësh telashe?” Ky do të ishte një shkatërrim morali shumë i madh që në hapin e parë. Për këtë arsye, kanë thënë: “Pas çdo burri të suksesshëm ka një grua.”

Të besosh është shumë e rëndësishme. Besimi dhe besnikëria e njerëzve, të cilët ecin drejt një ideali, ndaj liderëve të tyre janë shumë të rëndësishëm. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, e formoi këtë kuadër në periudhën e Mekës. Allahu i Madhëruar atë kohë i dhuroi atij kuadri edhe ngjarjen e miraxhit, në mënyrë që t’i forcohej besimi. Domethënë, miraxhi ishte një ndërrim për të Dërguarin e Allahut (a.s.), por ishte edhe një sprovë e madhe për myslimanët e parë. Politeistët filluan të talleshin duke thënë:

“A e keni dëgjuar se çfarë ka thënë ai profeti juaj?! Ai paska shkuar deri në xhaminë Aksa. Sikur të mos mjaftonte kjo, paska shkuar deri në qiell. A edhe këtë do ta besoni? Mos na thoni se edhe kjo është e vërtetë!” Këto fjalë ia thanë edhe Ebu Bekrit (r.a.). Përgjigja e vetme e Ebu Bekrit (r.a.), ishte kjo: “Nëse e ka thënë ai, është e vërtetë.” Në këtë mënyrë, ai vuri në pah logjikën dhe arsyetimin e zgjuar të tij duke u shprehur: “Unë besoj se ai merr shpallje nga Allahu Teala dhe se takohet me Xhebrailin, alejhi’s-salam. Nëse u besoj këtyre, sigurisht se do t’i besoj çdo gjëje që thotë ai. Prandaj, çfarëdo që thotë ai është e vërtetë.”

Ja, kështu u bë Siddik Hazreti Ebu Bekri (r.a.). Përgjatë jetës 23 vjeçare të profesisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Bekri (r.a.), ishte mbështetësi më i madh materialo-financiar dhe shpirtëror i tij në Mekë, në hixhret, në Medinë, në luftërat dhe në çdo vend.

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u shtroi një gosti të afërmve të tij, asnjëri prej tyre nuk bëri zë. Ndërsa ata që mendonin si Ebu Lehebi filluan të ofendonin. Hazreti Aliu, edhe pse ishte një fëmijë i vogël, u hodh përpara dhe tha: “Ty të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!” Nderimi më i madh që Allahu Teala i dha Pejgamberit (a.s.), ishin këta besimtarë. Për këtë arsye, patjetër duhet të keni ndihmëtarë që i besojnë idealit tuaj dhe që besojnë se ju do ta arrini synimin që i keni vënë vetes. Nisur nga kjo, ju duhet të formoni një kuadër të sinqertë dhe besnik të atillë.

Disa prej pashallarëve që e kundërshtonin që në fillim rrethimin e Stambollit, përgjatë ditëve të rrethimit që kalonin, i propozonin Fatihut që ta hiqte rrethimin. Ndërsa Akshemseddini u bë mbështetësi më i madh i Fatihut dhe fuqia shpirtërore e tij duke insistuar për çlirimin. Më në fund, çlirimi u realizua me sukses. Prandaj, konsultimi është kusht, por patjetër duhet të bëhet me njerëz trim, të ditur dhe optimistë...

Ne kemi nevojë për njerëz që na këshillojnë në lidhje me dispozitat e fesë së Allahut të Lartësuar dhe që na japin kurajë për të bërë atë që është më e drejta e për të vepruar me ndershmëri. Gjithmonë duhet t’ua vëmë veshin njerëzve që na këshillojnë me fjalë të urta, me histori mësimdhënëse dhe me shembuj domethënës. Sado që ne të dimë, prapë se prapë kemi nevojë të pashmangshme për të dëgjuar dhe mësuar. Përse i përsërisin me qindra herë reklamat në radio dhe televizion? Sepse kështu gdhenden në mendje dhe zënë vend në memorie. Prandaj edhe ne kemi nevojë që ta dëgjojmë me qindra herë të vërtetën.

Babai im ka qenë një njeri që kishte biseda të ëmbla, orator, elokuent dhe një njeri me shpirt prej poeti. Ai bënte kuvende fetare duke treguar shembuj plot urtësi. Unë kam dëshmuar disa herë kur njerëzit e dëgjonin bisedën fetare të babait tim deri në orën dy apo tre të natës pa u mërzitur dhe bezdisur aspak. Gjithashtu ka pasur raste edhe kur

*Këtu
ka një mësim
të mirë për të gjithë ata
që fillojnë ndonjë punë të
dobishme në këtë botë.
Askush nuk duhet të thotë:
“Të më besojë dikush dhe të
më mbështesë, në mënyrë që
edhe unë t’ia dal mbanë.”
Jo, jo, së pari duhet
të besosh
ti.*

thoshin: “Mahmut aga, u bë vonë, por sidoqoftë na tregoi edhe më shumë!”

Më sipër thamë se edhe njëra prej urtësive të miraxhit ishte të provuarit e fuqisë së besimit të besimtarëve. Kjo sprovë nuk ishte e vlefshme vetëm për atë periudhë, por do të jetë e vlefshme deri në kiamet. Edhe dje ka pasur prej atyre që nuk kanë besuar, edhe sot ka prej tyre.

Një herë kur babai im ishte gjallë, një ditë para natës së miraxhit, një i pafe kishte mbledhur dy-tri veta në një tavolinë para lokalit dhe po i helmonte duke u thënë: “Si mund të dalë një njeri në qiell? Kjo na u quaka miraxh! Kë po mashtrojnë këta?” Ata tre burrat ishin trembur dhe i kishin thënë: “Si mund ta thuash këtë?” Ai ua kishte kthyer: “Vëllezër, a mund t’ua pranojë logjika juaj këtë? Si paska shkuar dhe paska ardhur pa i ftohur ende vendi në shtratin e tij? A mund të ndodhë diçka e tillë?” Ata të tre i kishin thënë për shkak të padijes së tyre: “Ai ka dalë në qiell, por ka dalë me syrin e zemrës.” Burri dukej qartë se ishte prej ateistëve materialistë që i ka helmuar ideologjia komuniste. Çfarë të kuptojë ai nga zemra dhe shpirti? Atyre u kishte thënë: “Mos u bëni kaq injorantë! Njeriu ka katër sy në zemër. Në dy prej tyre qarkullon gjak i pastër dhe në dy të tjerët qarkullon gjak i papastër. Njëri qarkullon në trup, ndërsa tjetri shko në mëlçi dhe pastrohet. Mos ka edhe ndonjë sy tjetër zemra që thoni se ka dalë në qiell me syrin e zemrës?”

Ndërkohë i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk është ngjitur në qiell ashtu si në botën e ëndrrave. Veçanërisht për Isranë, domethënë, për shkuarjen nga Mesxhidu’l-Haram në Mekë deri në Mesxhidu’l-Aksa në Kuds ka konsensus ndërmjet dijetarëve se ka shkuar me shpirt dhe me trup. Kjo vërtetohet me ajetin fisnik. Shumica dërmuese e dijetarëve janë në konsensus se ky udhëtim ka vazhduar në të njëjtën mënyrë, domethënë, me trup dhe me shpirt. A nuk është Allahu i plotfuqishëm? A nuk është Ai që i ka krijuar këto ligje të fizikës? A mund të jetë i varur Ai nga këto ligje? Asnjëherë... Nëse Ai dëshiron ta çojë në qiell robin e Tij, i krijon shkaqet dhe e çon. Por ja që burri nuk besonte. Çfarë mund t’i thoni atij në këtë situatë? Prandaj ai le të mohojë derisa t’i vijë vdekja, të ngrihen perdet, të vijë dita e kiametit dhe ta shohë atë botë me sytë e tij!

Këta tre burrat nuk i jepnin dot përgjigje atij. Për shkak se nuk ia mbyllnin dot gojën, filluan të shqetësoheshin prej tij. Nuk e di si ta quajmë, rastësi apo mirësi, por ja që në ato momente babai im po kalonte aty. Ata menjëherë i thirrën babait ngaqë e dinin se ai ishte orator, elokuent, mjeshtër në të folur dhe i aftë për t’i bindur të tjerët:

-Mahmut aga! Mahmut aga! A mund të vish pak?

-Çfarë ka ndodhur?

-Këtu ndodhet një i pafe dhe jobesimtar. Ai e mohon ngjarjen e Miraxhit. Thuaja ndonjë fjalë këtij!”

Babai im mori frymë thellë. Çështja ishte serioze... Burri i pafe ishte ulur dhe po devijonte njerëzit. Atij duhej t’ia tregonte cakun. Babai ishte ulur dhe i kishte pyetur: “Cili është problemi?” Ata i treguan për çdo gjë. Babai im u kishte thënë:

-Domethënë kështu ë? Shumë mirë. Atëherë, para se të fillojmë debatin, le ta nxjerrim në pah veten tonë. Kush je ti dhe kush jam unë? Çfarë je ti dhe çfarë jam unë? Që nga dita e parë e deri më sot njeriu ka gjetur dhe ka zgjedhur një të adhurar për vete. Qoftë ky i adhurar i vërtetë apo i gabuar. Dikush ka adhurar zjarrin, dikush ka adhurar idhujt, dikush ka adhurar lopët dhe dikush tjetër i ka besuar Allahut. Dikush është bërë i krishterë, dikush është bërë çifut, dikush është bërë kështu, dikush është bërë ashtu, ndërsa dikush tjetër është bërë mysliman. Kjo është një e vërtetë historike, apo jo?

-E vërtetë!

-Atëherë, cili prej këtyre je ti? Ta dimë këtë, në mënyrë që të debatojmë sipas kësaj.

Burri kishte thënë:

“Unë nuk pranoj asnjërin prej këtyre.”

“Unë t’i thashë njëri pas tjetrit. Njerëzit kanë kërkuar dhe kanë gjetur një të adhurar për veten e tyre. Meqë ti nuk i pranoke asnjërin prej këtyre, do të thotë se nuk je njeri. Ndërsa unë nuk di të flas gjuhën e kafshëve. Për të folur me ty, duhet të jesh kafshë. Andaj, unë nuk kam asgjë për të folur me ty!” Në këtë mënyrë ia kishte treguar vendin. Pra, kjo ishte një formë tjetër e shprehjes se Hazreti Ebu Bekrit. “Unë besoj. Ti po deshe beso, po deshe mos beso! Nëse nuk beson, ti do të humbasësh. Nëse beson, ti do të fitosh. Prandaj mos u mundo për t’i hedhur njerëzit në dyshim!” Njeriu beson. Ai beson sikur sheh me sy. Ai nuk i heton dhe nuk i sheh me dyshim gjërat që beson. Njerëzit e tillë janë myslimanët. Ata besojnë se Allahu ka dërguar peygamberë, se ka dërguar libra dhe se engjëjt që janë rreth nesh i shkruajnë veprat tona. Domethënë, u besojnë shumë gjërave që nuk mund t’i perceptojë mendja jote e ngushtë. Prandaj përse të mos i besojnë miraxhit? Ti e paske humbur besimin tënd. Gjithashtu e paske humbur edhe humanizmin.

Nëse dyshon për miraxhin, do të dyshosh për çdo

gjë. Pastaj thua: “Nuk ka engjëj, nuk ka libër dhe nuk ka shpallje.” Kjo nuk ka fund. Pastaj e mohon edhe Allahun, Zoti na faltë.

Unë kam besuar dhe e kam kuptuar çështjen. E kam hapur syrin e zemrës dhe e kam kuptuar çështjen edhe nëse nuk e sheh dot syri i kokës. Edhe ti do ta kuptosh një ditë, siç thuhet edhe në Kuranin Fisnik: “Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Ani, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!” (Nebe’, 1-5) Por atë ditë të kuptuarit nuk do të ketë dobi: “Dhe, kur të sillt Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç’i duhet se u kujtua!” (Fexhr, 23) Për këtë arsye, së pari duhet të besojmë.

Në çdo moment duhet t’i besojmë ekzistencës e njësimi të Allahut Teala dhe nuk duhet të kemi qoftë edhe dyshimin më të vogël. Si kush? Si nëna jonë Hatixhja. Si Sahabi i nderuar, Ebu Bekr es-Siddiku. Si Sahabi i nderuar, Aliu (r.a.).

Përse kemi ardhur në këtë botë?

Junus përse ke ardhur në këtë botë?

Që gjuha ta përmendë Zotin natë e ditë.

Poeti i njohur, Junus Emre e shpjegon çdo gjë me dy vargje. Allahu i Lartësuar na ka dërguar në këtë botë për t’ju nënshtruar, për ta adhruar dhe për ta përmendur Atë natë e ditë. Allahu na bëftë prej robërve të Tij që e përmendin pa reshtur dhe mos na bëftë prej atyre që e humbin besimin dhe që dyshojnë në çdo gjë!

Që nga fillimi po e shtjellojmë temën duke nxjerrë në pah se edhe në jetën e biznesit duhet t’i besosh synimit që ke. Ti e ke vendosur synimin dhe beson se do t’ia dalësh mbanë me sukses. Nëse ke vepruar kështu, atëherë mos u preokupo me ata që e shohin të palogjikshme këtë dhe që nuk e pranojnë. Disa njerëz çdo gjë e shohin me dyshim. Nëse bota do të kishte ngelur gjithmonë në dorë të këtyre kundërshtuesve, shumë gjëra nuk do të shpikeshin. A do të prodhoheshin avionët e sotshëm sikur të merreshin parasysh fjalët e atyre që thoshin: “A mund të fluturojë një gjë e rëndë me tonelata?” Mendoni

për operacionet. Mendoni për shumë teknika nga mikro deri te makro. Të gjitha këto janë sukseset e atyre njerëzve që besuan se ia dilnin mbanë. Po ashtu janë edhe sukcesi i atyre që u besuan dhe i mbështetën ata.

Të besosh do të thotë që të shikosh para se të shohësh me sy dhe ta integrosh atë në zemër apo në kokë. Kur Fatihu ishte fëmijë, shikonte ëndrrat e çlirimit. Ai e besonte këtë gjë. Atëherë, si t’ua shpjegonte atyre që nuk e besonin? Këtë mund t’ua shpjegonte vetëm duke e çliruar Stambollin. Ai e çliroi Stambollin dhe e nxori në pah suksesin e tij. Edhe njeriu që shpik, e kryen projektin dhe e nxjerr në pah. Këtu sigurisht se duhet ta shtjellojmë në veçanti edhe çështjen e të vepruarit vetës sipas imagjinatës.

Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se Allahu është i plotfuqishëm, ndërsa ne nuk jemi.

Gjërat që njeriu mund t’i imagjinojë pa futur në llogari të vërtetave të tregut, ligjet e fizikës, shpenzimet e prodhimit dhe gjendjen e vendit e të botës, nuk janë plane apo projekte, por imagjinata të pavlera. Sikundër njerëzve që e ekzagjerojnë në dyshime dhe në vesvese, ka prej atyre i besojnë vetes më tepër seç duhet dhe janë tepër optimistë. Domethënë janë robër të imagjinatës dhe aventurës. Nëse njerëzit e tillë i bëjnë edhe të tjerët që t’u besojnë imagjinatave të tyre, në pah dalin falimentime dhe dështime të mëdha. Në lidhje me këta njerëz gjithmonë duhet të pyesim: “Çfarë suksesesh kanë arritur deri më sot? Ai i kanë borxhe kujt? A gënjejnë? Si i kanë llogaritë personale? A mund t’i administrojnë si duhet paratë e tyre? A e njohin vetë punën që duan të bëjnë? Vallë, flasin për para që fitohen shpejt dhe lehtë apo për një fitim të ngadaltë dhe të vazhdueshëm që arrihet me punë serioze?”

Allahu i Lartësuar na bëftë prej atyre që e arrijnë të vërtetën, që i besojnë më të mirës dhe që e arrijnë më të mirën në të dy botët! Gjithashtu na dhëntë partnerë, shokë, ortakë, punëtorë dhe fëmijë që na besojnë në idealet tona të larta dhe të frytshme! Amin!..





DREJT ASAJ QË DUHET TË REALIZONET

— Idris Arpat —

“Dita kur do të kuptosh ndryshimin ndërmjet asaj që mund të realizohet dhe asaj që duhet të realizohet, është një ditë shumë e madhe.”

Kjo deklaratë i përket profesorit tonë të nderuar Sezai Karakoçit.

Përmbajtja e fjalisë na jep një këndvështrim të hapur ndaj zhvillimit. Ajo na bën të synojmë pikën më kulmore të mirësisë, bukurisë dhe përsosjes.

Ajo që po ndodh dhe realizohet është e qartë, por çfarë është ajo që duhet të ndodhë apo që duhet të realizohet? Kush do t’ia caktojë natyrën, gradën dhe përkryerjen asaj? Cilat janë masat për ta bërë këtë?

Në caktimin e asaj që duhet të jetë apo që duhet të realizohet, rol të rëndësishëm do të luanin mendjet e edukuara mjaftueshëm dhe zemrat e gjera që e njohin mirë këtë botë. Nëse nuk e njihni këtë botë dhe nuk keni njerëz të mëdhenj, nuk do të jetë e lehtë ta imagjinoni “atë që duhet të realizohet”. Andaj, kjo do të sjellë pranimin e asaj që realizohet dhe si rezultat, automatikisht do të sjellë ndalimin e zhvillimit. Ta pandehësh gjënë e realizuar si gjënë që duhet të realizohet, është një gabim mjaft i madh.

Si rezultat, hadithi fisnik: “Është mashtruar ai që i ka dy ditë njëlloj.” – e ka hequr kufirin e lartësimit dhe zhvillimit.

Qoftë në plan individual apo qoftë në plan shoqëror, çdo ditë në jetën tonë duhet të jetohet më bukur se dita e kaluar. Veprat tona duhet t’i kalojnë ato të mëparshmet.

A ka kufi kjo përsosje?

Jo, nuk ka. Më e përkryera gjithmonë është e mundur të arrihet. Për këtë arsye, ne duhet të bëjmë studimet, llogaritë dhe hesapet për të realizuar më të mirën. Poezia më e bukur akoma nuk është shkruar dhe ndërtesa më e bukur akoma nuk është ndërtuar.

Për të mos qenë dy ditë njëlloj, deri diku vlen sasia, pastaj vlen cilësia. Kjo do të thotë: T’i shtosh numrat deri në fund është e pamundur, por rritja e cilësisë është e mundur.

Koncepti i ihsanit/mirësisë në Kuranin Fisnik shfaq një mendim të përkryer nga aspekti i asaj që duhet të realizohet. Ky koncept mbart në vete edhe të qenët i vetëdijshëm se në çdo punë që bëjmë jemi nën vëzhgimin e Allahut Teala. Çfarëdo pune që të bëjmë, duhet ta bëjmë me një cilësi që ta pëlqejë Allahu i Madhëruar. Punët dhe veprat tona ia shfaqim një pozite shumë të lartë. Pozitave të larta nuk u jepen vepra të zakonshme, por vepra që arrijnë pikën kulmore.

Në një hadith tjetër fisnik thuhet: “Kur robi bën një punë, Allahu Teala dëshiron që ai ta bëjë atë punë në

formën më të bukur dhe të duhur.” Domethënë, punës duhet t’i jepet haku i saj.

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet se çdo punë duhet të kryhet nga specialistë të klasit të parë dhe me një kujdes dhe përpikëri absolute. Ky është një parim aq shumë i vlefshëm, në mënyrë që punët e umetit të Muhamedit (a.s.), të shkojnë sa më mirë dhe sa më bukur. Sa herë që e lexoj këtë parim, them me vete: “Nuk mund të ketë parim që mund të shprehet më mirë se ky.” Puna duhet t’u jepet atyre që janë specialistë në atë fushë. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ne duhet të synojmë rezultatet më të larta.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Nëse nuk e respektoni këtë, priteni kiametin shoqëror.” “Kur puna të mos u jepet të aftëve, priteni kiametin.”

I Dërguari i Allahut (a.s.), vuri re se fundi i varrit që do të varrosej biri i tij, Ibrahim, i cili ndërroi jetë në moshë të vogël, nuk ishte rrafshuar mirë. Varrmihësi i tha që ta rregullonte. Varrmihësi e pyeti: “A ka ndonjë dëm i vdekuri nga kjo?” I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: “Jo, i vdekuri nuk ka ndonjë dëm, por syrit nuk i duket bukur.”

Të gjithë ata që e vrasin mendjen në lidhje me këtë ngjarje menjëherë do të kuptojnë se i Dërguari i Allahut (a.s.), kërkon që puna të bëhet pa mangësi dhe me estetikë.

Edhe Muhjiddin ibnu’l-Arabiu thotë se myslimanët i kanë nënvlerësuar dy çështje të rëndësishme. E para është lartësimi i njeriut dhe e dyta është estetika. Domethënë, njeriu duhet të zbukurohet me dije, urtësi, moral e mirësjellje. Gjithashtu edhe bota e tij duhet të jetë një botë shumë e bukur.

A është e mundur të mos e mbështesësh këtë të vërtetë?

Mrekullitë në Kuranin Fisnik janë vendosur si një synim për brezat e ardhshëm. Ato duhet të bëhen reale duke u formuar bazën shkencore dhe duke u gjetur ligjet e tyre dhe pastaj të kalohen në jetë. Ky këndvështrim u hap horizonte shumë të gjera myslimanëve. Nëse myslimanët do të synojnë për t’i realizuar mrekullitë shkencërisht, edhe nëse nuk e arrijnë këtë synim, do të kenë përparime të mëdha. Kjo do të thotë se do të rritet niveli i mirëqenies në jetën e kësaj bote.

Në këtë pikë do të dalë në pah vetvetiu rëndësia e konsultimit, e të menduarit bashkërisht mbi një çështje dhe e shprehjes së lirë të mendimeve, sepse atë që nuk e sheh njëri, mund ta shohë tjetri. Edhe atë që nuk e sheh tjetri, mund ta shohë dikush tjetër i tretë. “Arsyeja është mbi arsyen.” Synimi është që t’i heqim mangësitë dhe t’i shtojmë cilësitë. Pra, hatrit të Zotit t’i japim më shumë rëndësi se hatrit të mikut. Në vende që është e pamundur t’i shprehësh lirshëm ato që mendon, mangësitë dhe problemet nuk thuhet, rruga që të çon te përsosmëria nuk shprehet

dhe çdo gjë ngel siç është. Veçanërisht nëse përvetësohen shprehjet e rrezikshme si “mirësia është te ajo që ka dalë në pah / që është realizuar” apo “gjërat e realizuara janë ato që duhet të realizohen”, atëherë, ulu aty ku je, sepse, nëse “gjërat e realizuara janë ato që duhet të realizohen”, a ka kuptim të imagjinosh një botë më të bukur, kushte më të zhvilluara dhe shoqëri me nivel më të lartë?

Veçanërisht në jetën shoqërore dhe çështjet sociale duhet ta kemi parasysh edhe parimin “el-emru bi’l-ma’ruf ve’n-nehju ani’l-munker-in” nga aspekti i temës sonë.

Cila është natyra e këtij parimi të mrekullueshëm në Islam?

Natyra e këtij parimi të mrekullueshëm në Islam është shtimi i mirësisë dhe pakësimi i ligësisë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e shikon këtë si parim të domosdoshëm të Islamit dhe thotë: “Ose do ta zbatoni këtë parim në jetë, ose do të shkatërroheni nën padrejtësinë e të padrejtëve.”

Nëse njeriu ka edhe potencialin e devotshmërisë, edhe potencialin e ligësisë, nëse në botën e jashtme gjenden engjëjt dhe shejtanët, atëherë edhe mirësia dhe ligësia do vazhdojnë të ekzistojnë deri në fundin e kësaj bote. Nëse e vërteta është kjo, feja e qartë, Islami na thotë: “Përpikuni për t’i shtuar mirësitë dhe për t’i pakësuar ligësitë! Nëse për këto punë duhen organizata, mos e nënvlerësoni formimin e organizatave. Nëse duhen para, mos i neglizhoni paratë. Nëse duhet fuqi, mos e lini pas dore fuqinë. Nëse duhet shtet, mos e nënvlerësoni formimin e shtetit.” Përveç të tjerash, asnjëherë të mos harrojmë se qëllimet miqësore, dija, edukata dhe metodologjia janë shumë të rëndësishme në qortime, kritika dhe propozime.

Gjithmonë duhet ta kemi në mendje se shahadet ka një “la ilahe”. Kjo do të thotë refuzim i të devijuarës, i ligësisë dhe i gabimeve. Gjithashtu ka edhe “il-lallah-un”. Kjo përputhet me pranimin e Zotit (xh. xh.), e mirësisë dhe të të vërtetave. Andaj, gjithmonë do të ketë përpjekje për ta zhdukur të keqen në një lloj mënyre dhe për ta zhvilluar të mirën. E vërteta dhe e pavërteta asnjëherë nuk do të lejohen që të mbliidhen bashkë. Një përzjerje e tillë është totalisht e papranueshme.

Nënvlerësimi i kësaj ndjeshmërie në çështjet sociale, ekonomike dhe politike, apo në të gjitha fushat e jetës, sjell probleme të pariparueshme. Myslimani duhet ta pranojë të vërtetën si të vërtetë dhe të pavërtetën si të pavërtetë brenda rregullave të përcaktuara. “Ata që nuk mund të thonë ‘jo’ kur të jetë e nevojshme, nuk u është zhvilluar plotësisht personaliteti.”

Njerëzimi është falënderues ndaj fëmijët të mëdhenj që përvëlohen me mallëngjimin për një botë më të ndershme e më të bukur dhe që luftojnë për këtë.



TEVEKKULI *i Ibrahimit (a.s.)*

— Sezai Engin —

Fjala “tevekkul”, e cila do të thotë besim dhe mbështetje, në literaturën islame përdoret në kuptimet si: “T’i besosh Allahut, ta pranosh atë që vjen nga Allahu dhe t’i dorëzohesh Allahut.”

Sigurisht se është e mundur t’i cilësojmë të gjithë pejgamberët e Allahut Teala me cilësinë “mutevekkil” e cila do të thotë: mbështetës te Allahu Teala dhe të nënshtuar ndaj Tij. Kur pejgamberët e kanë kryer detyrën e thirrjes hyjnore, e mbartnin këtë cilësi në karakteret e tyre dhe në rrugën e thirrjes hyjnore kanë vepruar brenda kornizës së kësaj cilësie.

Ibrahimi, (a.s.), ka një vend të veçantë në lidhje me thirrjet që shprehja “tevekkul” i shkakton në mendje. Vendi i tij i veçantë shprehet kështu në Kuranin Fisnik: “Vërtet, Ibrahimi ishte i butë, i

dhembshur e vazhdimisht i kthyer (tek Allahu).” (Hud, 75)

Pa dyshim se pejgamberët janë zgjedhur ndërmjet njerëzve, në mënyrë që të përbëjnë shembull për ta. Mendimi se ata nuk mbartin cilësi njerëzore është i papranueshëm. Cilësitë njerëzore kanë arritur pikën më të lartë duke u konkretizuar te ata. Ja pra, “tevekkuli”, i cili është më i virtytshmi prej cilësive njerëzore, pothuajse nxori filizat në personalitetin e Ibrahimit (a.s.) dhe u integrua te ai. Ky integrim tregohet kështu në një ajet tjetër: “Me të vërtetë, Ibrahimi ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve.” (Nahl, 120)

Mirë, por cili ishte shkakun që Kurani Fisnik u

shpreh në këtë mënyrë për Ibrahimin (a.s.)? Si i arriti Ibrahim (a.s.), këto lavdërime?

Ai u sprovua me fëmijën e vet, i cili ishte drita e syve dhe një pjesë prej tij. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë! Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: “O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?” – I biri i tha: “O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!” Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahim) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.” Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuar atë (Ismailin) me një kurban të madh dhe i lamë atij (Ibrahim) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. “Paqja qoftë mbi Ibrahimin!” Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët.” (Saffat, 101-110)

Dhimbjen e fatkeqësisë për vdekjen e dikujt, të cilin e do nga thellësitë e zemrës dhe me ekzistencën e të cilit gjen prehje, e shohim në jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), kur i vdiq xhaxhai dhe bashkëshortja e tij, të cilët i donte shumë.

Ndërkohë që edhe i Dërguari i Allahut i rezistoi me vështirësi kësaj dhimbjeje, Ibrahim (a.s.), pa në ëndërr se do ta therte me duart e veta birin e tij. Ai e kuptoi se këtë duhej ta bënte patjetër, andaj ia hapi çështjen edhe të birit dhe mori aprovimin e tij. Tashmë që të dy kishin vendosur për ta kryer këtë punë. Në këtë situatë, gjendja shpirtërore e Ibrahimit (a.s.), si një baba, është një gjendje që nuk mund të kuptohet pa e përjetuar dhe pa e ndjerë.

Ja pra, ndjenja e “tevekkulit” të pakufishëm ndaj Allahut Teala ishte ajo që ia dha guximin për të vendosur që ta kryente këtë detyrë të vështirë.

Dijetari i nderuar mysliman, Muhamed Ezedi, e shtjellon kështu këtë temë: “Kuptimi etikoshpirtëror i ëndrrës së Ibrahimit (a.s.), ishte në provën që do ta vërtetonte nëse ishte i gatshëm apo jo për ta flijuar për hir të Allahut Teala gjënë më të shtrenjtë në jetën e tij nisur nga shenja

që pa si kërkesë e Allahut.” (Mesazhi i Kuranit, Botimet Isharet, fq. 917.)

Folja “eslema” që përmendet në ajetin fisnik është një folje e dalë nga fjala mysliman. “Eslema” do të thotë: “Ata të dy iu nënshtruan (Zotit).” Përdorimi i kësaj foljeje në etapën e parë të realizimit të kësaj sprove të vështirë nga babai dhe i biri, pothuajse është një apel për myslimanët:

Nëse thoni: “Jemi myslimanë” dhe “i jemi nënshtruar Allahut”, nëse merrni përsipër identitetin e myslimanit, edhe ju duhet ta mbartni në zemrat tuaja tevekkulin e Ibrahimit (a.s.). Kur të jetë e nevojshme duhet ta flijoni për hir të Allahut të Madhëruar gjënë më të shtrenjtë që keni në jetën e kësaj bote. Nëse arrini ta bëni këtë, “selami / paqja”, për të cilën Zoti (xh.xh.), thotë qoftë mbi Ibrahimin (a.s.), do të jetë edhe mbi ju dhe do të shpërbleheni siç u shpërblen Ibrahim (a.s.) dhe siç shpërblehen të devotshmit. Në sajë të kësaj, do të bëheni prej “robërve që besojnë me të vërtetë”.

Sigurisht se Allahu i Lartësuar nuk ka kërkuar nga besimtarët që të therin bijtë e tyre apo të shkatërrojnë pasurinë e tyre. Ajo që kërkon Allahu Teala nga besimtarët nuk është pika kulmore e “tevekkulit të Ibrahimit (a.s.)”, sepse Allahu (xh.sh.), askënd nuk e ngarkon me një barrë që s’mund ta përballojë.”

Ajo që kërkon Allahu i Lartësuar nga robërit e tij është që, duke flijuar një pjesë prej pasurisë së tyre, t’i ndejnë qoftë edhe pak ndjenjat e Ibrahimit (a.s.) dhe Ismailit (a.s.), që patën përgjatë sprovës, të cilën e kaluan me sukses, në çështjen e bindjes ndaj Allahut të Madhëruar. Gjithashtu, Allahu Teala kërkon nga robërit e Tij që të kontribuojnë në ndihmën e ndërsjellë dhe solidaritetin shoqëror kur ta përkujtojnë këtë shembull nënshtrimi edhe pse me një sjellje simbolike.

Ndërsa theksimi që i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka bërë rëndësisë së kësaj ndjesie dhe kontributi, shpjegon qartë se sa të ndjeshëm duhet të jenë besimtarët në këtë çështje: “Ai që nuk ther kurban edhe pse ka mundësi, mos t’i afrohet faltores sonë.” (Ibn Maxhe, Edahi, 2; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 321.)

Nëse thoni: “Jemi myslimanë” dhe “i jemi nënshtruar Allahut”, nëse merrni përsipër identitetin e myslimanit, edhe ju duhet ta mbartni në zemrat tuaja tevekkulin e Ibrahimit (a.s.).

FLLADI HYJNOR

Mëshira

— Dr. Mustafa Xhanllë —

Një hadith: “Mëshiruesit!.. Ja, i Mëshirshmi do t’i mëshirojë ata. Andaj, mëshironi ata që janë në tokë, në mënyrë që t’ju mëshirojnë edhe ata që janë në qiell.” (Ebu Davud, Edeb, 58)

Një mesazh: Mëshiro, në mënyrë që të mëshirohesh.

“Mëshira është perdja e fatkeqësive.” Umeri, (r.a.)

Në një hadith fisnik, të cilin e transmeton Ebu Hurejre, (r.a.), Profeti, (a.s.), ka thënë:

“Allahu e ka ndarë mëshirën në njëqind pjesë. Nëntëdhjetë e nëntë pjesë të saj i ka mbajtur pranë, ndërsa një pjesë të saj e ka zbritur në tokë. Ja, në sajë të kësaj pjese (mëshire), të gjitha krijesat sillen

me mëshirë ndaj njëra-tjetrës. Madje edhe pela, e ngre këmbën e saj (për shkak të kësaj mëshire) me frikën që të mos e shkelë dhe të mos e dëmtojë (të voglin e saj kur i jep për të pirë qumësht).” (Buhari, Edeb, 19.)

Allahu, (xh.sh.), është më i Mëshirshmi i mëshiruesve. Ai është Rrahman, është Rrahim... Ai është burimi i mëshirës. Çdo mëshirë e shfaqur nga të gjitha krijesat në tokë dhe në qiell është vepër e Tij...

Mëshira është shfaqje e attributeve Rrahman/i Mëshirshmi dhe Rrahim/Mëshiruesi të Allahut të Lartësuar...

Kur çdo punë të mirë e fillojmë duke thënë “Bismil-lahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim”, ne kërkojmë mëshirën e Allahut Teala që në fillim të punës, duke i përmendur emrat e Tij Rrahman dhe Rrahim. Po të mos jetë mëshira e Tij, nuk mund të arrijmë asnjë mirësi qoftë në këtë botë apo qoftë në botën tjetër.

Të menduarit e këtyllë, në të njëjtën kohë është një reflektim tjetër i vetëdijes së nënshtrimin ndaj Zotit (xh.xh.).

MËSHIRA ËSHTË VULA QË ALLAHU I MADHËRUAR I KA VËNË TOKËS.

Mëshira është një fllad i bekuar që vjen nga Zoti (xh.sh.) dhe që ia qetëson njeriut botën e brendshme të tij...

Nëse një nënë ndjen mëshirë ndaj të voglit të saj, mund ta bëjë këtë vetëm në sajë të ndjenjës së mëshirës që Allahu Teala ia ka vendosur asaj në zemër. Një njeri që i jep ujë një qeni të etur, mund ta bëjë këtë me ndjenjën e mëshirës që Allahu i Lartësuar ia ka dhuruar atij. Në sajë të mëshirës që Ai ka vendosur në zemrat tona mund t'i puthim dhe t'i lehdatojmë fëmijët dhe nipat tanë. Nisur nga ky aspekt, mëshira është një mirësi e madhe që Allahu i Lartësuar na e ka dhuruar neve. Përveç të tjerash, edhe njeriu vetë është vepër e mëshirës së Krijuesit, sepse Rrahmani na ka mëshiruar ne. Ai na ka krijuar si njerëz, të cilët jemi krijesat më të nderuara. Nëse tani marrim dhe japim frymë në tokë si një gjallesë inteligjente dhe jo si një kërmill, gur apo pemë, kjo është në sajë të mëshirës së Tij.

EDHE LOTËT JANË PREJ MËSHIRËS...

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), e mori në krahë me dhembshuri dhe mëshirë nipin e tij që po jepte shpirt. Sytë filluan t'i rridhnin lot. Ata që gjendeshin pranë tij u bënë shumë kureshtarë dhe e pyetën:

“Çfarë janë këta lot, o i Dërguari i Allahut?” Nisur nga kjo pyetje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte i dërguar si mëshirë për botët, u tha:

“Këta lot janë një mëshirë që Allahu e ka vendosur në zemrat e robërve që dëshiron. Allahu mëshiron prej robërve të Tij vetëm ata që janë të mëshirshëm.” (Buhari, Merda, 9.)

ISLAMI ËSHTË FEJA E MËSHIRËS...

Për këtë arsye, besimtari, duke u nisur me rregullin: “Tolerroje krijesën për hir të Krijuesit.” – shfaq dhembshuri dhe mëshirë kundrejt të gjitha krijesave që i ka krijuar Allahu i Madhëruar. Një besimtar që i beson Allahut Teala nuk e torturon dhe nuk

ia pret fytyrën njeriut, i cili, siç e shprehëm edhe më lart, është krijesa më e nderuar. Kushdo që e bën këtë, qoftë individualisht apo qoftë në grup, nuk ka asnjë lidhje me Islamin, edhe nëse mund të ketë shpallur kalifatit Islam, sepse, me këto veprime po bëhet një vepër prej së cilës nuk janë të kënaqur Allahu dhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Këtë duhet ta dimë mirë të gjithë se mysliman është ai njeri prej të cilit janë të sigurt njerëzit e tjetër dhe për të cilin thonë: “Neve nuk na vjen dëm nga ai.”

Nisur nga ky aspekt, në Islam, nuk ka dhunë, torturë dhe barbarizëm. Madje edhe lufta e Islamit është e mbushur plot me mëshirë, sepse në luftë, sipas Islamit, nuk vriten fëmijët, gratë dhe klerikët. Kur ushtria të jetë ballë për ballë me ushtrinë armike dhe të zhvillohet lufta, prapë se prapë janë të ndaluara barbarizmat, si vrasjet për qejf apo prerja e gjymtyrëve. Në vend të këtyre, në fenë tonë sublime, në Islam, ka gjallërim, zhvillim dhe ndërtim. Nëse u hedhim një sy çlirimeve të bëra nga Islami, vëmë re se vendet janë çliruar jo duke i varur, prerë, shkatërruar, dhunuar dhe torturuar njerëzit, por duke fituar zemrat e tyre. Këtë mund ta shikojmë edhe në luftërat që janë bërë në kohën e Resulullahut, sallallahu alejhi ve sellem. Sipas një studimi, përgjatë gjithë kohës dhjetëvjeçare të xhihadit që ka bërë i Dërguari i Allahut (a.s.), ndërkohë që tokat islame u zgjeruan deri në dy milion kilometra katrorë, humbën jetën 250 veta nga radhët e armiqve dhe 150 luftëtarë nga radhët e myslimanëve.

Por për fat të keq, kohët e fundit po bëhen përpjekje serioze që Islami, që është feja e mëshirës, të lançohet si feja e terrorit dhe e dhunës me ndihmën e sjelljeve të privuara nga mëshira e disa myslimanëve injorantë dhe të paditur. Në këtë mënyrë, duan që të gjithë njerëzit e botës të drejtohen nga një perceptim i gabuar. Përballë këtyre orientimeve të gabuara mund të qëndrojmë vetëm me shembujt e mëshirës.

MËSHIRA GJALLËRON, JEP JETË DHE JEP SHPIRT...

Siç e gjallëron dhe i jep jetë uji tokës së thatë, edhe mëshira i qetëson, i preh dhe u jep jetë zemrave.

Edhe vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte peygamber i mëshirës. Allahu i Lartësuar e deklaroi kështu këtë të vërtetë:

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107) Ai është mëshirë për botën e njerëzve, për botën e kafshëve, për botën e xhindëve, për malet dhe për gurët. Siç shprehet edhe vetë në një fjalë të tij:

“Unë jam Muhamedi. Unë jam Ahmedi. Unë jam pejgamberi i mëshirës...” (Ahmed bin Hanbel, V, 405.) Një herë sahabët nuk rezistuan dot ndaj torturave të mëdha të politeistëve. Andaj i bënë këtë kërkesë të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Mallkojini politeistët!” Ndërsa ai u dha përgjigje me këto fjalë që mbartnin mëshirë:

“Unë nuk jam dërguar si mallkues, por si mëshirë.” (Muslim, Birr, 87.)

Ndoshta cilësia më e qartë e tij ishte mëshira. Kjo mëshirë e tij është shfaqur më së shumti mbi umeitin. Në një ajet fisnik, Allahu i Lartësuar e cilëson atë si një pejgamber të dhënë pas besimtarëve, të dhimbshëm dhe të mëshirshëm ndaj atyre dhe si një profet që i vinte rëndë kur besimtarët gjendeshin në vështirësi. (Shik. Ahzab, 6)

I gjithë universi ka nevojë për mëshirë...

Njeriu, i cili është më i nderuari prej të gjitha krijesave, ka nevojë për mëshirë. Njeriu i botës së sotme, i cili është i privuar nga mëshira, ka nevojë të madhe për mëshirë... Pothuajse në çdo vend që hedhim hapim përballemi me ngjarje barbare. Po, barbarizma në shtëpi, barbarizma në punë, barbarizma në televizor, barbarizma nëpër gazeta... Mbi të gjitha, ekzistenca e këtyre barbarizmave në shoqëritë myslimane janë një gjendje me të vërtetë pikëlluese.

Sot vëmë re se një fëmijë mysliman e ther dhe e copëton barbarisht nënën e tij. Një nënë e privuar nga mëshira, mund ta hedhë në mbeturina apo në banjë të voglin e saj të sapolindur pa e vrarë ndër-gjegjja aspak. Ndërsa ndër situatat më të tmerrshme mund të përmendim edhe këtë: Një barbar që pohon se është mysliman, ia pret kokën me thikë një njeriu tjetër mizorisht dhe duke përmendur emrin e Allahut. Pastaj pandeh se po predikon Islamin duke ia treguar të gjithë botës kokën e prerë të atij njeriu. I shkreti... Ky nuk është Islami, të cilin ai pandeh se po e zbaton... Kjo që bën ai nuk është gjë tjetër përveçse mizori apo satanizëm, pra, rrugë e shejtanit të mallkuar. Ç’është kjo mizori kështu, o Zot! Ç’është kjo papërgjegjshmëri! Ç’është kjo fatkeqësi!

Në një hadith fisnik thuhet:



“Vetëm fatkeqi është i privuar nga mëshira.” (Tirmidhi, birr, 16.) Sa gjendje e keqe është privimi nga mëshira... Andaj, nëse nuk mëshiron, nuk do të mëshirohesh. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte i dërguar si mëshirë për botët, thotë:

“Allahu nuk e mëshiron atë që nuk i mëshiron njerëzit.” (Buhari, Tevhid, 2.)

Për këtë arsye, atë që është i mëshirshëm e mëshiron edhe Allahu Teala...

Nëse dëshiron që mëshira e Allahut të jetë mbi ty, duhet t’i mëshirosh krijesat. Nëse mëshiron, edhe engjëjt të mëshirojnë dhe të mbulojnë me flatrat e tyre... Në hadithin fisnik që e kemi përmendur në krye të tekstit, i Dërguari i Allahut, (a.s), thotë:

“...Mëshironi ata që janë mbi tokë, në mënyrë që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell.” Domethënë, duhet të mëshirosh njerëzit, kafshët, gurët, pemët, shkurtimisht, çdo gjë që ekziston, në mënyrë që edhe ty të të mëshirojnë Allahu dhe engjëjt e Tij.

EDHE KAFSHËT KANË NEVOJË PËR MËSHIRË...

Kafshët, për të cilat është harruar se mbartin shpirt, në përgjithësi torturohen, keqtrajtohen dhe dhunohen. Allahu, xhelle xhelaluhu, i ka dhënë kafshët në shërbim të njeriut. Nisur nga ky aspekt, njeriu duhet t’i trajtojë me mëshirë kafshët, por ja që në botën mizore të sotme, kafshët, të cilat janë



krijesat e dashura të Allahut, gjenden ballë për ballë me barbarizmat e tmerrshme duke filluar nga të ndeshurit e tyre me njëra-tjetrën deri në ngordhje e deri te rrjepja e lëkurës së tyre në gjendje të gjallë, në mënyrë që të përfitohet sa më shumë para.

Ato shikime nuk më largohen dot nga sytë!

Ata, nën shoqërinë e muzikës dhe argëtimit, po ia rrjepnin lëkurën të gjallë një foke. Në gojë kishin cigare. Në njërën anë pinin alkool, ndërsa në anën tjetër qeshnin me të madhe. Foka akoma ishte e gjallë. Më së fundi, ia rrjepën edhe lëkurën e kokës dhe e hodhën fokën në një vend diku përpara. Foka, me një shpresë të fundit, pa majtas e djathtas me ato sytë e bukur që kishte. Ndoshta po priste ndonjë dorë të mëshirshme. Pastaj dha shpirt. Në të vërtetë, ky ishte momenti kur dha shpirt njerëzimi. Kjo vepër barbare ishte shenjë treguese e mosbesimit dhe e rezultatit të tiranisë që lind për shkak të tij. Po, nëse në një zemër nuk ka besim, prej saj mund të pritet çdo lloj barbarizmi. Poeti i ndjerë thotë:

“Besimi është xhevahir, o Zot sa i madh që është!

Zemra pa besim, e cila është e ndryshkur, është thjesht një barrë!

Nëse ka besim, ka edhe mëshirë...

Nisur nga ajo që thamë më lart, ndërmjet mëshirës dhe besimit ka një lidhje të fortë. Një njeri

që i beson Allahut Teala, është edhe i mëshirshëm. Besimi e bën të domosdoshme mëshirën. Barbarizmi dhe besimi nuk mund të qëndrojnë bashkë. Për këtë arsye, një besimtar që pohon se i beson Allahut, duhet të flasë me mëshirë dhe të sillet me mëshirë. Nëse sillet në mënyrë barbare, duhet ta kuptojë se besimi që ka ndaj Allahut nuk është ndonjë gjë më tepër se sa një pohim i pavlerë.

KURBAN DO TË THOTË MËSHIRË...

Ne duhet të shfaqim mëshirë edhe kur t'i therim kafshët që Allahu Teala i ka nënshtuar në shërbim ndaj nesh për të na nderuar ne.

Sipas transmetimit të ardhur nga Ibn Abbasi, (r.a.), në një ditë kurhani, i Dërguari i Allahut, (a.s.), po kalonte pranë një burri, i cili e kishte vendosur këmbën në barkun e deles dhe po mprehte thikën. Sapo Pejgamberi i mëshirës, (a.s.), e pa në atë gjendje, menjëherë i tha:

“A nuk do të ishte më mirë sikur ta kishe mprehur thikën më parë? Apo dëshiron ta therësh dy herë këtë kafshë?” (Hejthemi, Mexhmau’z-Zevaid, IV, 33.)

Gjithashtu, edhe njëri prej haditheve të tij që mban erë mëshire është:

“Allahu ka caktuar që ta trajtoni mirë çdo gjë. Për këtë arsye, vrisni me mirësi kur të vrisni! Therni me mirësi kur të therni! Kur ndonjëri prej jush të vendosë për të therë ndonjë kafshë, le ta mprehë thikën, ta therë me mirësi dhe ta rehatojë kafshën që ka therur!” (Ahmed ibn Hanbel, 4/123.)

Njerëzit, kafshët dhe natyra kanë nevojë për mëshirë. Ata duan të ndjejnë një shikim dhe një prekje të mëshirshme...

Së fundi, i gjithë universi ka nevojë për mëshirë. Për këtë arsye, ndjenjat e mëshirës duhet t'i gjallërojmë dhe t'i aktivizojmë përsëri. Ndërsa kjo e bën të domosdoshme njohjen e besimit tonë, i cili është burimi i mëshirës. Nëse dëshirojmë që në zemrën tonë të fryjnë flladet e mëshirës, duhet ta shtojmë dashurinë dhe komunikimin me besimin që kemi ndaj Allahut të Lartësuar, i Cili është më i mëshirshmi i mëshiruesve dhe burimi i mëshirës.

Allahu i Madhëruar na trajtoftë jo me zemërimin, por me mëshirën e Tij! Ne i kërkojmë mbrojtje Atij nga zemërimi i Tij. Në zemrat tona na vendostë ndjenjën e mëshirës! Të gjithëve na dhëntë shikime, të folur dhe sjellje të mëshirshme! U dhëntë mëshirë edhe zemrave që janë të privuara nga mëshira!

Amin!..



Të mëshirshëm kundrejt myslimanëve dhe të ashpër kundër armiqve të fesë

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu Teala në Kuranin Fisnik na i ka parashtruar qartë rregullat e jetës individuale dhe të asaj shoqërore. Libri ynë i Shenjtë (Kurani) i përkufizon myslimanët si shumë të mëshirshëm kundrejt ithtarëve të së njëjtës fe dhe si të ashpër kundrejt armiqve të fesë: “Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre.” (Fet’h, 29) Por për fat të keq, në ditët e sotme janë përhapur në çdo vend sjellje në kundërshtim të plotë me dispozitat e Kuranit që u përmendën. Disa grupe radikale i shpallin myslimanët qafirë për shkak të gabimeve më të vogla, ndërsa disa të tjera nuk shfaqin tolerancë kundrejt myslimanëve as një për qind të tolerancës që shfaqin ndaj jomyslimanëve. Madje, i braktisin myslimanët dhe formojnë miqësi me jomyslimanët.

Veçanërisht disa grupe mistike nuk shohin ndonjë pengesë për t’i shkelur kufijtë e fesë islame në emër të dashurisë dhe tolerancës. Imam Rabbani

është shembull për të gjithë me qëndrimin e tij për sa i përket kësaj teme, siç është edhe në çështje të tjera. Sipas tij, një besimtar nuk mund të braktiset sado që të bëjë gabime, por duhet të bëhet lutje për të dhe të ndihmohet. Imami thotë kështu në komentimin e ajetit të sures Fet’h që e dhamë më sipër: “Allahu, subhanehu ve Teala, në këtë ajet ka lavdëruar sahabët e të Nderuarit të Njerëzimit (a.s.), për shkak të mëshirës dhe dashurisë së pafundme që kishin për njëri-tjetrit, sepse fjala “Ruhama” e cila është shumësi i fjalës “rahim”, shpreh vazhdimësinë në mëshirë. Dashuria që ata kishin ndërmjet tyre dhe mëshira që shfaqnin ndaj njëri-tjetrit ishin të pranishme edhe kur ishte gjallë edhe pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (a.s.). Çdo lloj sjellje e pahijshme që binte në kundërshtim me këtë mëshirë dhe dashuri që ata kishin ndaj njëri-tjetrit, u largua nga ata një herë e përgjithmonë. Veprat e ulëta si urrejtja, smira, zilia dhe armiqësia u zhdukën përgjithmonë nga ata njerëz të mëdhenj. (Mektubat, II, Letra e 24-t) Sipas Imamit, kushti më i rëndësi-

shëm i profecisë është mëshira. Kjo gjendje është një kusht jetik edhe për ata që i besojnë dhe e pasojnë të Dërguarin e Allahut (a.s.): “Si mund të imagjinohet shfaqja e cilësive të shëmtuara si smira, urrejtja, zemërimi dhe armiçësia, të cilat bien ndesh me dhembshurinë dhe mëshirën, nga një shoqëri e nderuar me edukimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ndërkohë që njëra prej kushteve të profecisë është dhembshuria dhe mëshira e pakufizuar ndaj njerëzve? Kjo tirani, urrejtje dhe zemërim, të cilat sipas Imamit nuk i kanë pasur shokët e të Dërguarit të Allahut dhe as umeti që ka pasuar gjurmët e Pejgamberit, në ditët e sotme për fat të keq gjenden në të gjitha vendet islame. Disa injorantë derdhin gjakun e myslimanëve në emër të Islamit, dikush tjetër i mallkon në çdo lloj mënyre myslimanët e pastër dhe nuk shohin asnjë të keqe në bashkëpunimin me armiqtë e fesë dhe të huajt. Sipas Islamit, jo vetëm myslimanët, por edhe jomyslimanët nuk mund të mallkohen, sepse kjo është një sjellje që nuk i ka hije myslimanit dhe feja jonë nuk e pranon si ibadet mallkimin dhe ofendimin. Po të ishte ibadet ofendimi dhe sharja e dikujt, do të ishte ibadet ofendimi i Ebu Lehebit dhe Ebu Xhehlit, të cilët janë të mallkuar dhe të refuzuar nga Kurani Fisnik. Në këtë mënyrë, do të fitoheshin shumë sevape. Por a ka mirësi në sharje që përmbajnë fjalë të pamoralshme dhe armiçësi?! Përveç të tjerash, ofendimi është shumë i shëmtuar nëse bëhet kundrejt dikujt që nuk e meriton! Ndërkohë që mallkimi i myslimanit dhe armiçësia ndaj tij janë mëkate të mëdha, patjetër se ta nxjerrësh atë jashtë fesë apo ta shfaqësh sikur është i atillë, padyshim se është një situatë e rëndë dhe fatale. Myslimanët e sinqertë veprojnë me kujdes të veçantë në këtë çështje dhe nuk japin gjykim duke u bazuar në dyshim.

Grupet që bëjnë bidate, duke u nisur nga fakti se janë besimtarë që i drejtohen të njëjtës kible, nuk mund të cilësohen si qafirë përderisa nuk i mohojnë dispozitat, të cilat janë vërtetuar se janë nga feja, dhe bazat e fesë që janë të domosdoshme për t'u besuar. Nisur nga kjo, dijetarët kanë thënë: “Nëse në një çështje ka nëntëdhjetë e nëntë shkaqe që të

bëjnë të gjykosh për kufër / mohim të fesë dhe në anën tjetër të kësaj çështjeje ka vetëm një shkak pozitiv që bie ndesh me kufrin, ky shkak i vetëm duhet të vlerësohet dhe ajo çështje nuk duhet të gjykohet me kufër.” Allahu Teala është ai që e di më të drejtën dhe fjala e Tij është më e vërteta. (II, Letra e 38-të)

Krahas kësaj, Imam Rabbani sugjeron me gjithë zemër që të sillemi ashpër dhe të mos i kemi lakmi armiqtë e fesë dhe ata që kurdisin kurthe ndaj Islamit. Imami nuk e sheh si të pranueshme që t'i thyhet zemra një njeriu pa të drejtë, qoftë ai edhe jobesimtar. Ndërsa të jetuarit e myslimanëve si jobesimtarët dhe festimi i festave të atyre nga

myslimanët për të përfutur prej tyre, e sheh si një vepër mjaft të shëmtuar. Për fat të keq, në ditët e sotme ka shumë prej myslimanëve që i shohin me simpati traditat e jomyslimanëve, madje, edhe besimet e tyre. Ata nuk shqetësohen aspak kur i bëhet shirk Allahut Teala. Ndërkohë As'habu'l-Kehfi patën ikur nga politeistët, në mënyrë që të ruanin fenë e tyre. Sipas Imamit, shkakun që ata fituan këtë pozitë të lartë është qëndrimi larg njerëzve të kufrit dhe shfaqja e një kujdesi të veçantë për të mos u ngjarë atyre: “As'habu'l-Kehfi e arritën këtë gradë të lartë shpirtërore dhe këto sevape, nga që u larguan nga armiqtë e Allahut Teala në sajë të dritës së besimit.”

(Mektubat, I, Letra e 44-t) Sa shumë që kemi nevojë për këto parime të arta të Imam Rabbanit në këto ditët e sotme, kur bota islame po përjeton pothuajse një kaos. Andaj, le t'ia vëmë veshin këtij apeli që na bën Imami në çështjen për ta dashur dhe respektuar njëri-tjetrin dhe në çështjen e bashkimit të umetit. Tani le ta përfundojmë letrën tonë duke i thënë “amin” kësaj poezie të Erogllu Nuri:

“O Zot! Vetëm për Ty kam nevojë.

Andaj, më duaj, më bëj të dashur dhe bëji të tjerët të më duan!

O Zot! Ma prano lutjen time!

Andaj, më duaj, më bëj të dashur dhe bëji të tjerët të më duan!

“Si mund të imagjinohet shfaqja e cilësive të shëmtuara si smira, urrejtja, zemërimi dhe armiçësia, të cilat bien ndesh me dhembshurinë dhe mëshirën, nga një shoqëri e nderuar me edukimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ndërkohë që njëra prej kushteve të profecisë është dhembshuria dhe mëshira e pakufizuar ndaj njerëzve?”

ME ZEMËR TE PASTËR DHE FAQE TË BARDHE

Selma Çevikollu

Siç janë të nevojshëm uji, ajri dhe ushqimi për të jetuar edhe besimi është ushqimi shpirtëror themelor më i nevojshëm për jetën. Besimi është burimi i lumturisë dhe qetësisë shpirtërore për njeriun. Po në të njëjtën kohë, besimi është e vetmja rrugë që u vë rregull sjelljeve të pakontrolluara dhe të çrregullta, që i vendos në ekuilibër ato sjellje me një përputhshmëri dhe harmoni të madhe dhe që ka një plan e synim të shenjtë. Besimi është alternativa e vetme prej së cilës njeriu nuk mund të heqë dorë. Ai është fitimi më i madh për njeriun.

Besimi është pikërisht si një lule. Ai nuk e mban brenda aromën e mrekullueshme të tij, por e shpërndan rreth e rrotull. Edhe sjelljet e mira të njeriut janë një lloj shenje e reflektimit të besimit, pra, e shpërndarjes rreth e rrotull e asaj erës së mrekullueshme. Zemrat që mbartin besim përhapin qetësi shpirtërore dhe lumturi në mjedisin ku jetojnë. Prania e atyre i qetëson zemrat e njerëzve të tjerë.

Besimi nuk përbëhet nga qëllime të mira që nuk shndërrohen në aksion. Në besim ka reflektime madhështore nga Allahu, azza ve xhelle. Ato janë veprat e mira dhe sjelljet e drejta që e shpjen robin drejt përsosmërisë. Besimi nuk bën pa vepra. Një besim i thatë, i cili nuk mbështetet dhe nuk ushqehet me vepra të mira, vjen një ditë dhe shuhet. Në besim ka një aksion pozitiv. Rezultatet e arritura jo nëpërmjet besimit, nuk janë nga Allahu, por janë nga shejtani dhe djalli i mallkuar.

Njeriu nuk është një krijesë e krijuar pa ndonjë qëllim. Ai ka një Krijues. Ai është Allahu Teala. Poseduesi absolut i gjithësisë, Allahu i Madhëruar, i ka dhënë njeriut mendje dhe vetëdije duke e stolisur me pajisjet më të mrekullueshme. Pastaj e ka obliguar që t'i besojë Atij. Njeriu, i cili ka ardhur në këtë botë duke mbledhur stolitë (pajisjet) më të bukura, sprovohet në forma të ndryshme përgjatë

jetës së tij në këtë dynja. Në Kuranin Fisnik thuhet kështu në lidhje me këtë të vërtetë:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.” (Ankebut, 2-3) Njeriu nuk është sjellë pa ndonjë synim në këtë botë. Përkundrazi, ai është dërguar në dynja me një synim hyjnor dhe qëllim sublim. Gjithashtu, njeriu nuk është lënë pa përgjegjshmëri. Allahu Teala thotë në Kuran:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)

Çdo njeri, brenda rrjedhave të kohës në këtë botë që e quajmë jetë, është i detyruar ta konceptojë lidhjen ndërmjet besimit dhe sprovës në ngjarjet që i ndodhin. Nëse kjo nuk kalohet me sukses, atëherë, humbja është e pashmangshme. Njeriu, si një krijesë e ndryshme nga të gjitha të tjerat, është krijuar me një synim. Krijuesi i Lartësuar thotë:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115) Kur Allahu i Madhëruar ia ka treguar njeriut këtë të vërtetë të shenjtë, ka njoftuar se njeriu nuk është krijuar pa ndonjë qëllim, se në fund do të kthehet te Zoti (xh.sh.) dhe do të japë llogari për ato që ka vepruar. Ndërsa qëllimin e vërtetë të krijimit të njeriut e shpjegon me këtë ajet fisnik:

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Dharijat, 56)

Atëherë, e vërteta e qartë është kjo se njeriu, i cili është krijuar me qëllimin për të adhuruar Krijuesin e Lartësuar, nuk ka kapital tjetër përveçse jetës së tij. Ndërsa jeta është një proces që mbaron shpejt aq sa hap e mbyll sytë. Çdo gjallesë do të qëndrojë në këtë

botë provizore aq kohë sa i është caktuar. Atij që i vjen koha, që një ditë do t'i vijë patjetër, sigurisht se do të shpërngulet nga kjo botë. Për këtë nuk ka asnjë zgjidhje. Jeta e kësaj bote është e limituar dhe e kufizuar. Ndërsa jeta e ahiretit është e pafundme dhe e pakufishme, domethënë, e përhershme. Jeta e vërtetë është jeta e ahiretit, e cila, siç e theksuam më lart, është e përhershme. Ky ajet fisnik na e shpjegon mjaft qartë këtë të vërtetë:

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë. Jobsimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me botën tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.” (Ra'd, 26) Çdo gjë që gjendet në jetën e kësaj bote, shkon drejt vjetërimit, plakjes dhe shkatërrimit. Faqet e kalendarit të jetës bien një nga një. Andaj, ata të cilët e lidhin zemrën me këtë botë të përkohshme dhe e harxhojnë kapitalin (jetën) e tyre për hir të kënaqësive të dynjasë duke e neglizhuar jetën e botës së përhershme, ndërkohë që gjendja është e atillë, me të vërtetë do të jenë prej atyre që janë mashtruar.

Kjo botë pothuajse është si një mysafirhane, në të cilën të gjithë janë të mirëpritur për një kohë të caktuar. Ndërsa njeriu sprovohet me shumë gjëra në këtë mysafirhane të dynjasë, në të cilën gjendet. Këtë ka shumë ajete fisnike që e vërtetojnë:

“Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja.” (Muhammed, 31) Gjithashtu, edhe në një ajet tjetër thuhet:

“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.” (Enbija, 35) Atëherë, synimi i vetëm i njerëzve të mençur duhet të jetë arritja e lumturisë së përhershme duke i kaluar me sukses sprovat e kësaj bote.

Në Librin tonë të Shenjtë, pra, në Kuranin Fisnik, flitet rreth sjelljeve dhe veprave që priten nga njeriu për t'i shfaqur e për t'i bërë. Aty janë vendosur urdhra dhe rregulla në lidhje me sjelljet e njeriut dhe janë dhënë këshilla që i sigurojnë qetësi e lumturi atij përgjatë jetës në këtë botë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Allahu i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.” (Nexhm, 31) Allahu Teala na njofton se çdo çështje do të shtjellohet me drejtësi në ditën e shpërblimit dhe të ndëshkimit:

“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (Enbija, 47)

Këto të vërteta të shenjta na tregojnë se njeriu duhet ta marrë seriozisht jetën e kësaj bote dhe se besimi mbart përgjegjësi. Për këtë arsye, besimi e bën të domosdoshme veprën. Njeriu e ka kusht që të jetë prej të devotshmëve, në mënyrë që t'i pranohen veprat të cilat do t'ia paraqesë Zotit (xh.xh.).

Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë:

Veprat duhet të bëhen me sinqeritet dhe dëlirësi. Veprat e mira në rrugën e drejtë janë depozitat e kapitalit më të veçantë, i cili i shpie robërit në xhenet.

Përgjatë udhëtimit të jetës në këtë vend, të cilin e quajmë dynja, njeriut mund t'i ndodhin shumë gjëra të bukura e të shëmtuara, të mira e të këqija. Në këtë proces të përkohshëm, pikëllimet dhe brengat e njeriut nuk janë të përhershme siç nuk janë të atilla edhe gëzimet. Secila prej këtyre vjen në jetën e njeriut me një kohë të caktuar dhe pastaj ikën e shkon. Vështirësitë, sëmundjet, dëshpërimet, mangësitë, pamundësitë, aksidentet, vdekjet dhe çdo gjë tjetër, janë nga një shkak për sprovimin e njerëzve. Xheneti është vendi të cilin do ta fitojnë ata që i kalojnë sprovat me sukses. Xheneti është një kënaqësi e pafundme, por ja që çdo gjë e ka një çmim. Gjërat pa çmim janë të pavlefshme. Andaj edhe xheneti nuk është aq i lirë. Xheneti është i rrethuar me vështirësi, ndërsa xhehenemi është i rrethuar me gjëra që i pëlqejnë nefsit. Në këtë rrugë ka mjaft alternativa që duken si të sakta, por që janë të gabuara. Dëshirat vetjake, kurthet e shejtanit, frymëzimet negative të shoqërisë, joshja e kësaj bote, padrejtësitë e ndryshme të të padrejtëve, etj., janë vështirësi që njerëzit duhet t'i mposhtin. Çdo vështirësi kalohet me besim. Besimi e bën të lehtë çdo gjë të vështirë. Ja pra, jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër përveçse një provë e tillë.

Ndërkohë që çdo njeri, i cili ecën në vijën e kaderit që i përket atij përgjatë jetës së kësaj bote, patjetër sprovohet me gjërat që i janë caktuar. Andaj, ajo që na takon neve për të bërë është që t'i kuptojmë drejt këto ngjarje dhe të shfaqim sjellje në përputhje me urtësinë e tyre. Ajo që na takon të bëjmë kundrejt çdo lloj ngjarjeje që na duket si negative është që të veprojmë me durim, të kërkojmë mbështetje nga Allahu, t'i nënshtrohemi Atij, të jemi të kënaqur ndaj caktimit të Zotit (xh.sh.) dhe ta falënderojmë Atë sa më shumë të jetë e mundur. Domethënë, neve na takon që të dalim në audiencën e Allahut të Madhëruar me zemër të pastër dhe fytyrë të bardhë. Çdo ngjarje që njeriut i duket si e keqe, është një e mirë e veçantë që e afron atë te Zoti (xh.sh.), sepse në llogarinë hyjnore asnjëherë nuk ka gjë të keqe.

Lus Allahun Teala që mirësitë dhe bukuritë të na e ndriçojnë rrugën përgjatë gjithë jetës sonë!



Hutbe
të zgjedhura

VLERA E LEXIMIT TË KURANIT

— Naim Drijaj —

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: “Ne Kuranin e bëmë të lehtë për mësim, po a është ndokush që merr mësim?” (Kamer, 17)

Sado i mirë të jetë njeriu, sado besimtar qoftë ai, Allahu (xh.sh.), e di se njeriu është i dobët. Zemra e tij ka nevojë për forcë, për fakte, për argumente dhe për shembuj. Prandaj Zoti nuk la asnjë profet pa mrekulli.

Dikujt i dha shkopin, që gëlltiste gjithçka. Dikujt i dha devenë, që ushqente një fshat të tërë me qumësht. Dikujt i dha shërimin e sëmundjeve të pashërueshme. Ndërsa Profetin (a.s.), e pyetën: “Çfarë të ka dhënë Zoti ty?” Profeti (a.s.), u përgjigj: “Ajo që më ka dhënë mua Allahu (xh.sh.), është shpallje, është fjalë”.¹

Fjala është mrekullia më e madhe dhe më e fuqishme. Ajo nuk mbaron në asnjë kohë apo vend. Shkopi mbaroi me profetin që e kishte, deveja u largua me largimin e profetit që e kishte këtë mrekulli, shërimi largohet me largimin e shëruesit, por fjala do të mbetet gjithmonë, për aq kohë sa do të flasin njerëzit. Prandaj Kurani ishte mrekullia e njeriut, e cila nuk do të përfundojë kurrë.

Kjo është mrekullia jonë, mrekullia e çdo myslimani, mrekullia e çdo njeriu që ka dëshirë të shikojë mrekulli me sy. Ai është KURANI, i cili është fjala e Zotit dhe fjalën mund ta thotë edhe i vogli edhe i madhi. Fjala e merr peshën nga ai që e flet

atë. A mund të ketë fjala peshë më të madhe, sesa kur e flet Allahu (xh.sh.)?” Kurani është fjalë, por nuk është fjalë njerëzish, fjalë mendjelehtësh, fjalë shkencëtarësh apo filozofësh, por është fjalë e Zotit të gjithësisë, fjalë e Krijuesit, prandaj pesha e tij nuk krahasohet me asnjë fjalë tjetër, prandaj edhe vlera e tij nuk matet me vlerën e asnjë fjale tjetër.

Ky Kuran ishte ai që i bashkoi arabët, të cilët ishin të përçarë si mos më keq. Ata kishin qindra vite që luftonin për pretekste të kota, por Kurani i bashkoi ata.

Kurani zbuti zemrat e këtyre njerëzve, që tashmë ishin ngurtësuar. Kurani lartësoi moralin e këtyre njerëzve, që askush nuk i njihte në botë. Ky Kuran i shndërroi këta njerëz nga barinj delesh dhe devesh, në barinj të gjithë njerëzimit. Kjo është fjala që ka pasur, ka dhe do të ketë peshë sa herë që do ta respektojnë njerëzit. Arabët ishin njerëz të thjeshtë, por kur u përballen me të vërtetën, u treguan njerëz të natyrshëm, u treguan burra dhe e pritën atë me zemra të hapura.

Ne dhe të gjithë myslimanët e botës e lexojmë Kuranin, por vallahi ka mbetur fjalë, që nuk futet në zemër, por hyn në një vesh dhe del nga veshi tjetër. Akoma nuk i kemi hapur zemrat për këtë Kuran. Vallahi, po t'i hapnim zemrat ndaj Kuranit siç i hapën të parët tanë, do të ishim shumë më lart se ç'jemi sot.

Ky Kuran preku zemrat e njerëzve të mirë dhe njerëzve të ligj. Dikush i shkoi Profetit (a.s.) dhe

1. Hadith i vërtetë. Buhariu (1044) dhe Muslimi (152).

u përpoq me të gjitha mënyrat, që ta largonte nga rruga e drejtë. Pasi tha atë që kishte për të thënë, Profeti (a.s.), ia ktheu: “Unë kam vetëm dy fjalë, ato janë ajetet e Kuranit. Dëgjoji ato dhe vendos vetë pastaj”. Kur ky njeri dëgjoji fjalën e Allahut (xh.sh.), u kthye kokulur tek njerëzit e tij dhe u tha: “Mos më çoni herë tjetër për ta rrëzuar poshtë Kuranin. Vallahi, ai është një libër i ëmbël. Ato fjalë nuk kanë të krahuar. Vallahi, ai libër do të jetë gjithmonë i lartë dhe kurrë nuk do të rrëzohet”.²

Disa njerëz shkuan në Mekë, por vendosën pambuk në veshët e tyre, që të mos e dëgjonin Kuranin. Ndërsa Kurani nuk pyeti për pambukun që ata kishin vendosur në veshët e tyre, por hyri drejt e në zemrat e tyre.

Ky Kuran drejtoi zemrën e Umer Ibn Hattabit (r.a.), i cili ishte nisur të vriste Profetin (a.s.), por kur dëgjoji Kuranin, u shkri ashtu siç shkrihet bora nga dielli.

Kurani i habiti edhe xhindet, të cilët hipën në shpinën e njëri – tjetrit për ta dëgjuar atë nga goja e Profetit (a.s.). Pastaj shkuan dhe u thanë shokëve të tyre: “Kemi dëgjuar një Kuran që mahnit, prandaj besoni se ne kemi besuar tek ai”. Allahu (xh.sh.), thotë për këtë Kuran: “Sikur Ne ta zbrisnim këtë Kuran mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukturuar e të çarë prej frikës nga Allahu...”. (Hashr, 21) Pra, nëse Kurani do të zbriste mbi mal, ai do të bëhej shkrumb e hi. Vallë, ç’bëhet me zemrat tona? A thua janë bërë më të ngurta se malet? Si ka mundësi që nuk preken zemrat tona nga fjalët e Krijuesit, nga Kurani?

Dua të flas për vlerën e leximit të Kuranit, sepse mendoj se jemi larg tij. Ka kohë që nuk e kemi lexuar. Ndoshta kur flasim për leximin e Kuranit, na vjen nëpër mend Ramazani i kaluar. Ka kohë që nuk kemi ndenjur me Kuranin, ka kohë që nuk kemi punuar me të. Prandaj le t’ia kujtojmë vetes sonë këtë gjë. Me çfarë tjetër duhet ta përkujtojmë veten, nëse nuk e përkujtojmë njëri – tjetrin me leximin e Kuranit?!

Ky Kuran të jep aromë besimtari dhe nëse ti nuk e lexon, ta heq aromën. Profeti (a.s.), ka thënë: “Shembulli i besimtarit që lexon Kuran, është si shembulli i portokallit. Shijen e ka të mirë edhe erën e ka të mirë. Shembulli i besimtarit që nuk e lexon Kuranin, është si shembulli i hurmës. Ajo shijen e ka të mirë, por nuk ka erë. Ndërsa munafiku që lexon Kuran është si shembulli i borzilokut. Erën e ka të mirë, por shijen e ka të keqe. Kurse munafiku që nuk lexon Kuran, është si puna e kungullit të egër.

2. Hadith i vërtetë. Hakimi (2/507). Hakimi e vlerëson hadithin të vërtetë sipas kritereve të Buhariut dhe me vlerësimin e tij pajtohet edhe Dhehebiu.

Erën e ka të keqe edhe shijen e ka të keqe”.³

Besimtari që nuk lexon Kuran nuk ka erë, sepse nga ai nuk del aroma e ajeteve të Kuranit, që janë si trëndafila. Prandaj le t’i japim aromë zemrave dhe gjuhëve tona. Le ta lexojmë Kuranin. Le të dalë aroma e fjalëve, që janë fjalët më të mira që mund t’i thotë çdokush.

Kurani është shpëtimtari dhe zgjidhja e enigmës, sipas deklaratës së Profetit (a.s.), i cili një ditë i tha Aliut (r.a.), dhëndrrit të tij: “Pas meje do të ketë shumë probleme dhe trazira”. Aliu (r.a.), e pyeti: “O Profet i Zotit, cila është rrugëdalja prej trazirave?” Profeti (a.s.), u përgjigj: “Libri i Zotit është rrugëdalja prej trazirave. Në Kuran është njoftimi i atyre që ishin përpara jush dhe atyre që do të jenë pas jush. Ai është gjykatësi, që gjithmonë gjykon drejt. Allahu do ta copëtojë çdo tiran, që e braktis Kuranin. Këdo që kërkon ndihmë dhe udhëzim përveç Kuranit, Allahu (xh.sh.), do ta humbë. Kurani është litari i fortë, kujtuesi i urtë, është rruga e drejtë, që kurrë nuk do të humbasë. Gjuha nuk lodhet me leximin e tij. Nga leximi i tij nuk ngopen dijetarët, zemra nuk mërzhitet asnjëherë nga përmendja e tij. Mrekullitë e tij nuk mbarojnë kurrë. Kush flet me të, ka folur drejt, kush gjykon me të, ka gjykuar drejt, kush fton për tek ai, ka ftuar për tek e drejta dhe është gjithmonë i drejtuar”.⁴

Këto janë përshkrimet e Profetit (a.s.), për Kuranin. Kjo është zgjidhja dhe rrugëdalja nga streset dhe problemet që kemi në zemrat tona. Vallahi, sikur ta bënim mik Kuranin, do të ishim shumë më të qetë, sepse Kurani është shpirt për zemrën e njeriut dhe nuk ka ushqim tjetër për zemrën përveç Kuranit. Shpirti është prej Zotit dhe ushqimi për të, është përsëri prej Zotit.

E pranojmë të gjithë që sot jemi shumë larg me Kuranin, prandaj nuk e ndjejmë besimin në zemrat tona, nuk e ndjejmë as namazin që falim. Dëgjoji se ç’thotë Profeti (a.s.): “Do të vijë një kohë, që Kurani do të vjetërohet në zemrat e disa njerëzve, siç vjetërohet rroba, derisa në fund njeriu ta hedhë atë, sepse nuk ka dobi prej saj. Ata njerëz që do ta lenë Kuranin edhe kur ta lexojnë nuk do t’ia ndjejnë shijen atij leximi. Ata njerëz do t’i godasë Allahu (xh.sh.), me një sëmundje. Do ta lenë punën e sotme për nesër dhe të nesërmen do të thonë se ka kohë për ta bërë atë punë edhe pasnesër. Ata njerëz do të bëjnë gjynahe dhe do të thonë, se i fal Zoti i gjithësisë”.

Mesazhi im për veten time dhe për të gjithë ju është: “Le të afrohem me Kuranin. T’i forcojmë lidhjet tona me librin e Allahut (xh.sh.)”.

3. Hadith i vërtetë. Buhariu (5020) dhe Muslimi (797).

4. Hadith i dobët, ndërsa domethënia e tij është e vërtetë. Tirmidhiu (2906). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët.



Tre ushqimet

TË CILAT ULIN KOLESTEROLIN DERI NË 40%

Shkaktarët e kolesterolit janë të shumtë e të ndryshëm.

Këtu përfshihet ushqyerja e keqe, mungesa e aktivitetit fizik por edhe stresi.

Kur kolesterolit është i lartë por niveli i triglicerideve është normal, atëherë stresi është përgjegjës për këtë situatë.

Kur niveli i triglicerideve dhe i kolesterolit janë të lartë, atëherë faji i takon sheqernave dhe tiroides.

Nëse kolesterolit është i lartë për shkak të stresit, medikamentet kundër kolesterolit nuk janë efikase dhe sekretit në këtë rast qëndron tek ushqyerja.

Sipas ekspertëve, niveli i shëndetshëm i kolesterolit është si më poshtë:

Kolesterolit i plotë duhet të jetë më pak se 200 mg/dl (miligramë për një decilitër gjaku).

Kolesterolit LDU duhet të jetë më pak se 100 mg/dl.

Kolesterolit LDL duhet të jetë 40 mg/dl ose pak më i lartë.

Ekspertët thonë se kufizimi i sheqerit por edhe përfshirja e tre ushqimeve të caktuara në regjimin tuaj të përditshëm mund të ulë kolesterolin deri në 40%.

NJË GJYSMË MOLLË E KUQE NË DITË

Molla e kuqe ofron antioksidantët më të mirë. Ajo është gjithashtu e pasur me fibër, flavonoidë dhe ushqyes të tjerë.

Frutat në përgjithësi kanë një ndikim të fortë tek

njerëzit që vuajnë nga niveli i lartë i triglicerideve dhe shkaktojnë dhjamosje të mëlçisë.

Për këtë shkak, ekspertët rekomandojnë që të konsumoni vetëm një gjysmë molle të kuqe në ditë kundër kolesterolit.

TREÇEREK FILXHANI ME COPA PANXHARI

Fibra tek panxhari është e domosdoshme për mbajtjen nën kontroll të kolesterolit dhe shëndetit të zemrës, pavarësisht nivelit të triglicerideve.

Panxhari përmban shumë fibër dhe ushqyes të rëndësishëm që ndihmojnë zemrën, mëlçinë dhe trurin.

I KARROTË MESATARE

Karrotat janë të shkëlqyera për zemrën dhe për sistemin tretës.

Ato janë të pasura me fibër, beta karoten, antioksidantë, vitamina dhe minerale.

Karrota e përmasave mesatare përputhet më së miri me gjysmën e mollës dhe copat e panxharit duke ofruar kurën ideale me tre përbërës kundër kolesterolit të lartë.





Kurat e shpejta dhe të shëndetshme

PËR PASTRIMIN E MËLÇISË

Mëlçia është një organ shumë i rëndësishëm në trupin e njeriut.

Ajo luan shumë role thelbësore në organizëm si pastrimi i gjakut, luftimi i infeksioneve të ndryshme dhe tretja

Mëlçia është organi i vetëm në trup që rregullon veten në rast dëmtimi, por ajo ka nevojë të pastrohet rregullisht.

Në këtë artikull do të mësoni disa receta të thjeshta për pije të shëndetshme që do t'ju ndihmojnë të pastroni mëlçinë.

ÇAJI I LËKURAVE TË LIMONIT

Lëkurat e limonit janë të pasura me vitaminë C dhe shumë antioksidantë.

Për këtë çaj ju nevojitet: lëkurat e një limoni, 250 ml ujë dhe një lugë gjelle me mjaltë.

Pastroni mirë me ujë dhe pak sodë buke lëkurat e limonit.

Ziejeni ujin dhe më pas hidhni brenda lëkurat e limonit.

Mbulojeni çajnikun me kapak, hiqeni nga zjarri dhe lëreni lëkurën të çlirojë substancat mirëbërëse për 10 minuta.

Kullojeni dhe ëmbëlsojeni çajin me mjaltë.

Ky çaj duhet pirë 30 minuta përpara gjumit dhe çdo ditë për tre javë me rradhë.

ÇAJ ME XHENXHEFIL DHE LIMON

Xhenxhefili me limonin përmirësojnë tretjen, luftojnë inflamacionin dhe pastrojnë mëlçinë e tëmthën.

Për këtë çaj ju nevojitet: 1 lugë çaji me xhenxhefil pluhur, 250 ml ujë dhe lëngu i një gjysmë limoni.

Ziejeni xhenxhefilin pluhur në ujë për 2-3 minuta. Më pas lëreni në ujë për 10 minuta të tjera.

Kullojeni dhe shtoni lëngun e limonit.

Ky çaj duhet pirë 40 minuta përpara gjumit për 2 ose 3 javë me rradhë.

ÇAJI I MENTES

Mentoli tek kjo bimë përmirëson tretjen dhe metabolizmin.

Ai kontribuon në eliminimin e toksinave nga mëlçia.

Për përgatitjen e çajit ju nevojiten: 1 lugë gjelle me gjethe mente, 250 ml ujë dhe gjysëm luge gjelle me lëng limoni.

Ziejeni menten në ujë, lëreni për 10 minuta dhe më pas kullojeni.

Sipas dëshirës mund të shtoni edhe lëngun e limonit.

Ky çaj duhet pirë 20 minuta përpara gjumit për 3 javë me rradhë.

ÇAJI I KAMOMILIT

Kamomili është shumë i pasur me antioksidantë të cilët ndihmojnë në filtrimin e toksinave nga gjaku.

Për këtë çaj ju nevojitet 1 lugë gjelle me lule kamomili dhe 250 ml ujë.

Ziejeni kamomilin për 5 minuta dhe më pas lëreni mënjane për 10 minuta të tjera.

Kullojeni dhe pijeni menjëherë përpara se të shtriheni për të fjetur. Mund ta ëmbëlsoni me mjaltë.

Ky çaj duhet pirë çdo mbrëmje për 2 javë.



VËLLAI I MADH I EPOKËS DIGJITALE: DO TË NA VËZHGOJNË PËR 24 ORË NË DITË!

Silicon Valley është një industri nxjerrëse, shkruan Ben Tarnoff në Guardian. Modeli i saj i biznesit, nuk është përqendruar në nxjerrjen e naftës apo qymyrit, por në atë të të dhënave. Për hir të saktësisë: të dhënave tona personale. Sa herë që bëjmë një kërkim në Google dhe sa herë që bëjmë një të tillë në Facebook, lëmë prapa gjurmë digjitale të cilat përdoren për të “targetuar” reklamat më të mira që shohim kur lundrojmë rrjet.

Duke pasë parasysh rezultatet, nuk ka dyshim se ky është një model i suksesshëm biznesi: më 2016, Facebook dhe Google grumbulluan 71 për qind të investimeve digjitale në SHBA (51.7 miliardë dollarë nga 72.5 gjithsej), duke lënë vetëm thërrime për të gjithë operatorët e tjerë në këtë sektor. Pavarësisht fitimeve të mëdha, dy gjigantët duhet të përballen me një problem: ashtu si nafta apo qymyri, të dhënat nuk janë të pafundme dhe gjetja e të dhënave të reja po bëhet gjithnjë e më komplekse! Zgjidhja e problemit është të zgjerohen në tregje të reja me çdo kusht. Është si programi afatgjatë i Facebook-ut, me disa nga vështirësitë e tij, me projektin e tij Free Basics i cili premton të sjell një version thelbësor dhe të lirë të internetit në vendet më pak të zhvilluara, për të fituar të dhëna nga një numër i madh përdoruesish të rinj.

Zgjidhja e dytë është të futesh më thellë në mbledhjen e të dhënave: pasi zbulon se sa fitimprurës është ky biznes, pse të mos spiunosh aktivitetet tona në internet? Sado që ne shpenzojmë shumë para kompjuterëve, smartfonëve dhe tabletave, sërisht pjesa më e madhe e ditës sonë është jashtë linje. Por, edhe “offline” mund të mblidhen të dhëna për shfrytëzim komercial.

Gjiganti që tregon më së shumti mbi këtë formë kontrolli është Amazon. Asistentë virtualë, duke përfshirë Alexa-n, në fakt janë në gjendje të nxjerrin informata të dobishme duke dëgjuar bisedat

tona në shtëpi. Por, shembulli më tipik vjen nga Echo Look, versioni i serverit virtual të Amazon-it për entuziastët e modës, i cili na jep këshilla për veshjen pasi na ka fotografuar dhe xhiruar mu në dhomën tonë, duke zbuluar kështu shijet tona për këtë çështje.

Brenda pak vitesh, kjo formë e mbikëqyrjes komerciale do të zhvendoset mes raftëve të supermarketit (vlen të përmendet se Amazon ka blerë kohët e fundit zinxhirin e “Whole Food” për 13.7 miliardë dollarë), ku disa sensorë do të vëzhgojnë se si lëvizim në korridore, para cilave prodhime ndalemi më gjatë, atë që ne shikojmë e pastaj e refuzojmë etj. Të gjitha informacionet janë jashtë-zakonisht të dobishme. Nuk është një ekzagjerim: supermarketi plotësisht i automatizuar që Amazon sapo ka hapur në Seattle, tashmë i kryen të gjitha këto aktivitete.

Kjo nuk është e gjitha: një patentë paraqitur nga Amazon-i tregon potencialin e dronëve të saj për furnizimet në shtëpi. Në saje të një aparati fotografik, do të jetë në gjendje të shohë nëse shtëpia jonë ka nevojë për një riparim në çati, apo nëse kopshti ka nevojë të punohet. Dhe, pastaj na dërgon disa reklama respektive.

Përfytyroni pak sikur disa dekada më parë, do t’ju thoshin se të tjerë do të hapnin të gjithë letrat në postën tuaj, se në restorant do të regjistrohen çdo fjalë që thoni, apo që një punonjës supermarketi ku bënit Pazar do t’ju ndiqte hap pas hapi, kudo që të shkonit. Çfarë do të kishit menduar?

Në botën online, e gjithë kjo është pranuar në mënyrë pasive prej nesh. Ndoshta kur kjo formë vëzhgimi të hyjë në shtëpitë tona, do të fillojmë t’i kushtojmë më shumë vëmendje.



NEPTUNI DHE URANI FSHEHIN PASURI TË VËRTETË: PLANETËT KU FORMOHEN DIAMANTET MASIVE

Diamante të paçmueshme që fundosen ngadalë përmes “turbullirave” në fund të Neptunit dhe Uranit, mbulojnë bërthamat solide të planetit, tregon një studim i ri.

Vetitë fizike të këtyre “gjigantëve të akullit” dallojnë shumë nga Toka. Neptuni dhe Urani kanë bërthamë shkëmbore të rrethuar nga shtresa të dendura të akullit të përbërë nga hidrogjeni dhe amoniaku.

Thellë brenda këtyre planetëve, rreth 10 mijë kilometra nga sipërfaqja, presioni është kaq intensiv sa që fizikanët ka kohë që spekulojnë se mund të krijohet një “grumbull diamantesh”.

Ata tani kanë bërë një eksperiment të ri që simulon këtë proces dhe ofruan provën e parë se “shiu prej diamantesh” është i mundshëm.

Kërkuesit nga laboratorit Helmholtz-Zentrum Dresden-Rossendorf në Gjermani kanë simuluar kushtet ekstreme, të cilat ndodhen në brendësi të planetëve duke përdorur laser të fuqisë së madhe e cila ka krijuar valë goditëse në polistiren, përzierje



plastike e hidrogjenit dhe karbonit, e cila Neptuni i jep ngjyrën e tij karakteristike të kaltër për të prodhuar presion intensiv të ngjashëm me atë që ndodhet në thellësi të sipërfaqes së planetit.

Pothuajse secili atom i hidrogjenit në polistiren është ngulitur në strukturën mikroskopike të diamantit në gjerësi prej disa nanometra, kanë publikuar shkencëtarët në revistën Nature Astronomy.

Edhe pse formacionet kanë zgjatur vetëm disa të qindta të sekondës, ky ishte fakti i parë i qartë i teorisë eksperimentale për “shiuin e diamanteve”.

Dominik Kraus, autor kryesor i hulumtimit, tha se rezultatet ishin ndër momentet më të mira në karrierën e tij, pasi që më herët të gjitha këto ishin vetëm supozime, shkruan The Times.

Diamantet që formohen në Neptun dhe Uran mund të arrijnë peshën prej disa milionë karatësh. Ndryshe, diamanti më i madh në botë është ylli i madh i Afrikës Cullinan 1 i cili ka 530.4 karatë dhe 106.1 gramë.





Souvenir Albania




*tregton me shumicë dhe pakicë
punime artizanale të cilësisë së lartë.*





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orndive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mveshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress të balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin – qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.






VILA DANTE
RESTORANT

 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

SHOPPING HOUSE


ADRESA:
RRUGA QEMAL DRAÇINI
TEK SAHATI, SHKODËR

ÇAPA[®] musluk



REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI
DHE 5 VJET GARANCI
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



5 ★★★★★
Yıl Garanti

www.capamusluk.com.tr

www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Vurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni
përmes telefonave dhe web faqes.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive


4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“O besimtarë!
Bindjuni Allahut,
bindjuni të Dërguarit
dhe atyre që drejtojnë
punët tuaja.
Nëse nuk pajtoheni
në ndonjë gjë,
drejtojuni Allahut
dhe të Dërguarit,
nëse besoni Allahun
dhe Ditën e Kiametit.
Kjo për ju është më e mira
dhe shpjegimi
më i bukur.”

(Nisa, 59)